

SHËTZAT

LE
PLEIADI

IX, 1965 — 1-2

SHËJZAT

[LE PLEIADI]

E përkohëshme kulturore, shoqërore
e artistike

Rivista culturale, sociale ed artistica

Anno IX - n. 1-2 Gennaio-Febbraio 1965

Vjetri IX - n. 1-2 Kallënduer-Fruer 1965

Drejtuer Përgjegjës
Direttore Responsabile

MATILDE MANCINELLI

Kryeredaktor - Redattore capo

MARTIN CAMAJ

Selija e Redaksís dhe e Administratës:
Sede della Redazione e Amministrazione:

Drejtësa për letra e lajmime:
Indirizzo per la corrispondenza:

PIAZZA DELLA BALDUINA, 59

Dorshkrimet, dhe në qoftë se s'botohen,
nuk kthehen.

I manoscritti, anche se non pubblicati,
non si restituiscono.

Pronar - Proprietario
ERNEST KOLIQI

Derdhja e pajtimeve - Versamenti:
Conto Corrente Postale 1/23626

PËRMBAJTTJA

Sommario

HILUSHI :

**Fjala qet fjalën: Tue lundërtue nëpër
dët e nëpër jetë** (Una parola tira l'altra:
Navigando attraverso il mare e la vita).

REDAKSIJA :

**Habilitaçoni i dr. Martin Camajt si
doçent n'albanologji** (Conseguimento
della docenza in albanologia del dot-
tor Camaj).

KARL GURAKUQI :

Për historin e arsimit shqiptar (Per
la storia della pubblica istruzione al-
banese).

MARTIN CAMAJ :

**Vendi që i përngjante një zgjoni ble-
tësh** (Il luogo che assomigliava ad
un alveare di api).

ANGELA CIRRINCIONE :

**Immaginificazione idiomatica albane-
se** (Nfytyrsim idjomatik shqiptar).

HENRIK GRADILONE :

Një lyrikë arbreshe (Una lirica italo-
albanese).

I quaderni di un anonimo scutarino
(Tefterët e një shkodrani të paemën).

LUIS DE ROSA :

Vjerrsha (Poesie).

ERNEST KOLIQI :

Rrëjë të lëvizin (Le radici vibrano).

MARTIN CAMAJ :

**Jeta dhe vepra e Johann Georg von
Hahn** (Vita e opera di J.G. von Hahn)

VASIL D. ALARUPI :

Biri Nënës (Il beniamino di mamma)

Kronikë kulturore (Cronaca culturale).

Libra të lexuem (Libri letti).



SHËZAT
LE PLEIADI

Fjala qet fjalën

nga HILUSHI

Tue lundërtue nëpër dët e nëpër jetë

— Les Cyclades! — *i a bânî dikush mbas meje tue shênjue me dorë ujdhezat qi ngrehashin rreth e rrotull sipër valve t'argjanta, mërtisë ndër maje me tisa të ndërpëshëm avujsh.*

Motoanija po çante me zhdërvjellti Detin Egjë n'at paradite kristalore vjeshte. Ishim nisë nga Athina në të zbardhun të dritës e tashti po lundërtojshim kah Stambolli.

Unë u solla me pá kush foli. Nji zotni i mushkazëm (ngjyrë-mjalte) mirë i veshun, kund me një moshë tridhetëvjeçare mbas dukës, aty në pupe, — ku unë po soditëshëm vashkën (sillage) kah po e lulzonte me lule të bardha shkumbe detin mbas anës, — filloi me më tregue frengisht emnat e ujdhezave qi shifeshin anash e para nesh.

— *Histori e shkelqyeshme kjo e Helâdes! — fola unë, vërtë i dall-disun nga bukurija e myteve klasike.*

— *Po, po; por ka vjetërsina edhe mâ të madhnueshme se kjo e Helâdes — m'a priti shoku i em udhëtimi.*

— *E ku? — pyeta.*

Ai u paraqit: diplomat egjyptian nisë me shkue n'Ankara si pjestar i përfaqësis diplomatike të vendit të vet në kryeqytetin e Turqisë. Unë i thaçë se jam shqiptar edhe shqiptova emnin t'em. Xûmë bisedën. Më lëvdoi vjetërsit e Egjyptit, qytetnimin e lartë egjyptian qi ushqeï me

dituni të vet të gjitha qytetnimet e lulzueme mâ vonë në Mesdhë e përtej. Mâ i pari e mâ i madhi qytetnim qi njofti bota, ai i Egjyptit.

Të gjitha ato pohime ishin deri diku të vërteta, por nuk më pëlqente mënyra tepër urdhnore, disi sulmuese, qi ai përdorte tue m'i parashtrohe. Me sjellje e shprehje vërtë shumë të njerzishme vinte tue e endë bisedimin, por më gitej se në zâ të tij sikur tingullonte një qellim ngacmues.

Na Shqiptarët jemi tekanjosa. Edhe mâ i buti ndër né ndryn në vetvete një tharm idhnije qi, sa na ngucë kush, zgjohet e na e turbullon gjakun. Mâ tepër tingulli i zânit se sa fjalët e atij spitullaqi më harbuen (m'excitërent). Vendosa, pa i dhânë kurrkund me kuptue zëmrimin t'em të përmbrendëshëm, me i a thye çibrin, njëherë tue e mrekullue me përgatitje t'eme kulturore e mandej tue i a ngulë mirë në krye me prova të gjalla se na Shqiptarët nuk jemi shkalbalta e dheut, por mundemi me u ndëjë përkrah pa zori çdo populli arab. (E shifni? huji na bân edhe patryota!).

Thonë se mproja mâ e mirë âsht të msyemit. Unë vendosa me e sulmue at mburracak mun në qandër të mburrjeve të veta d.m.th. në punët e Egjyptit. Dojshem t'i epshem një dishmí se ishem i pajisun me njoftime bukur të gjâna mbi zhvillimin kulturuer egjyptian.

I a fillova:

— Kam njoftë në Kajro para do vjetvet shkrimtarin t'uej Mahmud Taimur-in e pata rasën disa heresh të shëndrroj me të mendime mibi letrësin e popujvet të vjetër nga zânafilla historike, por të rij për kah shfaqjet letrare moderne. Edhe shkrimtari i juej përqendronte vëzhgimin mbi mënyrën mâ të përshtatëshme si m'e paraqitë në trajtat bashkohore trashigimin shpirtnuer jetik qi përbâhet nga vetit dalluese të një kombi. Pat mîrsin të më levdojë do novela të mija me subjekte shqiptare qi një prelat i kulturuem, Hirësija e Tij Vehbi Smajli, asokohe student n'Universitetin Al-Azhar, ka përkëthye e botue arabisht. Më tha se në to ndiehet shpirti shqiptar në luftim ndërmjet traditës e frymës së kohës së ré. Taimur-i më la përshtypjen e një njeriu me një gjânësi së madhe përftimi (conception). Më dhuroi librat e vet të përkëthuem frengisht, tue u shkruie në ball kushtime mjaft përkëdhelëse për mue. Në Kairo e mâ vonë në Palermo u takova shpesh edhe me Teofik Al-Hakim-in prej veprave të cilit më pëlqen poemi dramatik Shtatë njerzít e fjetun t'Efëzít, qi i a rriti nâmin mbrendë n'atdhë dhe i a bâní të njoftun emnin përjashta. N'Universitet të Romës mandej ndëgjova një ligjiratë, të mbarrsun me dituni të gjallë, të Taha Husai-t qi thellonte problemet mâ të ngashrueshme të kohës së sotshëme. Thânjët e tija ku spikatshin mendime të freskëta dhe të depërtueshme, të drejtpeshueme e njëherit guximtare, më pushtuen menjherë shqisen sepse kishin gjasim të madh me probleme kombtare t'ona.

Njoftja e auktorvet mâ të cilsuem të vendit të tij, njoftje qi ai nuk e prítte prej meje, m'u ngjá se e mbushi me habí. Më pyeti:

— Keni çekë problemet e popujve të vjetër qi vonë arríjten në shfaqje letrare moderne. U kushtoní studime të veçanta gjenezës letrare të këtyne popujve?

U habita njëherë, mandej u kujtova se në paraqitje s'kishte marrë vesht se prej kah ishem.

— Jam Shqiptar! — i thaçë.

Kur i thaçë «Jam shqiptar!» m'u bâ (mbas gjase at ditë paskam pasë ndjehë shum ndyeskeq!) se i u vizatue në buzë një shêj përqeshjeje. E unë atëherë, tue shtî në punë gojtarin mâ tronditëse qi mujshem me shtrydhë nga cilsit shprehse të mija, i shtjellova para një panoramë krenare të kulturës s'onë. Rrjeshtova, tue i çue në qiell, emna poetësh të parë e të dytë, tregimtarësh, dramaturgash, studjuesash, shka më rá në mend aty për aty. E, tue drashtë mos po i duket i pakët numri i auktorve, erdha tue grumbullue emna shkrimtarësh të vdekun e të gjallë, të çdo ngjyrje e të çdo rrymbe, pa marrë parasýsh dallimet qi zakonisht unë bâj ndër ta. Disá prej auktorvet, qi atij i a levdova, unë i urrejshem për arsýena vetiake pa kurnji lidhje me kriteret letrare.

Ai ndëgjonte. Në një shêj vendi, këlthiti:

— Të lúnët! Po më vjen mirë për këto përparime të Shqipnís.

Në zá bashkë me një kënaqje të njëmendët i tingullonte kësohere edhe çiltërija má e thjeshtë.

Kuptova, e ashtu u vertetue puna kur u spjeguem má mirë, se të dy kishim rá viktima të një mosmarrëveshtjeje. Ai, tue mos pasë ndëgjue mirë fjalët e mija kur i thaçë se ishem Shqiptar, më kishte marrë për Europjan d.m.th. pinjuell të njëj kombi të madh t'Europës. Kompleksi i ultësis vepronte n'atë si në të gjithë bijt e kombeve të vogla, kështu qi, për t'a mujtë në vetvete at kompleks, kishte përdorë kundra meje një qendrim ngucakeqi. Skjarue puna e kombësis s'eme, biseda u vërtit mbi Europë, mbi idét e ndritëshme qi ajo u dhuroi mbarë popujvet të botës, por edhe mbi faje të mëdhaja të saj. E u bâme miq.

Pak dit përpara ai kuvendim me diplomatin egjyptian më rá ndër mend në një rasë ku unë, tue theksue randësin e vlerave shpirtnore t'ona. laçë deshtas pa përmendë disa eksponenta të dekun e të gjallë të kulturës s'onë vetëm pse s'kam shkue ase nuk shkoj mirë me ta.

Fjala e vjetër shqipe thotë: «Huji vdes shtatë dit mbas shpirtit». Huji më shtýni me heshtë emna të dënjë për t'u vû në spikamë. E, prâ, n'udhëtím detar kah Stambolli, po huji më kishte nxitë të levdoj miq e anmiq. Huji shqiptar na bân me folë e veprue herë mbrapësht, herë mbarë. Kur do të shërohemi prej kësaj së mbetë?

Në Tiranë, para bukur do vjetve, një mik i dashtun i emi më mundështoi egërsisht kur nisa me i a levdue sjelljet e një kundërshtari të përbashkët. «A jé shëndosh në mend? Nji anmik s'ásht kurr për mue njeri i mirë. Ti, po e çmove atë si të mirë don me thânë se pohon me gojë t'ande qi jemi na të këqij. Kush m'a don të keqen, për mue s'ka asnji veti për t'u çmue.

— E po qe njëmend i ndershëm, mbas pohimit gjithunji të tjeret edhe mbas vetë bindjes s'ate?

— Atëherë e urrej edhe má fort dhe i a kam dyfish frigën, sepse një anmik i tillë të vën në gjumë dhe, kur má pak e pret, të bje krës e të rroposë. Prandej kurr nuk flas mirë për të.

Miku qi flitte kështu ishte intelektual dhe zëmërbardhë, në rrethana jete së randomta. Por... Shqiptar... e me huji qi në Shqiptarve na dallon, sot për sot. Po tham sot për sot pse dje kishte Shqiptarë qi mendojshin disi ndryshej. Për shembull, Binak Kola. Me 1925, në Podgoricë (sot Titograd) ishim mbledhë (qoftë për atëherë!) disa miq shqiptarë e po bisedojshim përzëmërsisht tue pí rakí të freskueme në pus e tue hangër meze kordhicash qi n'at vend janë fort të shijeshme

e prandej në zâ. Nuk e mbaj mend si u suell fjala mbi miq e anmiq dhe mbi të prûmit qi njâj burrit i përket kundrejt të parvet dhe të dytvet. Si m'u sjellë me miq të gjithë ishin një mendjeje; ndryshimi i mendimeve shpërthei kur rá fjala mbi sjellje me anmiq.

Binak Kola (kam xânë shumë gjana prej tij në të rit t'em), malsuer dukagjinas idealist, i pashkollë por i pajisun me një gjikim pleqnues qi të lënte pa mend, i vûni kapak asaj bisede me do fjalë të cilat më kanë mbetë të skalituna në trû ç'prej asaj kohe.

Burri i maleve kështu tha: — Njerin qi më ká gjakun borxh s'e lá pa e ndjekë dhe, kur të më vijë për shteg, pa e vrá. Por burri nuk e ka zakon m'e shá e përbuzë gjaksin ase anmikun edhe në kjoftë se ky të shpifet e shprallon kundra teje. Po kje i zoti. s'kam kurrfarë vishtirsije t'i a njoj zotsin. Po kje i ndershëm e bujar, i a çmoj sje-lljet. Po e xâmë se bieq në gjak me vojvodën, të parin e vëllaznis s'eme. E ndjeku dhe mundohem gjithsesi me marrë gjakun. Por, në kje se krisë kushtrimi e i beditet vëllaznis një rrezik i përbashkët dhe vëhet besa, un vrapoj m'u rrjeshtue me tjerë nën urdhën të tij dhe me shkue mbas si kahdo qi ai të më prijë. I a nderoj fjalën, i dal zot në kuvend të vëllaznis pleqnimeve të tija, në kjoftsha i bindun se janë për të mbarën e vendit, e s'kam aspak zori me i thânë « të lumtë e të paçim! » kur puna mbas prijës së tij i a zbardhë faqen vëllaznis. Tue nderue të parin t'em, nderoj Kanunin. Kush nuk nderon kanunin, ai s'a burrë por stramastik (bâtard) qi i a vën kambën nderit të të Parvet. Si të sôset nevoja e bashkimit edhe të kumtohet mbarimi i besës, atëherë tërhiqem në kullë t'eme për të pritë ditën qi me i a ngulë vojvodës sa të mundem do plumba të fortë në shtat për të marrë gjakun t'em. E vras, po, por të mirat qi ai ka nuk i a mohoj e nuk i a mshefi.

Në këtë mënyrë u shpreh Binak Kola, i frymzuem nga instinkti i thellë shqiptar, instinkt i paprekun nga zvetnimi qi kohnat e reja shkaktuen në natyrën e shumicës prej nesh. Na intelektualët kujtojmë se naltësohemi në shkallë të qytetnis tue u lirue nga ndikimet e trashigimit stërgjyshuer, qi përmbledh palcin misterjuz të vetive t'ona autoktone, e má në fund shofim se një burrë i thjeshtë shqiptar, shpesh-hera i pashkollë, por me instinktet e fisit në gjak, ka ndiesina má të nalta shoqnore se na. Nuk levdoh gjakmarrjen qi ka dâmtue tmerisht kombin. Çmoj ndiesit kalorsiake, qi përsjellshin një vrasje kur kjo kryehej në stihimin e ndiesis së nderit, por jo vrasjen. Ndiesija âsht për t'u levdue, pasoja qi ajo shkaktôn duhet dënue rrebtësisht.

Normat e Kanunit, qi ushqejshin burrnin e Binak Kolës, koha i kapërcei, por dâm të madh do të pësonte shpirti shqiptar ditën qi fryma thellësisht shqiptare e ligjëve dokesore mos të lëvritte në të.


Undyra e Kanunit âsht burrnija, d.m.th. sjellja fisnike, as tepër e butë qi m'u njehë ligështi, as e mujshtëme (violente) qi m'u njehë rrëmbim gjakues (passionnel) por e matun e e njerzishme në drejtpeshim ndërmjet trimnis e urtis. Huji e then këtë drejtpeshim. Duhet të qortohe- mi nga kjo e mbetë.

Dija vlen, por burrnija ka vlerë má të madhe, në marrëdhânje njerzore e kombtare. I dituni këtë duhet t'a pranojë.

Po qe mandej se në trup të Shqiptarit bashkohet dija me burrnin, atëherë gjindemi përpara një njeriut qi nderon kombin e njerzimin mbarë.

Habilitacioni i dr. Martin Camajt si doçent n'albanologji

nga REDAKSIJA



Dr. Martin Cama

Familja e «*Shëjzavet*» u gëzue në dhetuer të vjetit 1964 nga një fitore e madhe në lamijet kulturore, një fitore jo vetëm e së përkohëshmes por e mbarë gjindes shqiptare. Patem darsëm, një darsëm intelektuale me të cilën kremtuum marrjen me sukses nga kryeredaktori i ynë, *dr. Martin Cama*, të habilitacionit për doçenzën n'albanologji n'Universitet të München-it. Ngjarja merr një theksim të rand-sishëm sepse studjuesi i rí shqiptár, tue hým në radhën e doçentave të njânit prej Universiteteve mâ të çmueme të botës sidomos për sá i përket balkanologjis, do të mundohet me përtrí traditat e mëdhaja gjermane në sferën albanologjike, shkencë së cilës i vûni themelet në qindvjetin e kaluem Georg v. Hahn qi me të drejtë quhet *Ati i albanologjis*. Rrethâna të ndryshme e kishin ndërpré veprimtarin e Universitetit të München-it në degën e studimeve shqiptare. Historjani zámadh prof. Franz Babin-

ger vazhdon në veprat e veta me ndriçue sa mâ tepër mëndoret shqiptare t'errta e të ngatrrueme të qindvjetave XV e XVI ashtu prof. Georg Stadtmüller përpiqet të shtojë njohunít mbi ngjarje të qindvjetave mâ të vonë të historís s'onë, por deri tash mungonte një qandërr gjermane qi t'i u kushtohej veçan studimeve shqiptare. Në Lipsia i paharrueshmi prof. Lambertz, nonse shum i shtým në moshë, e mbajti gjallë me zéll e qendrim kejët t'admirueshëm deri vonë veprimtarin albanologjike por, si Atë e ngrini mardha e vdekjes, albanologjija në krejt Gjermanín s'pat mâ një kathedër pagëzue n'emën të vet. Këndej ra-

ndësija e habilitacionit të dr. Camajt dhe emnimi i tij si doçent i albanologjis n'Universitetin e përmendun të München-it.

Martin Camaj lindi me 21 korrik 1925 nga një familje e njoftun të Dushmani' (Dukagjin) e qyshë në vjetët e parë shkollorë u dallue për mende të mprehtë e dishir me zgjã njohunit e veta në degë të ditunis. Kreu mã s'miri studimet e mesme në gjymnazin klasik t'Etënvët jezuitë në Shkodër, qi qe shum i çmuem për methudhë e acarim ndër mësimë (ku i vùnë themelet e kulturës së tyne edhe Luigj Gurakuqi e Faik Konica). Ngjarjet e rrebtã të mbasluftës e shtrënguen Camajn si shum të tjerë të rij studjuesa të lãjë atdhën e të nisi me rrahë udhët e vishitira të mërgimit. U nëshkrue në Fakultetin e Filozofis t'Universitetit të Beogradit, tue e marrë liçenzen mbas katër vjetvet me një punim krye nën udhëheqjen e linguistit të famshëm Henrik Bariç. Gjatë qindrimit në Jugosllaví mori pjesë me dallí rinore në lindjen e mrekullueshme të letrësis kosovare me vepra qi tashmã xanë vend në zhvillim të saj bashkë me ato të shkrimtarvet kosovarë mã në shëj, të cilët Martinin e njehin të tyne. Dhe me të vërtetë dý përmbledhjet vjerrshash «*Nji fyell ndër male*» (1951) e «*Kãnga e vërrinit*» (1954) si edhe «*Djella*» botue në Romë me 1958 i përkasin, — për frymë qi i dallon dhe shqetësim shpirtnuer bashkue me një dishir të ndezët pallingjeneze vetiake e shoqnore, — rrethit letrar të Kosovës e radhiten në numër të produkteve letrare typike të tij.

Përveç artikujvet me subjekte të ndryshme botue në shtyllat e kësaj së përkohëshme, letrari i ynë botoi me 1964 një tubë poemthash, krejt origjinalë, nën titullin «*Legjenda*». Këtu arti i tij jep dishmí të qartë pjekunije. Nji dishir i avullueshëm m'u lëshue n'andrrime prallzore përsjellë gjithëkund me një ndiesí t'idhët se jeta nuk zhvillohet në hullí të trilleve të fantazis, ásht karakteristika kryesore e legjendave. Bota e vjetër mythologjike e maleve t'ona sherben si pikënisje për fluturime lyrike me trajtën e frymën mã moderne. Motive gojdhânore të lashta lulzojnë në kët poezí të ré, ku ngashërim e rrëmbim, klithime të një mjerimi të mbytun e tinguj magjikë të një muzike së nënzâshme, qi përshton palcin e vargjeve, shkrihen lumnisht, të metamorfozuem nëpër mjet të një shije në përkim me atë të poezis së sotshme botnore ku landë e trajtë thjesht shqiptare paraqiten në një dritë së papritun letrësisje së guximshëme bashkëkohore.

Nga Jugosllavija Camaj erdhi n'Italí me qellim të specializohet n'Universitet të Romës në degën albanologjike. Mbas pak kohe u emnue Lektor vullndetar pranë Institutit të Studimeve shqiptare të Fakultetit të Letravet e të Filozofis. Në ndërkohë, bashkë me shokë tjerë, shqiptarë e arbreshë, themeloi të përkohëshmen «*Shëjzat*». Ndoq rregullisht në Romë për disã vjet me radhë mësimet e Fakultetit të Letravet e të Filozofis dhe u kunorzue me larin akademik tue rrahë përpara Komisionit të Laures thezën me titull: «*Il Messale di Gjon Buzuku (Contributi linguistici allo studio della genesi)*». Unanimisht Komisioni i dha votat e plotã të cilave u shtoi lavdin, mbi propozimin e Prof. Maver, relator i dytë i thezës. Dijetarë në zã si proff. Pagliaro, Schirò, Picchio etj. miratuen veprën gjuhsore të Camajt. Por nuk u kënaq me suksesë të korrura në Jugosllaví e në qarqe universitare t'Italis. Qiti cekën me u thëllue në gjuhësi edhe në një qender studimesh me emën të madh si ásht Universiteti i München-it sidomos, po e përsrisim, në

studime qi i përkasin Europës jug-lindore. Kuptohet vetvetiu se për të marrë habilitacionin lypej më së pari njoftja e gjuhës gjermane. Në pak vjet Camaj, me një përpjekje kryeneçe ku shkelqen natyra e fortë e brumit të maleve shqiptare, u vù në gjendje me përballue me at gjuhë çdo provim. Punoj për pesë vjet pa i falë vetes asnjë ças frymëmarrje pushuese, nën drejtimin e indo-germanistit të shquem prof. Wilhelm Wissmann, mbi themën « Formimi i fjalve të vjetra shqipe » (*Albanische Wortbildung - Die Bildung der ältere Nomina*). Natyrisht tema përfshin edhe lidhjet e gjuhës shqipe me gjuhët balkanike. Camaj i fortë në gjuhët klasike e neo-latine si edhe në slavishte, e me njoftje të plotë mbi shkrimet albanologjike të gjermanvet, kishte tashmë veglat me i a hË zhvillimit të themës së vishtirë.


Colloquiu-mi u mbajt me 9 dhjetor 1964 para një Kolegjiumit ku mirshin pjesë të gjithë titullarët e Fakultetit të Filozofisë të München-it nën kryesinë e dekanit Prof. dr. Hans Müller e ku dijetarët më të spikatur për landën e provimit ishin, posë prof. Wissmann-it, edhe profesorat Alois Schmaus (slavist e bakanolog), Georg Stadtmüller (historian i Shqipërisë dhe specialist i historisë evropjane jug-lindore) e tjerë mjeshtra të përmendur. Pyetjeve të shumta, kandidati u dha përgjegje të plotë. Më tepër pyetjet u sollën rreth metodikës në përkim me studime shqipe e balkanike.

Kaluar me lavd prova para Kolegjiumit provimtar, dekani prof. dr. Müller caktoi aty për aty ditën e referatit publik me këtë themë: « *Refleksjet e Kanunit të Lek Dukagjinit në epikën popullore* ». Edhe kjo provë u kaluar më së miri para një publiku të zgjedhur miqës, nxansish, kolegësh qi deshten me praninë e vet t'i a shfaqin doçentit të ri admirimin e sympathinë e tyre; ndër këta edhe disa shqiptarë qi banojnë në Gjermani. Në referat gjajta qi bëni përshtypje qe krahasimi i skajëve kanunorë (terminologjia) të shqipes me ata të Malit të Zi dhe përpjekja për caktime kronologjike në zhvillim të Kanunit nëpërmjet mjeteve gjuhësore. U vù në dukje edhe vlera e hulumtimeve mbi ligjëtarë dokesore të Padre Valentinit, veprat e të cilit janë shumë pak të njoftuna nga etnologët balkanas.

Dr. Camaj, si kreu referatit i ndjekur me vemendje të paprëme nga ndegjuesit, u përgëzue nga mjeshtrat e nga miqtë e dashamirët qi aty gjindeshin pranë.

Tashti doçenti i ri i a ka hË punës së rregullt tue vazhduar kursin e shqipes dhe tue bashkëpunue me kolegët tjerë në lamije të studimeve bakanologjike.

Kryeredaktorit të *Shënjzavet*, mikut e shokut e kolegut, na, redaktorët e bashkëpunorët e së përkohëshmes, i drejtojmë urimet t'ona vëllaznore për një karrjerë të ndritëshme universitare në dobi e në lavdi të vet e të Shqipërisë dhe lusim Zotin t'a kemi pranë nesh shumë vjet në fushën e printarit kulturorë.



Per historín e arsimit shqiptar

nga KARL GURAKUQI

1. Shkolla Fretnore (1885)

Shtypi i Shqipnis, revistat dhe fletoret qi botohen në Tiranë, dihet se janë të frymzueme prej paragjykimesh, sikursë e kemi thëksue e dokumentue edhe tjetër herë, por me gjith këtë, shdrejtazi, aty-këtu, i bájne një shërbim historís s'arsimit shqiptár. Përkujtohen përvjetorë hapjesh shkollash në periudhën e rilindjes, themelime shoqñish kulturore e shoqnore, kujtime personalitetesh të dallueme në fusha të ndryshme. Fatkeqsisht në ket shtyp shifen disá mungesa të rânda: nuk na ká rá syni, apo vetëm shkel-e-shko, të përshekruhen e të qiten në shesh vlerat e Shkodrës, qi ká qënë qendra e kulturës shqiptare. Nuk kemi vù ré, për shembull, n'asnji nga revistat e fletoret e atjeshme të bâhet fjalë për dy institutet má me rândësi e má në zâ të Shqipnis, d.m.th. për Institutin Saverjan të Jezuitvet dhe për meritimet e Institutit të Fretënvet shqiptarë.

Gjurmët e Françeskanvet në viset shqiptare mund t'i shpiejmë historisht sëpaku deri në vjetin 1283 (1), tue mos marrë para sýsh legjendën, simbas së cilës Themeluesi i Urdhnit të tyne, Shën Françesku i Asizit, tue kthye nga Sirija në vjetin 1219, paska qënë ndalë në Lezhe dhe aty i paska pasë vù themelin e Urdhnit të vet në Shqipni, dhe se paska pasë bâ qi të ndërtohej Kisha e Kuvendi, qi shifen edhe sot maje nñij kodrine në krah të djathtë të rrugës tue shkue prej Shkodre në Tiranë, kundruell Urës së Drinit, qi rrjedh aty poshtë. Kuvendi i Lezhes në kohët t'ona pat qënë smadhue me një krah të rí, projektue nga dora vetë e Gjergj Fishtës, ku Poeti kishte zakon të mënjanohej për të punue në qetsí vjershat e veta. Kânga XXVI e «Lahutës së

(1) Në veprën e Dr. Ludwig von Thallöczy-t «*Illyrisch-Albanische Forschungen*», Vëllimi I, vjeti 1916, faqe 280, në mes të tjerave ducet lexojmë: «Im Jahre 1283 gehörten ihre Missionen in Cattaro, Antibari, Dulcigno und Durazzo unter die «*custodia Ragusina*». Damals führten der Domenikanerprior und der Minoritenguardian von Ragusa als Vertraute des Papstes ein bedeutendes Wort in den wichtigsten Kirchenangelegenheiten Nordalbaniens. Die erwähnten Missionen erweiterten sich bald zu ordentlichen Klöstern. In Scodra und Dulcigno errichtete (1288) Helene, Gattin des Königs Uroš I., den Franziskanern je ein Kloster mit Kirche; ... in Durazzo wurde 1398 das städtische Originallinstitut bei den Franziskanern (*apud Fratres S. Francisci*) bewahrt Ljubici, Listine 4, I 414).

Malcís » me titullin « *Koha e Ré* » u fillue dhe u mbarue së përpiluemi në ket Monastír, prej kah Fishta i lëshon zâ Zanës për t'i ardhë në ndihmë:

« *Behma ktu n'ket Lissus t'vjetër*
Ku, larg zhurmës e poteret,
Dola edh'un n'ket buzë prendveret,
Për me kndue n'« Lahutë t'Malcís »,
Se si u end fati i Shqypnis,
Kúr pshtoi kthetrave t'Shkjenis
E duel zgjedhet të Turkís:
Perendija si e kish shkrue . . . » (2).

Në të XIV shekull Françeskanët e Shqipnis, qi ishin pothuajse të gjith vendas, u shkëputën nga auktoriteti kishtar i Raguzës dhe themeluen një *Kustodí* në vete në Durrës (*Custodia Duracensis*); kjo kishte nën varunin e vet trí Kuvende: n'Ulqin, në Shkodër e në Tivár (3). Prej Tivari, prej Ulqini, prej Shkodre e prej Zadrieme u përshkuen nepër Mirditë, kaluen në Macedoní, ndanë fatin e vet me popullsin e Pultit, të Kastratit e të Malit të Zí. Por nga trazimet dhe turbullimet qi ngjanë në vendin t'onë prej pushtimit turk, Fretnit qenë të shtërnguem të tërhiqeshin nga qytetet e të nguleshin në viset e mbrendëshme t'Atdheut, në katundet ku nuk mërrijnte urrejtja dhe salvimi otoman e në malet e thepisuna, në mes të popullit, për të mbajtë gjallë fén e atdhén. « *Fé e Atdhé* » qe kurdoherë kryefjala e tyne deri në ditë të sotme.

Nuk e kemi mendjen të përpilojmë historín e Fretënvet Shqiptarë; janë të tjerë má me kompetencë për t'i a hÿ kësaj pune. Hulumtuesi i zellshëm, Át Marin Sirdáni (vdekë në Shkodër në vjetin 1962) më kishte pasë thënë se e kishte pasë vû at új në zjarm; dishka pat shkrue edhë në revistën « *Hylli i Dritës* » andej kah vjeti 1940. Nuk e besojmë t'a ketë vijue, e në rasë se po, kushedi ku ká mbarue dorëshkrimi mbas vdekjes së tij.

Deshtëm vetëm të thomi se Fretnit mund do të kenë pasë në Shkodër një Kuvend në shekullin XIV, por nuk i ndigjohet zâni deri në vjetin 1857. Me siguri dihet vetëm se ata bijshin në Shkodër prej katundevet sá për kalim. kúr zbritshin nga malet për çashtje jetese e bujshin nepër shtëpijat e bâmirësve qi i qitshin dhe i pritshin me ándje.

Tue qënë se Shkodra ishte qendra ku ata zhvillojshin veprimtarín e vet besimtare dhe kulturore, u pá përsëri nevoja e rithemelimit të njij kuvendi, mbasi edhë qeverija turke në kohët e mávonëshme u bá má dorëlëshueme. Prej njij letre s'epishkopit të Shkodrës, Emzot Topçit, qi në vjetin 1857 i dërgonte Kryetarit të përgjithëshëm të Françeskanvet në Romë, marrim vesht se ndërtesa qi u caktue për Fretnit

(2) Të shifet botimi i dytë i kryeveprës fishtjane, bá në Romë në vjetin 1958 nga Át Danjel Gjeçaj, faqe 607-622.

(3) Krahaso librin « *Serbët e Shqiptarët* » nga Dr. Milan Sufflay. kaptinën VI, faqe 27, përkthim nga slavishtja prej Zef Fekeçit e Karl Gurakuqit në vjetin 1926, Shtypshkroja « Luarasi » Tiranë.

e malcis në Shkodër që Seminari i vjetër, i cili kishte pasë qënë blé nga Emzot Albertini për selín ipeshkëvnore. Kjo ndërtesë u që lëshue má vonë nga Emzot Guljelmi 14 familjeve shkodrane katolike në shkëmbim të shtëpís ku sot áshjt selija e krye-epishkopit të Shkodrës pranë Kishës së Madhe në Serreq. Këto familje, tue vrejhtë qellimin e mirë për të cilin do të përdorej Seminari i vjetër, u lanë këtë pá u kërkue as të holla as shpërblim. Gjendja e shtëpís ishte si mos má keq. Qi të báhej e përdorëshme për Kuvend, shifej nevoja të meremetohej, e për ket meremetim lypeshin kund 500 apo 600 skuda (4).

Emzot Topiçi kishte pasë vendosë qi t'u a lëshonte në dorë Fretënvët, përveç shërbimit fetár, edhë arsimin filluer të fëmijvet të qytetit. Në letrën e naltpërmendun të këtij epishkopi të vjetit 1857 lexohen këto fjalë: «Përsá u përket mjetevet për mbajtjen e këtij Kuvendi, përveç ndihmës qi Fretnit do të kishin nga banorët katolikë, do të mujshin me marrë përsipër edhë mësimin e kalamajvet, të shpërndamë nepër shkolla lagjesh (5), qi mbaheshin prej mësuesish n'e moçme. Për ket qellim kam nxjerrë një ndihmë vjetore prej 1200 florintash nga Madhnija Apostolike prendore mbretnore » (6).

Ku do të zhvilloheshin mësimet kursë Fretnit nuk kishin një ndërtesë të posaçme? Disá vjetë má parë populli katolik i Shkodrës u kishte pasë falë Françeskanvet dý oda shtëpi në lagjen *Gjuhadol* për t'a përdorë si banesë, si bujtinë për misjonarët. Këto dý oda qenë nisërza e atij Instituti kulturuer, qi nën emnin «*Lyceum Illyricum*» i solli aq të mira arsimet kombtár derisá në vjetin 1944 erdh rebeshi i madh qi fshini çdo gjurmë të veprimtarís kulturore, fetare e kombtare fretnore.

Në një kumtesë qi Konsullata austriake e Shkodrës i dërgonte ministrís së jashtëme në Vjenë me 4 korrik 1863 përshkruhet fillimi i Shkollës së ré, të cilën vetë populli e quejti «*Shkolla e Fretënvët*» e má vonë «*Shkolla e Pater Gjergjit*»: «Qysh prej vjetit 1855 — thotë kumtesa — gjindet në Shkodër një shkollë fillore. Kjo má parë ishte në dorë të mësuesvet civilë të lagjevet; pastaj u pá nevoja e misjonarvet françeskanë. Mësimi në këtë shkollë áshjt i ndamë në katër klasë e mësohen këto lândë: besim, arithmetikë, bukurshkrim dhe elementet e para të gramatikës italjane. Ky Institut áshjt i ndihmuem prej mirsis së qeverís s'onë auguste me 1260 florinta të valutës austriake, ashtu edhë nga Shoqnija bámirse fetare «*Të Zánunit e pafaj të Zojës*». Prej këtyne ndihmave — vijon e thotë kumtesa — dalin shpenzimet për mbajtjen e për banesën e mësuesvet. Përpara dy muejsh i nënshkrue-

(4) Burimet për ket studim i kam pasë nxjerrë nga libri «*A volo d'ucello - Missione Francescana in Scutari d'Albania*», Tip. Artigianelli, Milano (pá datë botimi).

(5) Mbi këto shkolla do të shkruiej përsëshpejti.

(6) Ky ishte titulli i perendorit t'Austrís, qi kishte nën mprojtje klerin katolik shqiptár. Qeverija e Vjenës áshjt kujdesë gjatë shumë vjetve për të mbajtë në kámbë famullit e shpërndame nepër viset veriore, qi ishin çerdhe kulture dhe atdhetarije.

mi pat qënë ftue në provimet e nxânsvet dhe në ndamjen e çmimevet, qi u krye nga Emzot Çurçija, ipeshkëv i Shkodrës» (7).

Shkolla Fretnore kishte marrë një rrugë të mbarë, sâ qi në vjetin 1867 Emzot Pooten (8) e pau nevojën e shtesës së numrit të mësuesvet, prandaj pat kërkue qi ndihma e 1260 florintave të shtohet në 1560 për çdo vjet për t'i bâ ball rrogës së njëj mësuesi të katërt. Kërkesa u pranue menjherë pse kishte mbështetjen e Konsullatës Austriake. Ndihma ndahej këso dore: 600 florinta i mirrshin Fretnit, kursë të tjerat i jipe-shin një pjesë *Gjergj Benushit* (mâ vonë *Gaspër Benushit*) e një pjesë tjetër dý zojshave shkodrane, qi mbajshin një shkollë për punë dore për vajzat e rritëshme të qytetit, njëna e të cilave pat qënë Tina e Nikës.

Sâ mâ shum kalonte koha aq mâ tepër shtoheshin nxânsit, e, natyrisht, aq mâ të mëdhaja bâheshin nevojët shkollore, për ketë arsye u pâ e domosdoshme a të smadhohej lokali shkolluer apo shkolla të shpërngulaj në ndonji shtëpi mâ të përshtatshme.

Simbas marrëveshjes së bâme në vjetin 1875 ndërmjet Romës dhe epishkopatit të Shkodrës, Fretënvët i u dha një ndërtesë tjetër për banim, d.m.th. shtëpia ku deri tash sëvoni gjindej Kuvendi i Fretënvët të lagjes Gjuhadol bashkë me Bibliotekën e tyne, edhë kjo projektue nga Fishta. Ndërtesa gjindej në mes të qytetit, rreth e rreth kishte një vend të hapët, prandaj u qit mendimi qi në trollin e saj të ngrihej ndërtesa shkollore. Për përballimin e shpenzimevet të ndërtimit qeverija austriake dhuroi 3.000 florinta (9). Në vjetin 1876, prá një vjet mâ vonë, «*Vepra bâmirse e Lionit*», tue pranue kërkesën e Kryetarit të Përgj. të Fretënvët në Romë, dërgoi një ndihmë prej 3.000 frankash. Me ketë shumë u qitën themelet, u naltuen muret, por puna ngeli për gjymës, derisâ u gjetën burime të tjera: Vatikani dhuroi një sasî të mirë të hollash, Kryesija e Fretënvët në Romë fali 3.200 fr., Ipeshkëvijt shqiptarë dhuruan 3.300 fr., Fretnit vetë dhanë 2.200 fr., nga pasanikët e Shkodrës u mblodhën 4.000 fr. Me këto të holla e me ndihmën e qytetarvet në lândë ndërtimi, Françeskanët hýnë në shtëpinë e ré në vjetin 1877, ku vendosën edhë shkollën.

Menjherë u vû ré një përparim i dukshëm në zhvillimin e mësimvet, në ndjekjen e rregullshme të nxânsvet, në shtimin e tyne, kaq sâ në vjetin 1884 Fretnit patën qënë shtërngue t'a zgjânojshin shkollën edhë mâ (10). Nevoja e zgjânimimit u trefishue, pse, përveç banesës së Fretënvët dhe vendosjes së shkollës, u hap edhë *Kolegja Françeskskane*; kati përdhorë u përdorë si kishë (11). I u vû prá syni njëj shtëpije së vjetër, kufitare me kopshtin e Kuvendit. Mendimi ishte pâ tjetër i

(7) Nga ish-arkivi françeskan i Shkodrës, të cilin e shfletova nepër mirsin e Át Pashk Bardhit, ish-mësues i emi në gjimnaz.

(8) Në ket vjet si krye-epishkop i Shkodrës pat ardhë Emzot Pooten.

(9) Prej ish-arkivit ipeshkëvnuer të Shkodrës.

(10) Këto lajme i pata nxjerrë prej njëj letre s'Át Pashk Bardhit, të cilat i a pata kërkue për një studim qi botova në revistën «*Diturija*» të Midat Frasherit në Tiranë (Vol. III. Janár 1928, nr. 3, faqe 88-95).

(11) Nuk ishte ndërtue endë Kisha e madhe e Fretënvët të Gjuhadolit, e cila i hapi dyert për shërbimin fetár në vjetin 1908.

dobishëm, por zbatimi ishte i vështirshëm, pse shtëpija kushtonte shumë e mjetet ishin të pakta. Por edhe kjo pengesë u kapërcye prej bujarisë së Kryesisë Françeskane në Romë, e cila i mbuloi shpenzimet e blemjes. U bënë meremetimet e nevojshme, dhe pranë saj u ndërtue një salon i madh për çfaqje teatrore, për konferenca e për mbledhje të ndryshme.

Në vjetin 1899 shkolla pat qënë pajue me programe të reja e më të plota; ndërtesës i u shtuen edhe tri kthina të reja: dy si oda mësimi e një për drejtorin e shkollës. Në vjetin 1901 u ndërtue n'oborrin e shkollës një *treme*, ku nxânsit të mujshin me u argtue në mot të lig. Në vjetin 1916, pranë kësaj tremje, në një barrakë u vendos *Shtypshkroja Françeskane*, e cila në vjetin 1941 mori emnin «*Shtypshkroja Fishta*».

Këso dore qindroi puna deri në vjetin 1902-1903, d.m.th. derisâ u emnue si drejtuer i Shkollës Gjergj Fishta. *Nën drejtimin e këtij kjo mori një rrugë krejt të ré: më sëpari u hoq krejtësisht italishtja që deri atëherë kishte pasë qënë gjuha e mësimit dhe u zâvendësue me shqipen; mësimet, në mbështetje të programevet të reja, kishin për qëllim zgjimin e ndiesivet kombtare; përveç klasvet fillore pesëvjeçare u shtuen edhe dy klasë të tjera qytetse simbas programit të shkollavet t'Austrisë; u sollën prej së jashtëmi vegla mësimore, kabinetet e fizikës e të kimisë, vegla muzikore, ndër të cilat edhe një pianofort.*
2. 60 vjetori i Shkollës së Natës (1904).

2. 60 vjetori i Shkollës së Natës (1904)

Në këtë atmosferë ndriçuese u rrah çashtja e organizimit të djelmnis jashtëshkolllore në një Shoqni që të përmbliidhte rinin që s'kishte pasë fatin t'arsimohej e t'edukohej simbas parimevet atdhetare. Në Shkollën e Pater Gjergjit veprojshin si mësues dy pjonjerë t'idës kombtare, veterani i arsimit *Matë Logoreci* dhe arsimtari i vlefshëm *Ndue Paluca*, përveç Gaspër Beltojës e Gaspër Mikelit, të gjithë të përgatitun për misjonin e mësuesis, pedagogë të çmueshëm dhe atdhetarë të mirë. Këta, me në krye Fishtën, bënë një hap, që për atë kohë ishte shumë i guximshëm: *Rinija e organizueme* që nën një qeveri absolute që nuk i njihte Shqipnis asnjë të drejtë kombtare ishte një andërr e pasendërtueshme: kudo pengime, në çdo skutë prita, në çdo anë nënkâmbca, për të ndalue një nismë, e cila mund do të kishte përfundime të rrezikshme. Shkollat shqipe, klubet, shoqnitë e organizueme, mbledhjet botore, ishin halë në sy për qeveritarët turq, por besa edhe për një palë Shqiptarë që nuk e dojshin ndrrimin e gjendjes. E mbandej *Shkolla e Natës* e vjetit 1904, me Fishtën e Logorecin si organizatorë, ishte një gjâ që nuk mund të falej; *kanë dalë qemerit* thojshin e murmurojshin.

Shkolla e natës nisi të mirrte hapët: çdo mbrâmjë djelmt e rij me shumicë të madhe, mbas punës së ditës, ngarendshin në ndërtesën e teatrit për të ndigjue mësimet e shqipes. Nuk ishte vetëm shqipja që mësohej; aty çdo natë rinija kënaqej tue ndigjue fjalën e rrjedhëshme, tërheqse e plot anekdote të drejtorit të shkollës. Përveç mësimit të leximit e të shkrimit shqip simbas alfabetit të «*Bashkimit*» jipeshin njoftime historije e gjeografije shqiptare, mbareshin konferenca, deklarimoheshin vjersha auktorësh të ndryshëm; vlonte kënga e muzika deri n'orët e vona të mbrâmjes. Kështu më tregonte i ndiemi vëllau

i em Lazri, një tjetër frymzues i kësaj ideje, mik i ngushtë e bashkë-puntuer i Fishtës dhe i Logorecit.

Rá në sý kjo lëvizje. Filluen thashë-e-thanat. Dijekëqijt nuk mungojnë kurr; përhapën fjalën se aty báhej propagandë përçamjeje vëllaznore, se në këtë punë kishte gisht ndonji qeverí e huej; nuk munguen edhe asish qi i paditshin organizatorët e shkollës si mendimtarë të lirë me idé kryengritse politike e shoqnore; ndjeksit e shkollës i cilsuen si një riní kryekëcyeme, antifetare. Edhë ndër familje gjarpronnte propaganda anti-fishtjane e anti-françeskane. U mbush kupa e këtyne spílçavet me 1 máj 1906: Logoreci me Palucën organizuen për atë ditë një piknik jashtë qytetit në Bardhanjorë, ku gjinden vëneshtat e Shkodranvet; në ket piknik qi mori trajtën e njëj demonstrate, morën pjesë, përveç nxánsvet, edhe djelmoça të tjerë, puntorë e sidomos shegerta (çirakë) tregtoresh. Dita pat kalue në një atmosferë vëllaznije në mes kángësh, lojnash e pijesh me meze; në mbrámje vonë, tue këndue e tue u rá veglavet muzikore, kaluen nepër lagjen Serreq e u shpërndanë në shkollën e Fretënvët gëzueshëm e të kënaqun. Dita 1 máj shenoi gjykimin për vdekje të shkollës. Dita 1 máj, ditë e të pafetvet, e socjalizmës afetare, mendime tepër të shtëjme, prishja e ndërëgjegjes fetare të popullit! Rridhshin kohë të tjera; sot vetë Vatikanin e ká caktue ditën e parë të majit si ditën e puntoris, dita e Shën Jozeftit, pajtori i puntorvet. *Tempora mutantur et nos mutamur in illis!*

Përfundimi? Konsullata austriake në Shkodër, e shtëjme nga të dyja elementet besimtare të qytetit, madjë edhe nga një pjesë e klerit katolik, shkroi aty ku lipsej, qeverís së Vjenës, e cila paguente mësuësit e shkollës frennore, për të marrë masat e rasës. Matí Logoreci u shpërngul si mësuës i shqipes në Prizrend, kursë Paluca u emnue si mësuës në Shkollën Normale të Borgo Erizzo-s, për të vijue veprën e fillueme nga para-ardhësit e tij, Át Shtjefën Gjeçovi dhe Át Pashk Bardhi n'atë koloní arbreshe ku ruhet edhe sot gjuha e zakonet shqiptare.

Edhë dý fjalë përpara se t'i jipet fund këtij përshkrimi: me djelmoshat e Shkollës së natës Fishta i dha jetë njëj «*grupi theatruer*», i cili herë pas here kënaqte popullin me çfaqje dramesh, melodramesh e komedísh, të punueme nga vetë Fishta asë të përshtatuna nga gjuhët e hueja. Po përmendim disá nga këto: «*Vëllaznija*» asë «*Françesku i Asizit*», «*Nevoja e Mësimít*», farsa «*Pata*», «*Shqiptari Qytetnuem*», operetat «*Shkolla e Muzikës*» dhe «*Darka në Konvikt*», melodrami «*Juda Makabé*», melodrami «*Jerina asë Mbretnesha e Lulevet*», komedít e Molier-i «*Dredhít e Patukut*» dhe «*I Ligu për mend*» të përshtatuna në shqipen. Jo vetëm Fishta, por edhe të tjerë dhanë ndihmesën e vet, si p.sh. Zef Harapi me dramën «*Dedë Gjo Luli*», Filip Fishta me dramën «*Gjin Bue Shpata*», etj. Këto çfaqje jipeshin në sallën e theatrit, qi përmendëm má përpara. Kjo mund të quhet nisërza e theatrit t'onë kombtár me një program të caktuem. Me këtë nuk duem të thomi se edhe má përpara kanë qënë dhënë çfaqje theatre, por ato ishin sporadike. Dihet se në vjetin 1879 Kolegja Saverjane e Jezuitvet e paraqit në publik me një argtim poetik-muzikuer e me farsën «*Macco*», përshtatë zakonevet t'ona.

Në grupin theatruer të Shkollës Frennore patën qënë dallue si aktorë të talentuem Zef Hila, Lazër Gurakuqi, Gjon Krajni e ndonji tjetër.

(vijon)

Vendi që i përngjante nji zgjoni bletësh

nga MARTIN CAMAJ

Shumica e banorve të atij vendi të vogël mirrej me bujqsi sepse toka gjithkund 50 km. për rreth ishte shumë e plehëshme; më andej fillojshin naltsinat, male e kodra gurore. Ata pesëdhjetë vetë që ushtrujshin tregtinë si dhe hoxha në një anë dhe prifti në anën tjetër, bashkë me njëzet a tridhjetë nëpunës, pjesa më e madhe mësuesia dhe edukatorja të shkollës fillore dhe të gjysë-gjimnazit, të vendosun në kazermën e vjetër të ushtrisë, gjithashtu dhe tarikati i zejtarve e quejshin me andje këtë grumbull banesash *qytet*.

Ditën e merkurë prej maleve të thata për rreth zbritshin malsorët tue ngrehë për laku lopë, dele, dhë e mushq të ngarkuem me djathë, tlyen, lesh e lëkura, arra e lejthija si dhe drû e qymyr, secili si mbas mundësisë e gjendjes së vet shtëpijake. Në sytë e të huejit, që vren për të parën herë këtë eksodë, mund të dallojsh habinë: a është e mundun të pjellin shkambijt gjithë at mori njerzish me rraçe e bakti? Malsorët at grumbull banesash e quejshin *paazar*. Ngjarjet që kanë ndodhë ditëve të tregut në këtë paazar janë të shumta, sepse aty ku mbliidhen shumë shqiptarë bashkë ngjân gjithmonë dishka. Ndoshta një ditë kam me tregue ndoj send dhe mbi këto ndeshtrasha apo ndodhje syntomatike, por sot nuk e kam ndër mend të merrem me këso rrethanash që më kanë mbetë në kujtim nga koha e shkurtë që kalova në këtë vend.

Due të theksoj se në këtë folë shqipesh kam lanë ndonji dashamirë dhe më merr malli ta shof edhe një herë këtë vend, sidomos për të pa përparimin që do të ketë bërë prej asaj kohe. Due të shfaqim haptas se shumica e banorve nga fillimi më mueren me sy të keq, sepse unë në ditët e para thashë botnisht, në kafe nësa hajsha bukë, se ai vend nuk e meritonte emnin qytet. Këtë mendim qeshë i shtrënguem ta shfaqim mbasi qeshë i pyetun haptas, në praninë e njerzve më të dalluem t'atij vendi. I pari reaktion që një izolim i plotë që më kurdisen vendasit, si hakmarrje; për këtë arsye qeshë i shtrënguem të ndrrojsh në një kohë të shkurtë katër a pesë banesa. Të dytën herë, për t'i tregue të gjithë atij vend se unë kisha një personalitet temin, shfaqim haptas në kafe në kohë të bukës se ai vend nuk mund të quhej qytet kurrën e kurrës, deri sa ai ka më shumë gjela se sahata. E me të vërtetë ai vend kishte shumë gjela! Ata e nisëshin kangën një herë mbas mjesnate, njëkohësisht, tue ndjekë shembullin e njani tjetrit, e mandej me një pushim një një ore e gjysëm, pa ia nda kështu deri sa dilte drita e madhe.

Vendasit, të mësuem me këtë kangë ç'prej djepit, mundëshin me

fjetë qetsisht, nësa i hueji — si unë — nuk flente as tri orë në natë. Posë kësaj isha edhe i vetmuem krejtsisht dhe për të huejin në vend të panjofitun vetmija është burimi i të gjithë nostalgjisë për vendlindjen. Kështu qeshë i shtrënguem të kryej më së miri detyrën teme, jo për dashun për punë, por që mos t'i jepsha kuj shkak për të më bërë keq. Kohën e lirë e kalojsha në lexime gjithfarësh dhe rëmime e këcime fantazije. Për të parën herë u kujtova se kisha pasë një femini. Që, si qe puna. Për ballë banesës, ku pata jetue herën e fundit, shifej një pemishtë e vogël, në krye të cilës ngrihej një shtëpi dy ketësh, e vogël, me balkon përjashta mbushun me lule, gjë e rrallë në at vend. Oborri i saj ishte plot e përplot me zgjoje bletësh, të cilat kur binte dielli bājshin me ushtue të tana skajet e skutat e shtëpijave për çark. Njeriu që sillej gjithditën në at vathë bletësh ishte një burrë i vjetër, i gjatë e i thatë, gjithmonë me një shall dy metrash për qafë. Kur nuk kisha punë tjetër për të kaluar kohën, vëjsha të dy brrylat mbi murin e ultë që ndante rrugën nga vathi i bletëve dhe ash'u i pështetun, vrejsha endjen e bletëve, si për avlimendi mes qiellës dhe dyerve të vogla të zgjoje. Mbas disa ditëve m'u avyt i zoti i bletëve, ai plaku, e mbasi më përshëndeti, më pyeti — A je marrë ndoj herë me bletë? — tue bërë një buzëqeshje të tillë që zbulonte mbushmendjen e tij se unë nuk kisha farë njoftunije në atë punë.

— Është e vertetë — ia prita — se nuk di shumë mbi bletë. Por — vijova me një heksim të ashpër — im atë dhe ungi kishin me qinda zgjoj. Unë jam rritë ndër bletë!

— A ashtu? — m'a kthei ai tue mrralë vetullat e gjana.

Tue e vrejte më mirë, më bëni përshtypjen e një brumbulli që jeton në shpinë të bletëve. Nësa kërkojsha me mend një përshëndetje lamtumire, duel papritmas mes meje e tij një vajzë kund njëmbëdhjetë vjeçe.

— Ky është mësuesi i ri, papë — tha ajo tue çue kryet kah i jati. — Ai që lot *fumboll* me djelmt e shkollës së naltë.

Plaku shkoi ndër bletë dhe unë mbeta me vajzën e vogël. Asaj pa të jatin pranë iu mbyll goja dhe me mëzi më tregoi si e quejshin dhe se të cilën klasë ndiqte.

Për disa ditë u kondendova të ndjeku endjen e ushtimën e bletëve nga balkoni i banesës sime, deri sa Jesmina e vogël nisi të më përshëndesë me një rubë të kuqe mes zgjoje. Ndodhi kështu pra, që ditë për ditë aty e mbrapa ndalesha nga një gjysë ore dhe vrejsha bletët pështetun me brryla mbi murin e ultë që dante rrugën prej pemishtës. Andej murit avytej dhe Jesmina dhe pa qitë fjalë goje vrente me mue fjetë e arit mes qiellës e dheut.

Një herë m'u suell e më tha:

Ebbene, vige ancora il medesimo valore, il medesimo spirito belligero in questo popolo guerriero, e mescola nella sua rozzezza la religione alla bravura, conservando la prima intatta e la seconda nobilitando. Il montanaro Albanese, l'abitante di Hoti e di Gruda, di Mirdita, di Croja, di Chelmeni, di Guzigna, andrà dovunque la tromba delle armi e l'odor della polvere lo chiami, perchè ha bisogno di combattere, il sangue suo è in moto, lo spirito indipendente, considererà sempre il turco come oppressore e straniero... Nè transigerà mai il minimo dovere della sua fede, s'accosterà ai Sacramenti, ascolterà la santa Messa, non mangerà carne il venerdì e il sabato, rispetterà la comparità (il S. Giovanni), pagherà puntuale le annue alla parrocchia, e l'obolo per i poverelli e per la vedova.

Voglio dire che è religioso all'eccesso, fino alla superstizione, e la religione è quella che conserva questo popolo intatto e immune da ogni corruzione dei popoli vicini. L'Albanese non bestemmia mai, nella sua lingua non c'è termine per indicare la bestemmia. L'immoralità, non voglio asserire non esista da noi, poichè dove è l'uomo vi è la debolezza, ma il punto di onore da noi è alto, nè vi sono case di tolleranza nè aperta prostituzione in nessun punto dell'Albania.

Insomma amerei che si studiasse questo popolo originale e si educasse.

Tanti umanitari, filantropi, filosofi, letterati, perchè si perdono in vane teorie? Cerchino di allevare e di indirizzare educando questi popoli ancor vergini.

No; questa gloria è riservata alla religione, e sono i Missionari che hanno questo compito da noi, essi hanno il monopolio della scienza, delle arti, della carità cristiana. Se abbiamo qualche bene a Scutari e nella nostra Albania, è unicamente dai Missionari che ci coltivano con tanto amore, con tanti sacrifici.

Nè è facil cosa. Poco tempo addietro il Padre Filippo (un buon Missionario Franciscano), fu preso di mira mentre celebrava la S. Messa nel paese di Cacarigi per aver voluto correggere i malvagi costumi di quei abitanti, e dovette star molto a letto con pericolo di vita. Perimenti poco fa due PP. Gesuiti passeggiavano nel paese di Scirocca sopra Scutari, rinfrescandosi ad un fontana del monte Tarabosc, sono presi di mira da malvagi Turchi, uno cade a terra esanime in un lago di sangue, l'altro si salva quasi per miracolo.

Ultimamente, due tribù di Sciala e di Sciosci si azzuffano fra loro quasi in aperta guerriglia per ragioni di sangue ed antiche vendette (eterne fra noi), corre il Missionario (un buon Padre Franciscano della Liguria) colla croce in mano in mezzo alle palle, e grida e scongiura in nome di Cristo crocifisso, che perdonò in sulla croce ai crocifissori, di deporre le armi, di pacificarsi; e le armi come per incanto si depongono, la pace si fa, ridiventano fratelli e amici, e quelli che prima si volevano massacrare, bevono il *rachi* (l'acquavita) in comune banchetto. Questa è la forza della religione, questi sono i rischi di quelli che ce la predicano.

Nè posso enumerare i continui sacrifici ignoti, ma a Dio ben conosciuti di quei poveri Missionari in quelle inaccessibili montagne. La loro parrocchia può prendere cinque sei ore ad una giornata di distanza di cammino più a piedi che

a cavallo, arrampicandosi come le capre. Lo chiamano forse a mezzanotte per un ammalato che ha bisogno di assistenza per presentarsi a Dio, c'è un'anima da salvare. Si veste in fretta, monta sul mulo e su di corsa fra i boschi, fra torrenti impetuosi, a nuoto fra fiumi straripati senza strade nè ponti, in mezzo alle nevi ed ai ghiacci, arriva fra mille stenti al mattino, salva un'anima; e senza aver dove poggiare il capo, rimonta e non ha con che ristorarsi che con un poco di frumentone, un poco di cacio duro, un po' di latte e una pelle lanosa di montone per riposarsi. Una volta all'anno forse gli tocca venir in città per i bisogni del suo gregge, ed allora potrà provvedersi un po' di caffè e zucchero, un poco di vino e pasta ed altre cose necessarie e per gli altri usi, e qualche arma per difendersi. Egli vive isolato dal mondo dalla società, che conosce per reminiscenza. Ed ha genitori, e parenti nella bella Italia, gli scrivono, ma egli è il buon Adamo, s'è formato una nuova parentela, i suoi fratelli, le sue sorelle sono quei rozzi montanari, che egli porta a Cristo.

Oh! quante cose vorrei descrivere sull'Albania, all'Europa tanto sconosciuta, se la tirannia dello spazio ed il timore di riuscire noioso ai gentili lettori, non me lo impedissero.

Avendo detto qualche cosa sulla nostra lingua, voglio parlare brevemente sui nostri canti. Ogni nazione sia antica sia moderna, ha i suoi canti speciali, che racchiudono la sua storia ed i suoi costumi. Le nostre Rapsodie presentano pienamente il tipo della nostra letteratura, che consta, si può dire, di canti nazionali, animati da bellico entusiasmo, intesi a celebrare pubblici e privati avvenimenti, tramandando ai posteri le gesta degli eroi, o descrivendo i costumi, gli amori e le fazioni del popolo, che ne è ad un tempo autore e depositario. Vi si cantano componimenti poetici moderni della Toskria, della Ghegria centrale, di Necim Bei, di Mosa Sali Patta, di Hila Files, di Osso Falciores, canzoni delle colonie albanesi di Grecia e molte di quelle d'Italia, canzoni belliche Montenegrine e canti in lode del Visir di Scutari e di vari celebri Pascià, come Ali Pascià Tepelen, Mahmut Pascià Davletia, Ibrahim Pascià di Beratecco.

In alcuni si vedono mirabilmente i costumi di un popolo cavaliere, quando la cavalleria nel resto dell'Europa era già morta; d'un popolo forte e leale, selvaggio nell'odio, sublime nell'amore; ospitale, credente fino alla superstizione, guerriero e poeta ad un tempo. In altri canti si esprime l'odio e il disprezzo contro gli Osmanli ed i Turchi invasori; e il racconto geniale di tutti gli eroismi, di tutte le glorie della guerra d'indipendenza. Altri canti sono ispirati a lamenti, a desideri, a rimpianti, ad aspirazioni; vi è lo strazio ineffabile di una nostalgia infinita, sposato alla fede più cieca, più costante, nella prossimità della libertà, nella immancabile felicità della riscossa.

E le canzonette d'amore, quanto sono simpatiche, quanto patetiche, semplici, sincere! I sentimenti partono dal cuore, l'arte non entra nè la finzione; coloro che le hanno composte, le hanno sentite in se stessi. Poi quanta poesia, quante similitudini e metafore proprie degli Orientali, nei quali la fantasia è viva e nobilita anche le cose più usuali. Vi sono pure canzoni improvvisate nei momenti più critici della vita di un uomo. Per es. uno sta per andare al patibolo forse ingiustamente, ecco egli improvvisa un canto in mezzo alla folla, contento di lasciar fama di sè, quasi andasse a nozze.

Ed i nostri cori e le nostre danze negli sposalizi e nei banchetti, le « *valle* » tutte speciali dell'Albania, quanto entusiasmo hanno destato in tutti i forestieri! Vi si descrivono tutte le fasi della vita. E le lamentazioni pure in caso di funerali, costume del nostro paese, proveniente forse dal popolo israelitico, quanto sono belle, e come più volte mi hanno fatto mio malgrado lagrimare! Si descrive

la vita del defunto, le sue azioni, la sua morte; poi per volo poetico si suppone che gli vengano incontro tutti i suoi antenati, tutti i suoi amici morti avanti di lui, ed egli quasi lor porta le ambasciate dei viventi. Terminando sempre col ritornello « *figlio, figlio mio* » ed altro; come Davide: *Absalon, fili mi, Absalon*.

Il tono poi dei nostri canti è sempre flebile e lamentevole, perchè naturale, poichè l'uomo è inclinato al pianto anche in mezzo alle gioie più vive.

Anche le canzonette sacre sono piacevoli tra noi, ed il P. De Martino ne ha composto un grazioso libro, intitolandolo: *L'Arpa di un Italo-Albanese*. I Rev. PP. Gesuiti pure in una piccola stamperia che posseggono a Scutari, ne hanno raccolte e formulate parecchie, che si cantano nelle congregazioni e fra la gioventù per distoglierla dalle profane ed immorali; quantunque tra noi posso asserire che non vi sia immoralità nei canti, od è così velata, così poetica ed espressa con tali immagini naturali, che ci vorrebbe buona dose di malizia per sfigurarle. Poi nelle più semplici c'entra sempre il coraggio, il valore; e la sposa e le madre sono quelle che incitano il marito ed il figlio a lasciarle per distinguersi nelle bravure e nella guerra. « *Il seno che ti ha portato e ti ha allattato, la dolce sposa dai casti amplessi, non ti accoglieranno più se sarai vile e fuggiasco in faccia al nemico* ». Anzi quasi sempre la donna li accompagna nella battaglia, novella ammazzone, sfidando le spade nemiche; e novella suora di carità di accoglie feriti e li medica.

Molti hanno raccolto le nostre canzoni e le nostre rapsodie. Giuseppe Iubani è andato per tutti i monti dell'Albania, come ape scegliendo le migliori, e ne ha formato un libro, per noi prezioso. Il celebre De Rada ne formò un poema.

Ne scrissero pure, il Dorsa in un libro sugli Albanesi: *Ricerche e Pensieri*; Giuseppe Crispi, Vescovo di Lampsaco in un libro sulle costumanze albanesi. Il Biondelli sulla *Letteratura popolare d'Epiro*. Demetrio Camarda nell'*Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*.

Ne scrissero pure il P. Da Lecce, il Bianchi, il P. Francesco Rossi da Montalto Ligure, il Budda da Pietra Bianca, D. Antonio Bitucci, Giuseppe Schirò nelle *Rapsodie albanesi* a Palermo, l'Arcivescovo Bogdan nel *Cuneus Profetarum*, Necim Bey, Eutimio Mitco in Alessandria d'Egitto, D. Angelo Radoja nel *Concilium Provinciale sive Nationale*, Cristoforidis, Vassa, il Pouqueville, il Hann, Lord Byron, ed altri moltissimi, che non occorre numerare.

(continua)

POEZIJA E PJANËS (PIANA DEGLI ALBANESI)

O lule, n'ujë e vënë te një qelq,
si fluturen hernari, ti më telq.
Fëllezë, e parë e tufes t'ëndë, o mike,
më që t'vërrej, më e bukurë më duke.
Kur mua më flet, e hjeshmëza kopile,
ka goja t'derdhen lule e trundafle.
I mjerë edhe në qiell thom se kish t'ishe
në t'y përënë, o malli i jim, s'kish t'kisha!
Ti ngë m'do, po fort u' t'dua:
do e mos do kë t'duash ti mua!

(Nga « Canti Tradizionali » të Zef Schirò sr.
Napoli, 1923, pag. 340).

VJERSHA

nga LUIS DE ROSA

GJELI PASHQEVET

*Gjel, këndò!
menatet shpejt,
kur ka shtrati
dielli ve
të parin rrëmp,
kur ka qjellëza
illazët janë,
kur puntori
kuejt ve ndën.*

*Gjel, këndò!
kur vetëm sheh
rët e bardha
me gjith dritë.
Gjel, këndò.
ka dit'e bardha:
pse ke u'
ka Krishti erdha.*

IL GALLO DI PASQUA

Gallo, canta! / il mattino presto, / quando nel letto / il sole mette / il primo raggio, / quando nel cielo / ci sono le stelle, / quando il contadino / mette sotto (il carro) i cavalli. / Gallo, canta! / quando solo vedi / le nubi bianche / con tutta la luce. / Gallo, canta! / nei giorni bianchi (nei giorni di Pasqua) / perchè io / sono venuto a Cristo. /



TË DUA

*So'menat të paç,
nes'menat të shoh,
u' po tya mar vesh,
ty pë' mua n'ke fjalë.
U' tya të varenj
lesht e bukura që ke
e ty po luluzon
moj zonjëzë, ka ki dhe!*

*Dit e nat të kam,
gjith e dijnë, dhe hëna;
kur spassionj nga mbrëma,
u' po tya pënxonj.
Kur pas je prëzë mua,
zëmëra ime do' zëhet,
po më vjen dashurija:
dashurija do' bëhet.*

TI VOGLIO (TI AMO)

Stamane ti ho vista, / domani ti vedo (vedrò) / io, sempre ti ascolto, / tu per me non hai parole. / Io ti guardo / i bei capelli che hai / e tu (sì) fiorisci. / oh signora, in questa terra! / Giorno e notte ti ho, / tutti lo sanno, anche la luna; / quando passeggiò ogni sera, / io, (sì) ti penso. / Quando poi sei vicina a me, / il mio cuore arderà / (sì) mi viene l'amore / l'amore si farà. /



QITETI

*Me hundën ka vriti,
me dritën ka ballët,
një djal sheh qitetin
çë bëhet i madh:
jan' drasa, jan' gur,
shurben 'dhe një burrë
me diellin ka kurizi,
e diersit ja skuon
e burri këndon.
E djali varej,*

*si burri shurbej,
n'g dij pse këndonj
me diersit çë ja skuoj;
e del, vete pjesën,
e burri përgjegjet:
— « Këndonj me hare,
pse të kë harën,
u' të bëra shpín,
të kim një kujtim ».*

LA CITTA'

Col naso nel vetro, / con la luce in fronte, / un ragazzo guarda la città / che si fa grande: / ci sono legni, ci sono pietre, / lavora anche un uomo / col sole sul dorso, / e il sudore gli cola / e l'uomo canta. / E il bimbo guardava / come l'uomo lavorava / non sapeva perchè cantava / col sudore che gli colava, / ed esce, va a domandare, / e l'uomo risponde: / « Canto con gioia, / perchè tu hai la gioia, / io ti ho fatto la casa, / tu abbimi un ricordo ». /



BORA

*Bora bardh
mbulovi dheun;
e bëri gja njëri
me pak vjet,
i ri
pa një pet:
udhat, pinxhat, hora,
jan' mbuluot ka bora.
U' vetëm,*

*gja një shënim i zi,
ndër mesna tjervet
n'g dukem më
dhe ka ëndëra rronj:
Kam dashurin
çë gazion me mua,
çë më thot' të dua
e t'asaj bukurija
më mbulon, gja bora.*

LA NEVE

La neve bianca / ha coperto il suolo; / l'ha fatto come persona / con pochi anni, / nuovo / senza una macchia: / le strade, i tetti, il paese, / sono coperti dalla neve. / lo, solo, / come un (punto) segno nero / in mezzo agli altri / non mi vedo più / e nel sogno vivo: / ho l'amore / che ride con me, / che mi dice t'amo / e la sua bellezza / mi copre, come la neve. /

DUKET DIMIRI

*Sot frin Majlezja ftohtë,
flet' ka lisi bienjën,
dhe lumet ngasën plot.
Gjella u mbjet e xheshur
nën borë mbuluot:
ka t'vije bora nesër?
Gjella sot isht e shuot?
Naxori timin dheu*

*ndën parmendës;
fle grurët ndën botës,
mund vije bora nesër,
gjella n'g isht e shuot!
Del tim ka hora.
Ku i' burri? N'g i' ?
Vet rri prëzë ziarit,
pret gjellën e ré.*

APPARE L'INVERNO

Oggi soffia la Maillese fredda, / le foglie dalla quercia (albero) cadono / e i
fiumi scorrono pieni. / La vita è rimasta spoglia / sotto la neve coperta: / verrà la
neve domani? / La vita oggi è spenta? / Sta cacciando fumo il suolo / sotto l'aratro; /
dorme il grano sotto terra, / può venire la neve domani / la vita non è spenta! /
Esce fumo in paese, / dov'è l'uomo? Non c'è? / Egli sta vicino al fuoco / aspetta
la vita nuova. /



HARRONJ

*Varenj me syt të hapta,
patej ku isht moti bardh,
pënxonj që ka sont tata:
ndë kja, që bën, ndë u lodh.
Varenj... dhe n'g jam ka shekulli
më venjën syt mua larg,
futuronj si zog ka ajri:
harronj, pënxonj, harronj;*

*narronj 'dhe bukurin
n'g gjenj më Perendin;
jam vetëm i harrojtur
ka gjithë sej, n'g kam nesër jo dej
sonden e kam si ëndër.
Do'tthom, do't'bënj, do't'munj,
harronj gjithë sej, harronj.*

DIMENTICO

Guardo con gli occhi aperti, / di là dove il cielo è bianco (sereno) / penso che
ha oggi papà: / se piange, che fa, se si è stancato. / Guardo... e non sono nel
mondo / mi vanno gli occhi lontano, / volo come uccello nell'aria: / dimentico, penso,
dimentico; / dimentico anche la bellezza, / non trovo più Dio; / sono solo dimenticato /
da tutto, non ho domani, né dopodomani: / l'oggi l'ho come sogno. / Dirò, farò, potrò, /
e dimentico tutto, dimentico. /

LOTËT E ËMËS

*Lot' ka faqa
rriedhën dal
asaj grua
çë ka një mall.
« Bukurin po kishi shpija
kur jat'ëm' të kishi tya,
dje ty ishe, sot jo më,
ngrihu vajzë e thoj ty « më' ».*

*Ty nga qjellëza,
vajzë, përgjegju,
thoj ke engjëthrat
tja të kanë,
thoj ke ty
ke bukurin
dhe lot' terja
ty asaj ëmë.*

LACRIME DELLA MADRE

Lacrime nel volto / scorrono piano / a quella donna / che ha un desiderio. /
« La bellezza, aveva la casa, / quando tua madre aveva te, / ieri tu eri, oggi non più, /
alzati bimba e di' "mamma" ». / Tu dal cielo, / bimba, rispondi, / di' che gli angeli /
ti hanno (con loro) / di' che tu hai la bellezza / e asciuga le lacrime / (tu) a
quella madre. /



HËNA E BESËS

*Hënë,
ty çë jep besën,
çë kur u' leç, të paç;
hënë,
ata çë vëdesën
si ngavën shpejt, të pân;
lumnon, si martyri,
pë't'hoç Atë çë të bëri,
dhe u' ja vargënj kryen
Atija çë tya të vuri.*

*Gjith tya të kan' ndra mesma:
si i ligu, ashtu i miri:
ashtu kur dal si vjedhën,
ty me atë dritë i lidhën;
ashtu kur dal si puthen,
ty me atë dritë i zëhën.
Kur pas rét të mbulonjën,
do' t' siset besa ime,
ndrose ata çë vëdesën
tja n'g të shohën më.*

LUNA DELLA FEDE

Luna, / tu che dài la fede / da quando sono nato, t'ho vista; / luna, / quelli
che muoiono / come hanno camminato presto, ti hanno vista; / splendi come testimone /
per dire Chi ti ha fatto, / anch'io chino il capo / a Chi ti ha messo (al mondo). /
Tutti ti hanno in mezzo: / come il cattivo, così il buono: / così quando piano come
rubano, / tu con la tua luce li legghi; / così quando piano si baciano / tu con la tua
luce li ardi. / Quando poi le nubi ti coprono / finirà la mia fede, / forse quelli che
muoiono / non ti vedono più. /

Nota della Redazione — Siamo lieti di presentare ai nostri Lettori queste schiette
e scorrevoli liriche del giovane **Luis De Rosa** da Ururi (comunità albanese del Molise),
che usa senza alcuna alterazione l'attuale parlata del suo luogo nativo. Egli (ci dice)
deliberatamente evita in queste sue composizioni l'inserimento di vocaboli e frasi let-
terarie degli autori **arbreshë** e **skipetari**, attenendosi rigorosamente all'uso della lingua
viva di Ururi poichè ambisce di essere inteso anche dagli **arbreshë** che l'albanese non
lo hanno mai studiato ma semplicemente appreso nell'ambiente della famiglia.

RRÂJËT LËVIZIN

(Ngjarje me një dukë)

nga ERNEST KOLIQI

... What are the roots that clutch, what branches grow
Out of this stony rubbish? Son of man,
You cannot say, or guess, for you know only
A heap of broken images, where the sun beats...

T. S. ELIOT

Vetjet

SHUKU, mësim-dhânës	(28 vjetsh)
NDREKA, ish-tregtar	(66 vjetsh)
IZA	(24 vjetshe)
ROZA, e shoqja e Shukut	(25 vjetshe)
GANXHJA, e shoqja e Ndrekes	(62 vjetshe)
LINA, e motra e Rozës, nxânëse	(17 vjetshe)

Në Shkodër, me 197...

(Një odë buke, e gjânë, në një shtëpi të vjetër zotniysh. Mure prej shumë kohe së palyeme. Një tryezë e thjeshtë katrânëshe në mjedis rrethue me ndejse të zhgatrrueme të ndryshme njëna prej tjetrës. Në fund të dhomës dy dritore të mëdhaja që biejnë kah rruga. Në perden e mbajtë, në skâj kah fundi, një derë që qet në odë të zjarrmit, mandej një kanapeh mbulue me pelhurë të zgjedhun, tashti e repun dh'e zverdhakët në ngjyrë. N'ânën e djathtë një derë që qet në shenashin. Edhe pse s'mungon dlirsija, ambjenti ep një përshtypje së lánuni mbas dore. Shifet menjisherë se dikúr ajo banesë shkelqente me orendi të begatëshme e dallohej për mbajtje të kujdesshëme. Asht mëngjesi i një dite së dielle vjeshte).

LINA (tue hÿ nga dera e shenashinit, veshë me petka shetije, përshtëndetë Rozën që del me dy broka plot me új nga dera e odës së zjarrmit) Nadja e mirë!

ROZA Sa heret kënke çue! Mirë se vjen!

LINA Mesha në Shkollë të Murgeshavet thohet në shtatë. Mbaroi e këtheva këtu. Erdha me pá si keni ndjehë e me të marrë me dalë në Fushë të Qelës.

ROZA Ka kohë. Nuk do të jët sahati mâ tepër se tetë e gjysë. Shetija fillon mbas Meshës s'orës njëmbëdhjetë të Fretnevet. Po i çoj ujën m'u lá Shukut e po vÿj. Si ásh nâna?

LINA Mirë. I kanë pushue dhimbat n'ijë. Shuku si po ásht?

ROZA Me shëndet mirë, por, si gjithmonë, i habitun mbas trilleve të veta. Lexon, merr shenime e çohet e shetitë nëpër odë. Duhet me i a përsritë disá heresh fjalën para se t'a marri vesht: kaq përqëndrohet në mendime...

LINA Pregatitë ndoj vepër të ré, sigurisht.

ROZA Shka me kënë! Humbë kohën kot. Kur s'mujt me nxjerrë gjá në dritë sa ishin... *ata*, sot duhet t'a kuptojë se puna e shkrimeve të tija ka marrë fund. Mue më bán me plasë. Në vend me i a vù menden si e si me e përmirsue këtë gjendjen t'onë dhe m'u vù për fije si shokët, qi prá s'e kanë kurrkund zotsín e tij, bieret mbas ándrrave. Jam në hall të madh, Linë!

LINA Shuku ásht i zoti. Heret a vonë ka me i a dalë m'u rradhitë ndër shkrimtarë në shêj e me kënë i çmuem si meriton.

ROZA Prit gomar sa të dalë tërfoja! S'kam besim në zotsín e tij. Ka mbetë mbrapa shokve. Mandej... (*me zâ t'ulët*) kujton ti se e lâ-në... këta të sotshmit me çue krye si shkrimtar? Rrêhet kot. Por... më lën t'i a çoj ujin m'u lá. Mos u mërzi! Qe, erdha! (*Del kah shenashini*).

GANXHJA (*hÿn nga e djathta*) Nadja e mirë. Linë. S'ásht nevoja me të pyetë si jé pse po shof se ké ndjehë si molla në gëm. Kaq heret, sot?

LINA Jam kënë në Meshë te Murgeshat.

GANXHJA Tý të ndihmoftë. Edhe unë aty kjeçë në meshë, por ishem në fund të kishës e s'të kam pá. Ké pasë fat, moj bí, m'u rritë në hir të Zo'it e me marrë mësimë të mbara ndër Murgesha. Mjerrisht ka gjind qi, qyshë se kanë lé, nuk e kanë pá kishën me sý dhe nuk njofin ngushullimin e madh t'uratës...

LINA Si ime-motër, për shembull, ás? Mos i vën faj, Ganxhe. Ka thithë mendimet e... *atyne*. Nuk ásht zëmër-keqe, por koha e përparëshme ka lânë gjurma të forta në të.

GANXHJA Ajo qi nuk më pelqen, lum Lina, ásht se jote-motër nuk i mban për vete mendimet qi ka, por mundohet me i a rrasë në trú edhe tjervet. Qe, tuk ásht zotní Shuku: ai nuk i a thotë kurr kurrkuj një fjalë të vráshme dhe nuk shán shka na jemi të bindun se ásht e mirë e e drejtë. E, prá, kisha me thánë se atij i përket má tepër me u dalë zot mendimeve t'*atyne*...

LINA Unë nuk jam fort e rrahun në këto çáshtje. Por... me shka kuptoj unë, Ganxhe locja, Shuku ka mendime krejt të veta qi janë bukur larg prej parimeve t'*atyne* pa kënë, merret vesht, kurrkund afër me t'onat; me këto të sotshmet, due me thánë...

NDREKA (*tue hÿ nga e djathta*) Mirë se të gjëj, zojushë.

LINA Mos më thirrni zojushë, zotní Ndreka. Unë...

NDREKA Don ndoshta me të thirrë shoqe? Fjalët *shok* e *shoqe* i urrej edhe i kam qitë, sa për vete, jashta përdorimit.

LINA Më thirrni Linë.

GANXHJA (*të shojt*) Edhe ti ké nisë m'u bâ i mërzitëshëm. Lëne rahat vajzën qi kurr s't'a ka këthye fjalën.

NDREKA Ké arsye. Lina s'ásht si...

GANXHJA Lëni fjalët boshe, po të tham. Po shkoj me ju pjekë një kafe. E kam xhezën në zjarrm. (*Del kah oda e zjarrmit*).

NDREKA (*tue u ulë ndejun në kanapeh*) O Zot i lum, kjosh levdue qi premtove me më falë një pleqni të rahatshtëme! E din, Linë, sa vuejshem kur ishin *ata*. Sidomos të diellavet. Nuk u dallote e diellja prej ditve tjera. Qe, ndëgjò. Po biejnë kumbonët e Kishës së Madhe. Aman, mos pritò, çilma dritoren. Due me ndëgjue kumbonët. (*Lina hapë xhamat e dritores*). A ka lezet mà të madh? Me gëzue lirisht të diellen; me shkue në Meshë të madhe, ashtu si përpara. Ti jé e ré dhe s'merrshe gjâ vesht kur ishin *ata*. Por né na e kanë terratisë jetën. Kishim lakmí *ata* qi disshin. A merr vesht? I njehshim të lum *ata* qi përsiellshim ndër Rmaj... me i shtí në dhé!

LINA Unë s'mbaj mend mirë; po, vërtë, të rámit e kumbonvet ishte asokohe i ndaluem?

NDREKA Rrebtësisht.

GANXHJA (*tue hÿ me do filxhana kafje në një tabake*) Urdhnoni, prá.

NDREKA Të lumët dora, grue. Prej erës kuptohet se na ké pjekë një kafe tarrnake.

LINA (*Ganxhes*) Njimend pak e kush din me pjekë kafe si ti.

NDREKA Duket gjâ e kollajtë, përkundrazi don shumë marifet. Ah, s'ká mà gjâ të kandëshme se me pí kafe tue ndëgjue kumbonët qi bjinë e tue mendue se «*ata*» nuk na rrijnë mà përsipër me na marrë frymën. Lirija, lirija, s'ká të paguem në këtë botë.

ROZA (*tue hÿ ka ndëgjue fjalët e Ndrekes*) Lirí kallpe... Vetëm mendelehtit nuk kujtohen se priftnija i a futë shpirtin njerzís në një burg gënjeshtresh lara lara. Nuk áshht lirí ajo qi pa u kujtue të bân me ndjekë vijën e caktueme prej priftënvët dhe prej qeverritarve të cilët tjetër mendim s'kanë veç me shfrytëzue vo-gjëlín e shkretë.

LINA Pásh fén, pse nuk shikon punën t'ande!

NDREKA Lëne të turfullojë... Fjalët e saja nuk m'a prishin lezetin e kësaj së dielle plot kumbonë. Kumbonët s'i bájne dâm kuj. Kjo pëlqente krizmën e bataveve qi vinte prej Zallit të Kirit kur u pushkatojshin njerzit mà të ndershëm të vendit t'onë. Tashti ángthi u zhdavarit... Ah, kjo muzikë e kumbonve t'a zgjánon shpirtin. Tash mund të des i ngím...

ROZA E besoj: tash qi këthyem prap në Mesjetë...

NDREKA Këthyem në jetë te mbarë e të lume!

GANXHJA Po ti, morë nieri, pse e gërget? Lëne në punë të saj. Ajo áshht rritë me ato mendime.

LINA (*qi ka qitë kryet kah rruga prej dritores së hapun*) Grá, eni e shifni. Në krye të rrugacës áshht ndalë një zojë e huej... Se ç'petk qi ká!... s'ká si bâhet mà i bukur... e i rri mrekullí në shtat... Qe, ka ndalë dikëh e dishka po e pyetë tue bâ shëj me dorë kah kjo rrugacë...

(*Roza e Ganxhja shpejtojnë me dalë në dritore*).

GANXHJA Kush do të jét, vall? Po hÿn në rrugacë t'onë. Po afrohet këtej...

ROZA E veshun vërtë në mënyrë të përsosun... Sa t'ecun të zhdërvjellët... Shifet se nuk e topitë halli i jetës si né të shkretave.

LINA Zojë e randë duket me kënë...

ROZA Po ndalet para derës s'oborrit t'onë...

GANXHJA Jeee... Po kjo shka lypë te na?!

(Bjen trakllojca e derës s'oborrit: i ndëgjohet krizma nepërmjet derës së shenashinit)

ROZA Tham se e kanë drejtue gabim...

GANXHJA (tue dalë me shkue e me çelë derën e oborrit) Në kjoftë e huej si do të merrem vesht unë me të?

NDREKA (pa u tundë prej kanapehit, tue mbështjellë një cingare në kuti të duhanit) Më thirr mue. Unë italishten e dij...

ROZA (si në tallje) E po foli rusisht, jam këtu unë!

NDREKA S'ká me kënë nevoja as për tý as për mue. Ká gabue derë, po kje se kërkon ndokend. Këtu te na s'ká kush punë me të huej... Shko, Linë, të paça, e shif kush ásht ajo grue e si po i shkon puna Ganxhes me të... (Lina del kah e djathta).

NDREKA Shum të huej kanë fillue me ardhë. I ka dalë nâmi vendit t'onë e, tash qi udhëtohet pa pengime, shum kend ngucë kureshti m'e shetitë fund e maje.

ROZA Në këtë shtëpi gjysë të rrenueme s'ká kush shka me pá...

NDREKA Eeh... Dikur kjo shtëpi ka kënë një ndër mâ të mirat e Shkodrës...

ROZA E sot ásht çerdhe mijsh. Të mjerët na qi jemi të dënuem me jetue këtu mbrëndë.

NDREKA (tue mos u vù vesh fjalve të saja, vazhdon si të flitke me vete) Shtëpija e Sinadinvet, zotnij zëmërbardhë.

ROZA Pasanikë qi jetuen të kërtylun me miradina në shpinë të popullit t'únshëm. Mandej një prej tyne a më bâhet a ishte i dâm me gisht si njeri me idëna antipopullore?

NDREKA Thue për Pjerin Sinadinin, shkrimtarin?

ROZA Ç'e dij unë? Një prej asaj simsile...

LINA (tue hÿ turravrap pa frymë) E dini se kush ásht? E zoja e shtëpis!

NDREKA (tue brofë në kâmbë) Kush? Kush, thae?

LINA E zoja e kësaj shtëpije, prá! Ká ardhë prej Italijs. Po shetitë oborrit me Ganxhen.

NDREKA A ká se si? E ká marrë mirë vesht Ganxhja?

LINA Po, po: ajo flet shqip si na. Ásht bijë Sinadinësh; a u thoshin kështu pronarvet të kësaj shtëpije?

NDREKA Áshtu. Po pse ká ardhë?

LINA S'dij. Unë porsa u paraqita me të e ngava këtu me ju kallzue.

ROZA (me zâ idhnak Ndrekes) Shif: unë të kam pague qirán për një vjet e, t'a dijsh mirë: para Shën Gjergjit nuk los prej këndeje edhe me ardhë të gjithë Sinadinët e dekun e të gjallë...

LINA Para se me thânë ásthu, prit me marrë vesht si po merr zhvillim puna.

NDREKA (Linës) A të tha Ganxhja me më bâ zâ mue?

LINA Jo; por, mësi i a pásh gjasën, ajo tash po njetet këtu nalt.

NDREKA Si t'u duk?

LINA S'ká si bâhet mâ e njerzishme. Si çërcerrim bylbyli e ká zânin. Një buzqeshje e âmbël i a ndritë fytyrën kur flet.

NDREKA Kjo nuk u donte!

ROZA Shka nuk u donte?

NDREKA Ardhja e kësaj - deh?

LINA Po kush është kjo, zotni Ndrekë? Bash e zoja e shtëpis?

NDREKA Kjo - a? Mbas hamendjes është e bija e Pjerin Sinadinit.

ROZA T'atij shkrimtarit me mendime prapanike?!

NDREKA (*tue mos i vù vesh Rozës flet me Linën*) Pjerin Sinadini — unë e kam njoftë — ka këne njeri me idëna të vjefshme, nisjatuër i palodhëshëm veprimesh të mbara, shkruente ndër fletore, qitë libra, ká pasë një rreth të gjënë miqësh qi e dojshin me shpírt por edhe shumë anmiq qi e mënijsin...

ROZA Njerzit e këqij janë të mënim...

NDREKA Ai s'i ká bá keq kuj. Disáve, prej atyne qi e mënishin, u kish bá nderna e ç'farë nderdash...

LINA Po kjo zoja kush është?

NDREKA Sigurisht e bija, qi ká trashigje pasunín e tij.

LINA Po vjen! Qe, i ndëgjohet zâni. Janë në shenashin me Ganxhen.

ROZA Unë s'due t'a shof.

LINA Ti rri, he mos pritsh. Të shofim shka thotë e shka ka ardhë me bá...

IZA (*tue hÿ e përsjellun prej Ganxhes, me njerzi të spikatun*) Mirë se u gjëj!

NDREKA Mirë se të bjen Zoti! Unë jam Ndrekë Beltoja, kujdestar i kësaj shtëpije.

IZA Më falni qi po u trazoj, zotni Beltoja. Deshta me pá, mbasi më qiti rása me ardhë në Shkodër, shtëpin e prindve të mij.

NDREKA Jeni e bija e zotni Pjerinit, atëherë?

IZA Po.

NDREKA E kam njoftë babën e juej.

IZA (*me sÿ qi i ndrisin papritmas prej gëzimit*) Vërtetë?

NDREKA Po kush nuk e njifte? Është përpjekë shumë për këtë qytetin t'onë.

IZA Shkodrën e ká dashtë me shpírt. Ka dekë me zëmër të plasun prej mallit të saj. Më flitë gjithmonë për Shkodër, për Shqipni, për këtë shtëpi... (*Shikon rreth e rrotull me një hije mallëngjimi në fytyrë*) Kjo është oda e bukës... Aty në skâj dikur ishte një poltronë ku rrinte gjyshi... Këndeje duhet të jët oda e zjarrmit. A kam lëjën t'a shof?

NDREKA Kjo është shtëpija e juej, zojë... Urdhnoni: po ju përsjellim (*bashkë me Ganxhen shoqnon Izën tue dalë kah e mbajta*).

LINA Sa grue e hijeshme dh'e njerzishme.

ROZA Kështu e kanë të pámit këto reshpereshat, por përmbrenda janë pleh.

SHUKU (*tue hÿ prej së djathtës*) Kush është ajo zojusha qi erdh me Ganxhen n'odë t'onë e shikoi me përmallim të dukëshëm trapazanin e musandrën? Kishte në shikim një shprehje të çuditëshme! si me këne tue pá ândërr...

ROZA Ti, ti, jë gjithmonë i humbun ndër ândrra, morë tatalosh. E kjo bukurushë ká ardhë me të zgjue e me të bá me ikë rrezgabjezga prej kësaj shtëpije pse don me banue vetë këtu.

SHUKU (*pa u vù vesh fjalve të së shoqes, me kureshtë të gjallë*) Si?

Si? Æsht zoja e kësaj shtëpije?

LINA E bija e Pjerin Sinadinit.

SHUKU Pësh Zotin a 'imend? Shi e shkrintarit?

ROZA Si po urdhnon e thue. Shi t'atij njeriut antipërparimtar, prej të cilit ká trashigüe pasunín edhe sigurisht mendimet...

SHUKU Pjerin Sinadini, përlavduesi i bukuris së Shkodrës, poeti i ynë qi vdiq në mërgim...

ROZA Kush t'a báni poet t'andin at nieri egoist qi s'mendonte tjetër veçse me shijue jetën tue u zhytë n'andje të mbrapështa pa kurr-nji kujdes për vuejtjet e vogjëlis?

SHUKU Hesht se s'din gjá ti në këto çashtje. A ké lexue ndoj libër të tij? Jo. Atëherë pse flet kot? Me shijue ngjyrat e jetës shkodrane, në nji kohë kur ajo jetë po prendonte edhe me përshkrue shqetësimin qi përhapet në zëmra të ndieshme kur nji stinë historike soset dhe ajo e reja qi agon nuk dallohet ende mirë pse e rrethojnë mjegullina të denduna mendimesh e ndiesish, nuk është faj, por ve-për e miratueshme.

ROZA Po ti ku m'i ké lexue librat e këtij... bàmirsi të madh?

SHUKU Ndonji lexova, jo të gjitha. Natyrisht tinzë n'at kohë qi emën e vepra të tija ishin zyrtarisht të ndalueme m'u përmendë e me qarkullue.

ROZA Cila do qi të jët vlera e veprave, ti e din mirfilli se mendimet e tija nuk përkojnë kurrsesi me ato t'onat.

SHUKU Po më thuej, të lutem: cilat janë mendimet t'ona?

ROZA Këto, qi sot rishtas kanë marrë dhén, sigurisht nuk janë.

SHUKU E din, Rozë, se jé kah më çuditë? T'është ngulë mendja hù në mirnín e kohës para kësaj. S'bán tjetër veç tue e kjá me lot. A të kujtohet kur u ankoshe për padrejtësit e gjendjes s'atëherëshme? Këqyrshë, tue u grí përmbrenda prej zilís, grát e eprorvet qi porositshin toaletet përjashta mësa ti dhe shoqet e tua do t'u konde-ndojsi m'u veshë me stofna të dobta të kombineateve tekstile të vendit. Më thojshë: s'është e drejtë me ndjë ti nën filanin a fisticun qi s'vlejnë as sa nji gisht i kámbës s'ate! Tash, qi ajo kohë mbaroi, vjen tue i a gjetë përditë nga nji të mirë.

ROZA Mendimet t'ona nuk kjenë as nuk janë të gabueme edhe pse ata qi ishin të ngarkuem me i zbatue, u çoroditen e i shtrëmbënuen n'interesë të vet. Ti vetë prap ushqehesh me ato mendime...

SHUKU Unë? Kush t'a ká thánë? Mue as ajo kohë më pëlqente as nuk më pëlqen kjo e tashmja. Kërkoj nji rrugë të ré për vete, por s'dij m'e gjetë. Më lypet nji pikënisje me dalë prej amfís mendore qi më ndrydhë.

ROZA Pse e mundon veten kot? Përpiqu m'u gradue si shumica e shokvet dhe jo me bjerrë kohë e qetí tue lodhë menden për me gjetë pikënisjen, a shka është ajo gjá qi po të han fén kah më rrin tue e kërkue kot. Mendò me bá karrjerë...

SHUKU Nuk është karrjera qi më tërhjek. Due me gjetë pikën qi të më shërbejë si themel për nji veprimtarí letrare të vjefshme. Idët, e trashigüeme prej kalesës, të thásh se nuk më kënaqin. Ato qi trumbetohen në të tashmën nuk më bindin. Kam mbetë, prá, në kapërcyell. S'due me këthye mbrapa e s'dij me shkue përpara...

- ROZA Kur thue qi karrjera nuk të tërhjek, harron se gjendja e jote shkrepet mbi mue. Gjithmonë në mizerje do të jetojmë? Deri sa ti mos të merresh me punë qi qesin profit, unë do të jës e mbra-mja dh'e mâ e mjeruemja ndër shoqe të mija!
- SHUKU Ky âsht rrisiku i yt edhe i em. Por, a e din si mundesh m'e qetësue shpirtin e me fashitë menden?
- ROZA Elë? qite ilaçin e mrekullueshëm!
- SHUKU Thjesht: tue shikue ata qi janë mâ keq se ti e tue mos e ngrehë synin e menden nalt kah ata qi janë mâ mirë.
- ROZA Kë'o këshille epjua nxânsavet të tu në klasë. Unë s'kam nevojë për to. Due më jetue e me gëzue si e shumta e shoqeve të mija, jo m'e kalue jetën pranë një nierit qi humbë kohë e zotsi në punë boshe pa kurrnji dobí. (*Nisë me kja*).
- LINA Po a bân me dijtë se shka fitoni tue pezmatue këso dore shoqi-shojnë me fjalë të vrashta? Delni e shetitni si mbarë njerzija, sot qi âsht ditë e dielle, e mos rrini ndrÿ mbrëndë tue i a lëndue zëmren njëni tjetrit.
- ROZA (*fshin lotët me shamí, ngutëshëm*) Qe, po vijnë.
- NDREKA (*tue u prî Izës e Ganxhes hÿn n'odë prej së mbajtës*) Si urdhnove, zojë, me thânë?
- IZA Kopshtin mbas shtëpis, ai muri me shermashek, e dânte prej obo-rrit të Hilë Pashkos.
- NDREKA Edhe Hilë Pashkon e dijkeni? Pasha të Madhin Zot, lum zoja, jeni kah më shkaktoni çudi mbas çudije! Paj janë mâ se ka-tërdhetë vjet qi ká dekë ai i shkreti. E dij, sepse kam lé e kam banue gjith-herë në kët lagje. (*Tue pá Shukun*) Ky, zojë, âsht Shuk Blinishti, shkollar. (*Iza e Shuku paraqiten me shoqishojnë, mësa Ndreka tue i u sjellë të gjithve, këlthet*): Zoja me të vërtetë qi na ká lânë pa mend mue e Ganxhen. E njeft kët shtëpi si me pasë banue gjithmonë mbrënda so. S'âsh^t nevoja m'e drejtue! Tue dalë kënde, na tha: «Kjo âsht oda e zjarrmit me votër të naltë plot furraca. Këtu duhet të jët sqolli e, qe, shkalla e vogël guri qi ulet në kopësht mbas shtëpis». E, aty në kopësht, na báni «Di-kúr këtu në midis të midisit ishte një qershí. E mâ ndëj te muri kah rruga një tandë hardhijash. Ky muri tjetër paska mbetë, ashtu si ishte molit, krejt mbulue me shermashek».
- IZA (*me sÿ të qeshun e zâ të përmalluem*) S'kini pse çuditeni. Em-ât më fli'te shpesh për kët shtëpi. M'a përshkruenti në të gjitha hollsi-nat: shenashinin me pesë dritore të mëdhaja, arkën e gjyshes n'odë fjetjeje pranë odës së miqvet, e pasqyrat e mëdhaja në të gjitha odat me suaza t'arta, mandej odën divite ku ai mbante librat e shkrimet; këtu në kët odë, qi sherbente si odë buke në dimën pse në verë e shtrojshin sofrën në shenashin, ishte një stufë e madhe ma-joliket bojë jeshile...
- ROZA (*me zâ t'ulët Linës*) Flet shkodranishten e vjetër plot me fja-lë turçe.
- IZA (*tue shënjue me dorë vendet e ndryshme*) Aty ishte një raft me xhama ku gjyshja ruente shishen gatarje të rakis për miq edhe pu-tira^t e shkruem me lajle ari dhe një bocë me reçel në të cilën em-ât tinzë, kur ishte i vogël tue hypë mbi një karrigë, futte duert me kapë ndoj kokërr arre a fiku, e ndyhej me lâng të trashë dhe

gjyshja i a diktonte fajin feshnjarak ndër njolla të petkut. Aty ishte një tjetër raft druni të punuem me sofrabeza e mësalla e turra çinijash e luga e thika e piruj.

NDREKA Kanë marrë gjithëshka...

IZA E dij. Në shenashin, në skaj afër odës së miqvet, ishte një pjanofortë. Gjyshi i biente... Si amator... Mirrte këngë e hëngu...

ROZA (nën zë së motrës) Kjo djallushë paska ardhë me bā inventarin e plaçkave të dikurshëme. Sigurisht don të lypi dām-shpërbliemet prej qeverris... Nuk ngihen kurr me pasuni, këto ushujza...

NDREKA Të gjithë e dijmë, zojë, që kjo banesë për stolit e begatit dahej në shëj ndër shtëpijat e Shkodrës. Ata e kanë rrenue. S'pari e banoi një oficer i naltë edhe e mbajti mjaft mirë. Mandej e caktuen për zyre e erdh tue u dāmtue. Në fund shtëne mbrendë gjind gjithëfarësh që e shpartalluen krejt: në çdo dhomë ishte një familje e aty bājshin me hāngër, punojshin, flëjshin e pritshin e qitshin. Merrnje me mend... Kur Palok Ganjolla, ilakā i juej, m'a ngarkoi kujdes'arin e saj, unë u përpoqa m'e pastrue e deri diku m'e meremetue; ndreqa pullazin, ulluqet... Por, prap, duket harabë!

IZA E dij. Por s'duhet me u vū faj kurrkuj. Janë pasojat e kohës. Mandej... mue nuk më duket aspak harabë. Unë e shof ashtu si ishte dikur: me rafta e me poltronë të gjyshit e me stufë aty në skaj. (*Shuku i ngashnjyem prej atyne fjalvet avitet kah grueja e ré dhe e veshtron me vemendje të madhe*). Shof aty në perde mbi kanapeh një piksim të Venedikut... (*Flet si e rrëmbyeme në vegim të kalesës*) E prej tavanit biente pezull ndër sinxhirë të praruem një kandil me vojquri... i madh... me një kupë shumngjyrëshë për sipër...

SHUKU (i çmeritun) Po ju, zojë, mbasi s'jeni këne kurr mā përpara në këtë shtëpi, si i shifni të gjitha ato sende...

IZA I shof me sýt e t'em-eti...

SHUKU Si? Si?

IZA Em-āt ishte vjerrshatar, si e dini. M'a përshkruente shtëpin pa harrue as gjān mā të vogël të saj. Ndër shkrime të tija të pabotueme, gjeta mā vonë një vjerrshë që ai m'a drejtonte mue. Më thonte: «Mbasi tashmā nuk shpresoj të këthehem në Shkodrën e adhurueme, shko ti atjē, moj lule e bime prej gjakut t'em, e merr dritën e këtyne syve të mij në sýt të tú e m'a sodit bukurin që m'a mbushi përhera me kënaqje shpirtin. HËn në shtëpi ku unë linda e u rrita edhe m'a përshëndet mandin midis oborrit, pusin në skaj afër fikut të vjetër, e shimshirët që u rrijnë anash derës s'oborrit e drandofillen e verdhë në mur të jerevis te rrājët e së cilles dada plakë thonte se më lëshoi kur u linda një engjull e ajo e para më pau e më muer». Vjerrsha vijonte: «E veshtrò në heshtje, tue ndëje n'odë divite ku unë kuvendojshem me pjesën mā të mystershëme të shpirtit t'em, rrājët e vjetra të Shkodrës që lëvizin në themel të shtëpis s'onë e nën troje të mbarë qytetit. Ndoshta u përpoqen t'i zhgulin, por ato sigurisht janë gjithënjë gjallë në msheftësi të tokës e prap do të këndellen e lulzojnë. E, kur të lulzojnë, ké me i ndëgjue tue pëshpëritë si dikur ndër fllade gjethët e rij të mandit të vjetër, dhe ké me pá tue qitë filiza të rí hardhijat dhe tue u përtrí shimshirët». Kështu vjerrshonte

em-át. A e ndieni ju një erë të mirë qi vjen prej andej? (*E shë-njon derën kah shenashini*) Në mur nën dritore të shenashinit u kacavirshin degët e një jasemini... E pash parë se nuk është më aty. Me gjithatë unë i a ndiej erën...

ROZA (*Linës me zâ t'ulët*) Kësaj po i lot çekerku i mendes me shka duket!

SHUKU (*Izës*) Flitni si me këne edhe ju ve'ë poeteshë.

IZA Kam një doktoratë në letrësi, por nuk e shti në punë. Merrem me rëngët e shtëpis. Unë këtu shof me sýt e t'em-eti e flas me gojë e tij.

SHUKU (*i thekun thellësisht*) Æsht punë e mrekullueshme. Sýt e poetit të vjetër të ngjalln në ballin rinuer t'uej...

IZA (*tue e shikue me sympathy Shukun në të cilin heton një shqetësim shpirtnuer qi e shtÿn me kërkue dritë e drejtim*) Kini lexue vjerrshat e poetit ingliz Eliot?

SHUKU I a kam ndëgjue emnin, por nuk i a njof veprat.

IZA Ai thotë (këtë s'e mësova ndër kurset universitare, por e ndëgjo-va nga goja e babës s'em) në poemën *The waste land* (Toka e shkretnueme): «Ç'farë rrjësh janë tue xânë, ç'farë degësh janë kah rriten mbi kë'o gërmadha? Bír i njeriut, ti s'mundesh as të përgjegjish as të diktojsh gjâ, sepse njëf vetëm një grumbull fytyrimesh të thyeme e të bame copë mbi të cilat shkrepë rrezja e diellit...». Unë e shof me sýt të t'em-eti at rreze dielli mbi rrjë të shpërdame të kësaj shtëpije e të Shkodrës e të Shqipnis mbarë...

SHUKU (*si i prekun befas nga një dritë sqaruese*) Po, ky është një lajmërim i cilli na vjen nepër gojë t'uej nga një njeri qi parandieu ngashrimin e shpirtënvët t'onë të rrahuñ nga stuhit e kohës... Rrjëjt qi lëvizin...

IZA (*me një theksim ambëlsije në zâ*) Edhe ju merreni me shkrime?

SHUKU Përpigem të nxjerrim prej palcit më të kulluet të qënjes s'eme dishka qi të vlejë me u a shpallë t'jrvet për t'i nxjerrë nga dyshimi turbullues. Por deri tash s'kam...

IZA E kuptoj. Duhet me pasë, më përpara, vetë bindje në një idé e mandej vetvetiu kjo shpërthen nga shpirti si *message* për të tjerët.

SHUKU (*përherë më i çmeritun*) Më duket se i keni ra mbë të pikës qënësore qi shkakton në mue një pështjellim të madh menduer. Po, duhet, m'e ndie vetë përpara thellësisht një idé... përndryshej ajo s'ka fuqi me depërtue ndër tjerë. E unë ende s'e kam gjetë në vetvete at idé-nanë qi t'a pranoj me plot bindje si pikënisje të një veprimtarije letrare...

ROZA (*nën zâ Linës*) A e shef? Me të ky burri i em rrëfehët; veg mue nuk m'a gillë kurr as mendën as zëmrën.

IZA Domethanë nuk i ndieni rrjëjt ende tue lëvizë...

SHUKU Rrjëjt?

IZA Rrjëjt, po. Për t'i krijue një populli një ardhëmeni të përshtatun duhet shti në punë — me frymë të ré, kuptohet, e në përkim me nevojë shpirtnore të reja, — landa, qoftë edh'e shpartallueme, e kalesës. Tue mohue trashigimin stërgjyshuer i zhgulen rrjëjt një breznije. Si mundet një komb m'u përtri në veti qi pat si pajë nga Perendija e qi e dallojnë nga kombet tjera pa thithë lang jetësuer prej rrjëve të vjetra?

SHUKU (si *ândrramend*) Rá perdja qi m'a ndalonte të pámit. Më duket se e shof tashti udhën... (*Ndëgjohet një zâ prej rruget nëpër dritore të hapun: Isa! Isa! Sono quaggiù!*).

IZA (*tue dalë në dritore*) Eccomi, Renato.

(*Zâni prej rrugës: — Scendi che dobbiamo partire per Tirana.*)

IZA (*përgjegjet prej dritores*) Vengo subito! (*Ndrekës e të gjithvet*)
U falem nderës për pritje e më ndieni për trazim.

GANXHJA Kam kafen gati. S'keni si delni kështu pa një kafe...

IZA E ndëgjuet vetë burrin qi më tha m'u ulë menjherë.

NDREKA (*disi me marifet*) Ndoshta, zojë, shtëpín e keni gjetë në gjendje shumë më të vajtueshme se e mendoshi. Na jemi përpjekë n'at t'onën si e si m'e vû për fije. M'e pasë pá kur na u dorzue! Rrenojë: nd'odë të zjarrmit kishtë bî bari! Por (*tue shikue Izën ndër sý me dridhje zëmre*) tash qi ndruen punët, sigurisht keni me këthye vetë në Shkodër e atëherë tash e ndreqni edhe e stolisni kët shtëpí mâ mirë se ishte përpara.

IZA Nuk e kemi kurrkund at mende. Kët shtëpí em-át e ka rindërtue ndër vjerrsha të veta ku s'mund e prekin as njerzit as koha. Ju ndëjshi me të mirë në të. Natyrisht. (*sjell sýt kah Shuku*) kënaqje e madhe do t'ishte për mue po të shkrepse mbi këto troje të vjetra një diell i rí tue përtrí një jetë të ré me at frymë të kulluet shqiptare ashtu si lëvitte dikur në to... Lamtumirë! (*Ndreka e Ganxhja dalin me të*).

ROZA Amâ... Shum e dijen na shiti madama!

LINA Po ti shef gjithçafën me sý të turbullt, moj motër-shkreta? Ajo mâ njerzishëm s'pat si m'u sjellë me né të gjithë.

SHUKU (*pa i vû vesh asaj bisede*) Po, rrájët lëvizin... (*Me fytyrë të ndezun nga një shëllim i shkrepetitshëm*) Po, qe, unë e ndiej... ndiej një erë jaseminash qi vjen prej shenashinit...

ROZA (*këlthet e trëmbun*) Qyqja, ajo sh'trigë shtriget m'i ká bâ mënjí burrit!

Bjen sivjet njëqindvjetori i lindjes së Poetit **Zef Schirò** (1865-1927) nga Hora e Arbreshëve (**Piana degli Albanesi**). E përkohëshmjja e jonë do t'i bâhet krahu sa të mundet **Qendrës Ndërkombtare të Studimeve Shqiptare** të Palermo-s, qi përgatitë një varg kremtimesh mbrenda këtij vjeti.

POEZIJA POPULLORE E PJANËS

Ka dimër po edhe verë ka nga vit;
isht hënza herë e josme e herë e plotë;
mënatën edhe mbrëmën ka nga ditë...
Ti vetëm po jë një, dhe gjindja e thotë!

O syzezë, meschollë,
krep ke të dredhur si fëgjollë (= lino);
si një dardhë — ti jë e bardhë.
Klofshe dardhë, a klofshe ftua,
s'jë për t'jerë, po për mua...
Eja e puthmë, se të dua!

(Nga « Canti Tradizionali » të Zef Schirò.
Napoli, 1923, pag. 334 e 336)

JETA DHE VEPRA E JOHANN GEORG von HAHN

nga MARTIN CAMAJ

Ky është titulli i botimit të ri që merret gjansisht me jetën dhe veprën e të parit albanolog në kupim të plotë. Auktori Dr. Gerhard Grimm (1) punoi tri vjet rresht në mbledhjen dhe renditjen e landës tejet të gjanë, që pasqyron veprimtarinë e njeriut, që me siguri depërtoi ma thellë se askush tjetër së pakut në shekullin e kaluem në botën shqiptare dhe të Greqisë posa kishte dalë si shtet në vehte. Atyne që u ka ra në dorë « *Albanesische Studien* » (vëllim 1-3, Jena 1854), vepra kolosale e Hahn-it, që me të drejtë mbahet tash më se njiqind vjet themel i studimeve shqiptare, prej të cilës gjuhtarë, historjanë, folkloristë, etnologë dhe gjeografë kanë nxjerrë dhe nxjerrin landë të paçmueshme në lidhje me gjuhën dhe jetën e popullit shqiptar, kuptojnë se ç'randësi mund të kenë paraqitja e gjithmbarëshme e fëtyrës së këtij dijetari të shekullit të kaluem që pasqyrohet në librin e G. Grimm.

Për paraqitjen e nji vepre kaq të gjanë duhej shumë vend, prandëj qita cekën që këtu të parashtroj shkurtimisht vetëm kontributet e veprës në fjalë në lidhje me Shqipëri. Kjo paraqitje ka edhe për qellim që kjo veper e botueme tash shpejt të terheqi vrejten e lexuesave tonë sepse nëpërmjet të saj mund të hyhet shumë lehtë në gjenezën e historisë së albanologjisë.

Për nxjerrjen e nji kuadri të plotë të jetës dhe të veprës së G. von Hahn. Grimm ka shfrytëzue, posë veprave të botueme të dijetarit dhe shënimeve relativisht të pakta botue nëpër revista dhe enciklopedina mbi vehtjen e tij, arkivet e shtetit të Vjenës, ku janë gjetë 85 raporte dhe dy vëllime promemorjesh, që Hahn si diplomat ia ka dergue qeverisë së vet në Vjenë. Auktori ka bërë gjurmime edhe ndër arkivet e familjes së Hahn, ndër arkive private dhe qytetesh, shkollash nëpër të cilat ka kalue dijetari ynë si dhe letërshtëmbimet e njerëzve të shkencës, me të cilët ky ishte në lidhje, si p.sh. të J. Ph. Fallmerayer në Innsbruck, Franz Miklosich, Georg Finley e tjerë bashkëkohorve.

Libri i Grimm përfshin sh'atë kapituj: 1) *Hulumtimet e deritashme mbi jetën e veprën e Hahn-it* (fq. 9-14); 2) *Vjetët në mbretërinë e Greqisë*, ku parashtrohet veprim'arija e H. si gjyqtar në Nauplia, Tripolice e Kalkis, si konsull i përkohëshëm i Prusisë në Athinë. Ky kapitull (fq. 14-106) përmban dhe ngjarjet e rrethanat gjatë kohës si vicekonsull

(1) GERARD GRIMM: *Johann Georg von Hahn (1811-1869) Leben und Werk.* - Albanische Forschungen 1. Otto Harrassowitz. Wiesbaden 1964. 8°. 365 S., 2 Karten, 2 Photos. Kart. DM 48.

i Austrisë në Janinë si dhe dy udhëtimet nepër Shqipëri dhe, mbas një pushimi në Gjermani, këthimi përsëri në Greqi dhe vjetët e fundit në Syra. Në kapitullin e tretë (fq. 114-178) parashtrihen puna e Hahn si jurist në ngritjen e gjyqit të shtetit të ri grek (ky ishte në të vertetë doktor drejtsije) si dhe përpjekjet për zhvillimin e tregtisë dhe të organizimit të rrjeteve diplomatike austrijake. Nga përshkrimi i ngjarjeve e turbullimeve si të vendeve nën Turqi ashtu në Greqinë e shpërueme, lehet me kuptue se sa thellë kishte depërtue konsulli austrijak në mendësinë e njerzëve dhe në shpirtin e kohës së vështirë që kalojshin këta popuj.

Hahn na del dhe si ndërmarrës i dorës së parë në projektet për ndertimin e hekurudhës (kapitulli IV, fq. 179-192) për të gjatë të Ballkanit në drejtim të Moravës e në luginë të Vardarit deri në Salonik që do t'i ndronte faqe jetës ekonomike të kësaj treve. Ky plan u realizue vetëm mbas shumë vjetësh së vdekjes të konsullit.

Në kapitullin e V (fq. 193-285) në «përpjekjet shkencore të Hahn-it» Grimm paraqet një pasqyrë mjaft të hollësishme të kontributeve të këtij dijetari mbi gjuhë, folklorë, histori dhe etnografi të Shqipërisë dhe Greqisë, nësa në kapitullin e gjashtë (fq. 286-329) pasqyrohen vehtja dhe vepra e Hahn-it imtësisht në sytë dhe në gjykimin e bashkëkohorve. Ky kapitull ndahet: 1) Gjykimi i bashkëkohorve; 2) konsulli dhe diplomati; 3) dijetari; 4) njeriu; 5) krahasimi me bashkëkohorët.

Kapitulli i fundit (VII, fq. 330-364) i quejtun «*ekskurse*» bân fjalë mbi burimet e landës dhe vendet se ku gjinden si dhe mbi përmbajtjen shumë me randësi të dy promemorjeve mbi mbarimin apo zhdukjen e perandorisë otomane e fatin e popujve sidomos të Rumelisë që e përbâjshin.

E mbyllin veprën një aparat bibliografik, regjistri i vehtjeve dhe dy karta gjeografike 1) zhvillimi i rrjeteve hekurudhore së Europës mes 1858-1868, 2) udhëtimet e Hahn-it në Europën juglindore.

Georg von Hahn ra për të parën herë në kontakt me Shqiptarë kur qe emnue vicekonsull në Janinë (1847). Në këshillet që i jep konsullit të ri eprori i tij Anton von Prokesch-Osten, janë dhe fjalët: «... të më mbani në dijeni mbi karakterin, fuqinë dhe përpjestimet e levizjeve në Shqipëri. Mos merrni para syshë vetëm kufijt e Epirit si qark të vretjeve tueja politike, por zgjanonje vretjen tuej sa më thellë të mundeni» (fq. 50). Por Hahn nuk u kufizue vetëm në punën e vet si diplomat, por menjherë iu vû studimit të shqipes. Si mjet duket se së pari pat vetëm gramatikën shqipe të Xylandrit (Frankfurt, 1835).

Këtu njofti dhe dy Shqiptarë, atëherë nxansa të gjimnazit të përmendun grek Zosimos, që i ndihmuen Hahn-it të mësojë shqipen. I pari qe Apostol Panagiotides nga Llabova, «të cilit megjithse zotnonte mirë greqishten e vjetër, frengjishten e italishten, nuk i kishte ra kurr ndër mend të shkruaj dishka në gjuhën amtare ase të mendojë theoretikisht mbi të», kështu që ky kishte mbetë krejt i habitun se si diplomati austrijak me vullnet e duresë i ishte vû zotnimit të kësaj gjuhe. Panagiotides u bâ mjek dhe mblodh katër pralla shqipe për Hahn-in (fq. 201). I dyti qe Konstantin Kristoforidhi, i cili mbas të gjitha gjasave duket se mbas shembullit të dijetarit të huej i lindi dëshira t'i kushtojë gjuhës shqipe të gjithë jetën e vet.

Hahn sa pat vû bazat e njoftunisë së shqipes u dha mbas mbledhjes së folklorit shqiptar. Landën e zgjanoi dhe e përmirsoi edhe gjatë udhtimit të parë nepër Shqipni. Por dy udhtimet në tokën shqiptare e vunë në kushte dijetarin të fitojë një njoftuní të sigurtë si askush para tij mbi popullin dhe vendin tonë. Si shkak udhtimi qenë gjithmonë arsyesna diplomatike. Hahn duket se kishte vû në dijení ministrinë e jashtme në Vjenë se Shqipnja terhiqte vemendjen e ndoj fuqije europjane, sepse Prokesch në udhizimet që i nepte në rasën e udhtimit të parë nepër Shqipni i shkruente: «*Sikurse e keni vû ju vetë në dukje, nga fuqitë e jashtme kryesisht ást e interesueme Anglija që të ketë një ndikim në Shqipni*» (faqe 56).

Nga ana tjetër një ndër arsye të udhtimit ishte dhe informimi mbi gjendjen e katolikve në veri të Shqipnisë që ishin në at kohë nën protektoratin e monarkisë austrijake si mbas traktateve të caktueme me kohë me Portën.

Hahn u nis me 22 korrik 1850 nga Janina në drejtim të Gjino-kastrës, prej kah tue kalue nepër Delvinë e Kaninë mbririni në Vlonë. Në Myzeqé e kapi malarja, por ai vijoi rrugën në drejtim të Peqinit për në Durrës. Konsulli ka sy të vrejë gjithshka, jo vetëm për njerëz por edhe për përshkrimin e vendit. Mjerisht përshkrimet e udhtimit të parë kanë humbë. Si mbas të dhanave të Grimm edhe në udhtimin e parë Hahn shënonte gjatë rrugës që ndiqte çdo gjá që shifte, shtëpija hane e sidomos konfiguracionin e vendit. Hahn ka mbetë për gjeografë si pioner i dheshkrojës së Shqipnisë.

Sa kalon lumin Mat, i hapet një botë e re para syshë: burrat shkojshin të armatosun dhe verës njerzija flente nepër çardaqe jashtë. Në Shkodër vuen mâ se dy muej nga ethet dhe ást i shtrënguem të kthejë në atdhe. Në Gjermaní vehet në lidhje me dijetarët e kohës dhe i njofton mbi gjuhën e folklorin shqip. Ndër ta ást për t'u përmendë August Friedrich Pott, Oskar Ludwig Bernhard Wolff, një nxanës i të cilit E. Martin merr dhe mësim prej Hahn-it vetë mbi gjuhën shqipe.

Mbas 13 vjetësh Hahn kthen përsëri në Shqipni. Me 12 gusht 1863 zbarkon në Durrës i përcjellun nga fotografi Székely. Ky udhtim ást i përshkruem në librin *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*. Band 1-2. Wien 1867-1869. Si diplomat Hahn ka dhe tjera arsye të ndërmarrë një udhtim kaq të vështirë për at kohë, por duket se atë mâ tepër se çdo gjá e intereson objekti shkencuer i shtyem nga djega e kureshta të zbulojë fusha të reja hulumtimesh. Kësaj herë i përgatitun si duhet gjindet në krye të një ekspedicioni të vertetë. Në krahinën e Matit sillet kot mun një herë udhton dhe shtatë orë për të ra në gjurmë të kangëve popullore mbi Skanderbegun. Shënon doke e zakone. prralla, besime e gojdhana popullore. Asgjamangut duket se Hahn nuk mundi në një kohë të shkurtë të hyjë në mentalitetin e shqiptarve të veriut, sepse posë bukurisë së vendeve, pasunisë së pyjeve i ranë mâ tepër në sy të metat, si p.sh. gjakmarrja, grupet e bandave që bijshin pre nepër fusha e rruga. Këto cilsí negative në sytë e europianit të qytetnuem bânë përshtypje tronditse, kështu që tue pa në Prizren organizimin e xhandermerisë turke, që mund të krahasohej me policinë e një vendi prandimuer, gëzohet dhe shef një përparim të madh kah civilizimi i kësaj treve. Nga ana tjetër nuk duhet harrue se kon-

sullit në këtë ekspedicion i ndodhen dy incidente, një herë tue u kapë në Bishkas dikush lëshoi një batare pushkësh mbi ekspedicion dhe Hahn-it i kaloi për rrëshit një plumb. Të dytën herë qenë plaçkitë dy njerëz të tij në rrugë mes Kosovës e Shkodrës. Përshtypje i bâni sidomos zotsija e notëtarve që me rrëshiq dhe pa rrëshiq kalojshin Drinin lehtsisht. Nji dam i madh është humbja e fotografive në Vjenë, që Hahn i levdon shumë dhe mendon se janë «fotografitë më të daluna mirë» të asaj kohë. Hahn vren dhe typrat fizikë të shqiptarve dhe mendon se janë të ndryshëm.

Prej faqës 193-216 Grimm përpiket të japë një pasqyrë të hollësishtme mbi veprimtarinë e dijetarit në degën albanologjike. Si dihet vepra kryesore e Hahn-it në këtë lamë është «*Albanesische Studien*». Lajmet rreshtueme hjedhin dritë të plotë mbi gjenezën e kësaj vepre, këto njoftime janë të nxjerruna nga letërshtëmbimi mes Hahn-it dhe dijetarve të cilve ky u suell për ndihmë si dhe nga recensionet e ndryshme mbas daljes së blejve në dritë. Asgjamangut, me gjithë mendimet e ndryshme të auktoriteve shkencore mbi këtë vepër monumentale, shumë sende mbesin hapët për diskutim dhe kështu që mendimet e të dy palëve duhej t'i shtrohen një vlersimi kritik. Vetëm mbas një shoshitje të tillë mund të dalë e drejta në shesh. Në këtë mes besoj se është e vendit të theksohet se Hahn është një jurist dhe njeri i rrahun me çashtje reale të jetës ku duhet një logjikë e mpëjtë, prandej përvoja e tij në renditjen e në mbledhjen e landës në terren në shumë pika është shembullore dhe për hulumtuesit e kohës së soçme. Ankohet gjithmonë se ai si lajk në degën e filologjisë mund të gabojë. Mirëpo pikrisht cilsija e tij si njeri i pashtitruem në metodat p.sh. gjuhësore të kohës, prandej edhe pa paragjykime rregullash e formulash të caklueme, i ndihmoi Hahn-it shumë herë të gjente një rrugë të mesme dhe të përshtatun në përshtkrimin e gjuhës shqipe. Hahn nuk i njipte tekstet e vjetra të gegnishtes dhe megjith atë ai ia duel të diktojë dhe fizionominë e shqipes. Ky është i pari gramatolog që tue marrë në shqyrtim të dy djalektet kryesore të shqipes përpiloi një gramatikë. Këtë rrugë ndoq mandej me sukses mësuesi dhe nxanësi i Hahn-it Kostantin Kristoforidhi.

Si puna e çdo pionerit kështu dhe hulumtimet e Hahn-it përmbajnë disa naivitete. Ky në përpjekje për të qitë në letër gjuhën shqipe u përpoq të bijë në gjurmë të ndoj alfabeti shqip. Rasësisht i ranë në dorë shkrojat e përdoruna prej disa priftësh orthodoks në jug të Shqipnisë dhe në Elbasan në omelinat e veta. I bindun se kishte gjetë shkroja të vjetra mija vjeçare, sajue nergut për gjuhën shqipe, lajmoi shumë shkencatarë të vendit të vet. Miklosich, sigurisht jo i bindun për zbulim, e kshillon që të presë e mos t'i botojë aq shpejt. Hahn vdiq i bindun në zbulimin e vet. Mbas hamendjet shqiptarët e dijsin me kohë se një alfabet i tillë ishte i ri, por që R. Nahtigal i pari që vuni në dukje mbas shumë kohe se ky shkrim ishte një kursiv i stilizuem grek i shekullit 18, me shtesat e nevojshme për t'iu përshtatë gjuhës shqipe.

E çmueshme është landa e mbledhun mbi zakonet «familjare» si fejesa e martesës, me ceremonitë e darsmës, të vorrimit, «institutet» e kumbarisë, të gjakmarrjes etj. Nuk la në njanë anë as besimet e ndryshme, si sherimet magjike, flijen e gjakut, orët e rojsat e shtëpisë

dhe të vizareve të mshefuna nën tokë dhe tregimet mbi vampira. Edhe mbi këto përpjekje të dijetarit bân fjalë G. Grimm.

Problem që e rroku me shumë entuzjazëm, që i kushtoi kohë dhe mund, që përrardhja shqiptare. Pyetjet që vuni Hahn dhe më parë se ai Thunmann e Xylandri qenë dhe janë tema diskutimi ndër rrethe të dijetarve tash më se një shekull e gjysë. Argumenti i përsëritun në këtë drejtim për të provue se shqiptarët qenkan «pelasgjit e rij» qenë spjegimet dhe interpretacionet e mitologjisë nëpërmjet fjalësh shqipe, gjâ që vijuen mandej dhe shkrimtarët arbreshë, Dorsa, De Rada etj. Kjo metodë dhe këto pikpamje qenë dënue nga bashkëkohorët e Hahn-it si p.sh. të kundërshtarit të *filohelenizmit* Fallmerayer si dhe nga dijetarët e mëvonshëm (krh. Grimm, fq. 204vv.).

Nga disa vrejtime të Dr. Grimm (fq. 203) del në shesh se Hahn kishte shumë njoftunë e përvojë dhe kuptim për të ra nën ndikimin e plotë të filohelenizmit. Në këtë pikë ai mbajti një rrugë të mesme megjithse ndeja e gjatë në Greqi dhe lidhja e bashkëjetesa me popullin grek nuk e lanë të shlirohet plotsisht nga kjo rrymë romantike.

I tepruem më duket kujdesi i Dr. Grimm që vehtja e Hahn-it të jetë sa më shumë e sqarueme. Æsht e vertetë se mungojnë të dhana mbi jetën e dijetarit, po pikrisht për këtë arsye nuk duhej të humbte në endje të tepërta për të zbulue tiparet e tija më intime. Për sa i përket sqarimit të veprimtarisë së Hahn-it më duket se na mjafton të dijmë se që një njeri i mbyllun dhe plot frigë që mos të gabojë në dhanjen e gjykimeve. Përpushja e mbrendëshme e tij dhe dyshimet e vashdëshme zbulojnë në Hahn-in typin e gjurmuesit të vertetë.

Vepra e G. Grimm është kontribut sidomos dhe kryesisht për historinë e albanologjisë shumë pak deri në sot e zbulueme. Dhe pikrisht për këtë arsye përsëriten gabimet e vjetra në çdo lamë të kësaj degë. Nga ana tjetër gëzohena se tue qenë kjo theza e doktoratit, G. Grimm ka shumë kohë përpara që dhe këtu e mbrapa të merret me historinë e njerzëve, sidomos gjermanë, që aq shumë banë për këtë degë shkencore.

Metoda që ndjek Grimm në zbulimin e vehtjes dhe veprës së Georg von Hahn është shfryzimi i imtë i çdo dokumenti dhe informimi, një mozaik mija e mija copash (vepra në fjalë ka 2335 nota) prandej sigurisht auktori do të ketë të drejtë kur thotë në parafjalë se është vështirë të ketë mbetë ndoj dokument mbi Hahn-in e veprën e tij pa u gjetë e shfrytzuë. Të gjitha vehtjet që kanë ra në lidhje me Hahn-in janë të sqarueme. Ndër këta emna gjëjmë Kristoforidhin si dhe diplomatë austriakë në Shqipni dhe mbasardhsat e tyne, si p.sh. Paul Ballarini, Tedeschini, mandej klerikë si Mons. Karl Pooten etj. Shumë të randësishme më duken lajmet mbi kryengritsat shqiptarë Gjon Lekën e Rrapo Hekalin që na i njoftim më tepër nga kangët popullore si fëtyra legjendare. Natyrisht ndryshej i përshkruen konsulli i Austrisë (krh. fq. 135).

E ndijmë për de'yrë në fund të kësaj paraqitje të përshëndesim ndërmarrjen e prof. G. Stadtmüller dhe shtëpisë botuese Otto Harrassowitz për hapjen e një serie botimesh mbi albanologji (*Albanische Forschungen*) tue dishrue që numri një i kësaj serie të bëhet njëqind.

BIR'I NËNËS!...

nga VASIL D. ALARUPI

Një sëmundje e papritur e kishte shtënë Laken e Todit në shtrat e pas një javë lëngate ia kishte dërguar shpirtin në botën e amëshuar. Kështu, e mjera Ngjelinë, kishte mbetur e vechë me tre fëmijët: Ndreçin, Sotirin dhe Nerënxën.

Kur i ndanë murgut Lake për shpirt, pas mot-moti, Ndreçi kishte hipur më 16 vjeç. Ishte një djalurçinë akoma por i shëndoshë, i sgjuar edhe i kishte vënë gjoksin punës, i ndihmuar më sa qe e mundur nga e ëma, sepse i vëllaj edhe e motra qenë edhe të parritur.

Lakja kishte qënë një nga ata bujqit e vegjël plot urtësi e punëtor i palodhur, kursimtar e tejshëkonjës. Andaj punës së tija bujqësore s'i mungonte gjë. Pas vdekjes u kishte lënë një kasolle me tri të ndara, me një copë kopësht përpara të rrethuar me gardh e me një dy-tri rrënjë pemësh që bënin hije në verë e jepnin fruta të shijëshme; një vënd mjaft të gjërë prapa ku qenë ahuret për pendën e qévet, për kalën e samarit edhe lopën qumështore me viçin e saj; kosherja, koleshka e qerrja. Dy ara jo shumë larg banesës edhe një luadh të vogël me një sërë shelgjishtash për ane. Andaj shpirti i tij bekohej me mirënjohje me gjith plagën e thellë në zemër edhe zbrastësirën e madhe në vatër q'u kishte lënë çdukja e të dashurit të tyre.

Ndreçi tani merrej me punët që kryente i ati, edhe kur këto e lejonin, shkonte në mal me një grumbull bashkëfshatarësh për të bërë dru.

Por me gjith të mirat që kishin trashëguar nga murgu Lake, jeta ishte, si më parë, varfanjake, se mezi arrinin t'a ngrynsin motin me prodhimet që s'mjaftonin. Kjo kishte qënë një nga merakosjet e mëdha që ia zhubroste ballin dëndur bujkut Lake kur ishte edhe mysafir i kësaj jallaneje. Mendonte se fëmijët, të cilët i deshte porsi shpirtin e vet, qenë një barrë e rëndë edhe priste sa t'i bëheshin për punë që t'i merrnin krahun.

E kështu me disa fshatarë të tjerë kur ktheheshin nga pazari të shtunavet mbrëma, duke qarë hallet, kishin arritur në ca vendime, po që gjëndja e tyre ekonomike nuk u lejonte t'i vinin në sbatim.

— Po ja mor Loni, mirë thua ti, po navllos si t'ia bëjmë? Or' po s'të duken të rinj këta djem? — ia priste Lakja mikut të tij së cilit i qe mbushur mëndja top e deshte të dërgonte djalën e vetëm në kurbet.

Këtë çështje Lakja e kishte pleqësuar një ditë me gruan, e pajjalë ajo s'para dukej e vendosur sepse s'i pëlqente t'a ndante të birin nga

vatra familjare në një moshë aqe të re edhe mudohej t'ia kthente atë mëndje të shoqt. I vinte një varg me arësytetime përpara, edhe më-
nëfund dashurin e saja nëneje për birin e madh të konakut.

Kështu ishte rrutulluar moti e murgu Lake s'qe këthyer më n'atë kuvëndim, të pakën në shtëpi. Pastaj ardhi e përlau sëmundja, në moshë akoma të re, edhe hapi plagën e pashëruar në zemër të Ngjelinës.

* * *

Asi vafti Turku sundonte Vëndin e Shqiptarit. Ngjarje të mëdha kishin filluar të tronditnin shpirtrat e njerëzisë. Flitej për kryengritje, për Xhon Turq, për luftë...

Flitej në fshat edhe për disa kurbetllinj, të cilët kishin hikur n'Amerikë prej ca kohësh edhe kishin filluar të dërgonin parà në shtëpit e tyre nevojtare. E këto gjëra ngjallnin shpresa edhe futnin zili në shpirtrat e atyre njerësvet plot ëtje për të dalë nga jeta varfanjake në një tjetër më të lehtë që t'ua hiqte anghthet e t'u lejonte të punonin me këngë në gojë e jo me afshe që çkatërronin mushkëritë.

E një ditë të shënuar gushti, pas kishe, miku i Lakes, Loni, u-ngrit e vajt në shtëpi të Ngjelinës. Djemtë ishin jashtë e losnin me doce në shesh të fshatit; Nerënxa ndër shoqe.

— Gëzuashi Ngjelinë, — ngjatjetoj Loni, e passi përkëdheli qenin që i tundte bishtin, hyri brënda i pritur me përzëmërsi nga e zonj' e shtëpisë.

— Mirë se na vjen, Loni.

Dal nga dal, duke pirë kafënë e me shumë njerëzi bujku çeli kuvëndin. I kujtoj Ngjelinës miqësin e gjallë e vëllazërore që e lidhte me të ndierin Lake edhe mënëfund ardhi në thelbin e qëllimit që e kishte shtyrë të bënte atë vizitë.

— Unë dalldisa, ô motër, — tha — dalldisa edhe Zoti m'a bëftë mbarë. Vendosa të dërgoj Riken në kurbet. Si mik i shtëpisë s'ate, moj Ngjelinë, ardha të t'a them se këtë punë, si e di, e kisha pleqësuar edhe me murgun Lake. Ti ç'ke ndërmënd për Ndreçin?

Ngjelina u-tund vëndit duke thënë:

— Më rrofsh Loni, më rrofsh, Zoti të bëftë si të do e bardha zemër. Përçapja jote më dëshmon se je mik i vërtetë, po unë s'kam djallë për kurbet. Ndreçi, përveç që është i vogël akoma, qëndrôn direk i shtëpisë s'ime.

— Po janë moshatarë me Riken t'im, ô Ngjelinë, — ia preu fshatari.

— Ashtu vërtet, ô kurban, po shtëpia jote e ka direkun, e ç'direk! Kurse unë jam e vetëme. Dy fëmijët e tjerë i kam gërdhuzër. Më prishet shtëpia, më prishet. Jo, jo Loni. Nuk mundin.

Përpara qëndresës që mori Ngjelina, Loni nuk u-çarमतòs. Filloi t'i tregojë ç'kishte dëgjuar në qytet nga miqtë dhe njerzit e tij që i dinin punët e Qeverisë; i përshkroi si mudi edhe rreziket e luftës që kërcënonte të pëlcase, po Ngjelina nuk u-bind. Ajo i nxori edhe shkaku e navllos që s'e kishte, të-mallit që kush t'ia punonte. E kështu Loni iku duke thënë:

— Mendohu, Ngjelinë, mendohu motër. Unë ia dua të mirën shtëpisë s'ate, për ndryshe si do kuxonja të hapnja gojën...

Me gjithë që Ngjelina qëndroi e paepur, diçka i mbeti në zemër. Zu t'a bluajë në mëndje gjithë bisedën që pati me Lonin e të peshojë të mirën e të keqen që mund t'i ridhte nga një vendim aqë i madh për t'ardhmen e vatrës së saja.

Një të dielë, në kishë, mori vesh se edhe dy-tre bujq të tjerë kishin vendosur të dërgonin djemtë në kurbet. Njëri syresh ishte bilë në kushte mjaft të vështira. Kjo gjë e turbulloi më shumë, edhe si u kthye në shtëpi vendosi të flasë me Ndreçin.

— Të të them të vërtetën, Nëno, jo se s'e kam pasur në mëndje një qëllim të 'tillë, se edhe i ndieri baba m'a kishte thënë një ditë, ashtu larg e larg; po unë s'kam dashur të t'a hap atë muhabet, se e di që s'të pëlqen. Pastaj këtu kush të na e punojë mallin? Veç që duhen edhe mjaft para për udhëtimin e largët. Dal të rritet Sotiri, pastaj shohim . . .

— Ashtu, ô përgjërë! e nënës, ashtu më rrofsh e më patsh uratën.
— U-përgjigj Ngjelina, edhe e la atë bisedë, po pak si e turbulluar. Pas ca ditësh dërgoi edhe thirri Lonin.

Me t'ardhur bujku, Ngjelina hapi fjalë mbi kurbetin. Deshte të dinte shumë gjëra. Si ishin ato vise, sa larg qenë, sa para duheshin për udhëtimin e një varg pyetjesh të tjera, së cilavet Loni iu-përgjigj me sa qart i qe e mundur, duke u-sgjatur mjaft edhe duke përshkruar kurbetin ashtu si e kishte dëgjuar.

— Këta janë djem punëtorë, ô motër, e budallenj hiç s'i kemi deh. Disa vjet atje mbushen me para. Ne na shpëtojnë nga hallet edhe vehten e tyre e nxjerin në selamet. Shyqyr të themi që na e hapi Zoti këtë udhë, se si do bënte kjo njerëzi e varfër, Ngjelinë! Ja, ne të shkretët u-shojtmë së punuari një të tërë e ç'prokopë kemi parë! Aty jemi me atë çikë gjë mall që kemi trashëguar, gjysh-stërgjyshi. Mos kemi mundur të vemë gjë nga vehtja jonë? Rrobtohemi e rrobtohemi e gjenë me hiq-e-mos-këput kjo jeta jonë. Oh! nuk duhet të qahemi se na vret Perëndja, po pse t'i bjemë së mirës me këmbë? . . . — Foli Loni me tërë forcën e shpirtit të tij prej fshatari të ndershëm. — Unë do të shes atë arën që kam pranë kishës, se m'a paguajn mirë. Jo që mjafton për navllon e Rikes, po edhe xheç më mbetet.

Ngjelina e kishte dëgjuar me kujdes edhe ishte pothuaj bindur nga fjalët e mikut, andaj pyeti me interesim:

— Po unë si t'ia bëj, ô kurbane, si t'ia bëj? Jam menduar gjatë e sikur s'para më mbushet mëndja, e djalit i pëlqen të niset, po ay është i mirë e s'do të m'a prishë.

— Ngjelinë, ti nuk je edhe aqë keq. Pa vështro se ç'bëri Kóvi; vu vefë të vetëmen arë që ka edhe vendosi t'a dërgojë të birin n'Amerikë. Tashi do të të them edhe një gjë: Lakja, i ndrittë shpirti ku ka rënë, kur bisedonim për këtë punë, më kishte çfaqur një mejtim. Deshte t'i binte në kokë luadhrit që të nxirte navllon për Ndreçin.

— Po arat kush do m'i punojë, Loni? . . . A e ke shkuar ndërmënt këtë gjë?

Biseda vashdoi akoma, edhe passi i rahnë mbar'e prapë të gjitha, arritnë një përfundim: Ngjelina do të shiste kalën, qetë edhe luadhin. Ato para që do të nxirte jo vetëm që mjaftonin për shpezat e udhëtimin të të birt por i mbeteshin e ca më njanë. Punimin e aravet vetë Loni e merrte përsipër me kushtet më të mira.

Vapa kishte ikur me gushtin. Grynjat ishin korrur me kohë e misrat vjelur. Dru'e dimrit vënë stavë. Mullaret e kosheret radhitur pranë ahurevet. Fshati i tërë i qe pregatitur kohës së gjatë të dimrit i cili trokiste ndër dyer me vjeshtën që kishte filluar të rëzojë fletët e veshkura të pemëve. Qielli kishte marrë ngjyrën e hirit e lagështija sundonte kudò.

Ngjelina kishte shitur luadhin, qetë e kalën edhe pregatitur djalën për kurbet. Por sa i kishte dhëmbur zemra kur i nxori nga dora gjith ato pasuri! Lotët i kishin rjedhur rrëkë nga mallëngjimi. I kujtohej i shoqi e i dridhej buza nga një si merakosje e fshehtë që as ajo vetë s'arrinte të kuptonte. Me gjith ato e kishte mbledhur vehten. Fundja ajo po plotësonte një nga dëshirat që vetë murgu Lake kishte ushqyer.

Atë ditën e hënë kur Ndreçi u-bë gati me torbën më sup, me paratë të siguruara pas trupit në një qemër e me një shkop në dorë, u-përqafua dhemshurisht me t'ëmën, me vëllanë edhe motrën e u-premtoi atyre se së shpejti do të kthehej me tërë të mirat. Pas porosivet edhe bekimevet të nënës, pas lotëvevet që derdhë të gjithë, Ndreçi i ra me këmbën e djathtë gjymit me ujë vendosur mbi ca dru në prak të portës duke dalë nga kasollja. Pastaj bënë kryqin e Perëndisë edhe u drejtuan për nga kisha.

Ndreçi ecte me nënën më njanë e motrën e vëllanë më tjatrën. Ecte me hap të vendosur e kokën lart. Dukej si m'i madh se nga herë, edhe në syt e të dashurvevet të tij merrte një pamje si prej gjigandi, i cili po vinte t'i bënte luftë varfërisë, t'a mposhte e të kthehej fitonjës, duke sjellë në vatrën stërgjyshore gjithë të mirat që jep kjo botë.

E duke ecur, Ndreçi hidhte vështrimin e tij të përmallur e plot zjarr më tërë anët. Deshte t'i shëkonte edhe një herë mirë që t'i mbeteshin të puthitura në tru tërë ato pamje të vetishme të fshatit ku ay për herë të parë kishte parë dritën e diellit, ku qe rritur e ku kishte shkuar vitet e ëmbël të jetës së tija të re. Ja sheshi ku loste me doce me shokët moshatarë. Ja mulliri me ujin plot shkumbë të jazit ku laheshin në ditët e nxehta të verës. Ja çezma me sylynjarin që derdhte ujët e saj të kulluar në posatfin prej druri. E atje qëndroi. Piu ujë edhe lau sytë. Atje vinte edhe bandilla me bucelën... Ajo sy-zeza e bija e Gjelit... Ja edhe kisha me çatin'e unjtër, me kambanoren edhe varret rrotull. Oh! sa herë që i kishte rënë asaj kambane ay, kur ishte m'i vogël. Diçka sikur ia shtrëngonte fytin, sikur i përthante qiellzën, sikur i turbullonte mëndjen. Aty afër kishës udhëza fushore që shpinte në qytet, me vargun e pasosur të ferrishtevevet për anësh. Njerzit e fshatit qenë grumbulluar atje për të përcjellë pesë nga djemtë në kurbet. Bëhej zhurmë nga të biseduarit, nga porositë, nga lutjet. Gratë fshihnin lotët me shamí e fëmijët me kurriz të duarvet. Mërgimtarët ishin sulmuar nga prindët q'i kishin bijt e tyre prej kohësh andej.

— Të m'i bësh shumë, shumë të fala, të m'i bësh; t'i thuash se jemi mirë me shëndet, hë kurban!

— T'i thuash se e muarrmë kartën taukllli me gjithë çekun, i lumçin krahët. Amàn mos harrosh edhe porositë që të bëra dje...

— Hiç mos ki kasavet, hiç mos ki kasavet...

— Mos harròsh t'i thuash se blemë një arë, aty pranë kishës...
 — T'i marrish myshdenë se nus'e Lazit na polli një djalë!
 — Posi, posi hiç mos ki qeder...
 — Të hapni sytë djem, të hapni!...
 — Se mend harrova!: t'i thuash Tilit se lopa na bëri një viç!...
 Të puthura, përqafile, urime, lotë... edhe mërgimtarët që si-
 guronin:

— Hiç mos kini merak... Hiç mos kini merak...
 — Hajde djem, Zoti ju qoftë në ndihmë e bëfshi një udhë të mbarë. Të hapni sytë e të na nderoni dhe mos harroni, djem, se gurr'i rëndë në vëndin e tij është. Bëni kryqin e Perëndisë, djem, bëni...
 Djemt u-kthyen nga ana e kishës e u-falnë. I puthnë dorën uratës, e përqaftuan, puthnë edhe një herë nënat e gjith të dashurit, e të shoqëruar nga Loni, muarrnë udhën... Atëhere shpërtheu një e qarë e përbashkët e gravet, e fëmijëvet, e pleqvet... Ndonjë djalosh rrinte i dëshpëruar duke menduar kur do t'i vinte sëra edhe atij të merrte atë udhë...

Dal nga dal udhëza e ngushtë që çante përmez fushën e gjërë sikur zu t'i përpijë n'atë farë mjegulle të lehtë që kishte rënë porsì e ndezur nga rëzet e një dielli të shkëlqimtë.

* * *

Njëri pas tjetrit, muajt qenë rrukullisur me shpejtësi. Letrën e parë në fshat e mori Loni, i cili i hidhte lotët si breshër nga mallëngjimi. I biri e lajmëronte se që të gjithë kishin arritur shëndosh e mirë. Pastaj mori letër edhe Kovi; mend fluturonte nga gëzimi se i biri e lajmëronte se kishte zënë punë edhe i dërgonte dollarët e parë që të fillonte të paguante borxhin. Edhe dy nga djemt e tjerë dërguan letra e jepnin çkoqitje të gjëra. «Pa ç'dynjallëk qënkërka këtezaj, ô babi! — shkruante Mihali. — Këtu vëndi është i madh, i madh sa s'ta pret mëndja edhe kasabatë aqë të gjëra edhe ka aqë njerëzi sa që të duket sikur humbet possi bleta në kosheren. Pópo se ç'tu bëka syri dhjetësh e se ç'më t'u fryka gjoksi krenarisht se s'paske xhandërma turq këtej. Puna nuk është më e rëndë se në vëndin t'onë, po jeta, për bes't, është jetë pe njeriu...».

Vetëm Ngjelina ishte me zemër të thyer, sepse asnjë lajmë s'po i vinte nga i biri, edhe më kot u shkrojtì shokëvet të tij që t'i theshin gjësend.

Kështú ridhte koha e në shtëpin e Ngjelinës varfëria shtrydhte e shtrydhte zemrën e saja e, me gjith që i kishte shtrënguar rypat, mezi ia dilte. Po Loni s'e linte të vuajë. Gjithënjë i tregohej mik i ngushtë. I sillte drutë për dimër nga mali edhe arat ia punonte si për vehte që të prodhonin sa më shumë. Edhe ay vetë ishte dëshpëruar me sjelljen e atij djali që iku e më s'u bë i gjallë, e sa do që mendohej, nuk arrinte të kuptonte shkakun. I vinte keq për të mjerën grua edhe më tepër vërrosej edhe pendohej sepse ay vetë qe bërë shkakëtar për nisjen e Ndreçit në mërgim.

(vazhdon)

Kronikë Kulturore

PROF. SCHIRÒ N'AKADEMËN E ARKADIS

Prof. Zef Schirò jr., Ordinar i filologjis dhe i historis byzantine n'Universitet të Romës, ásht emnue në këto kohnat e fundit Antar korrispondues i Akademís s'Arkadis, një ndër má të vjetrat e qytetit të Romës, si çmim për veprimtarin e Tij kulturore. Studjuesi arbresh ndër këto vjet ka pasë edhe tjera dishmina e njoftje të meritue: dekorata Oficjer i Madh i Urdhënit Gjergj I të Greqís, Oficjer i Madh i Urdhënit «To Phoinikos»; emnimet si antar korrispondues i Institutit venecjan të Shkencave të Letrave e t'Artit, antar efektiv i Deputetsís së Historís s'atdheut për Kalabrí e Lukanje; antar nderi i Shoqnis shkencore t'Athinës, antar korrispondues i Philologhikòs Sylogos «Parnassòs» gjithënji t'Athinës dhe emnimin si Sekretar Kombtar i Studimeve byzantine.

Bashkëpun'orit t'onë të përndritshem, Arbreshit qi ushqen thellësisht kultin e traditave stërgjyshore e vepron me zëmër të flakët për naltësimin e vlerave të përbashkëta ethnike, Redaksija e së përkohëshme «Shêjzat» i paraqet përgzimet má të nxehta për suksese qi po vjen tue korrë në lamiye të kulturës, sukses qi bredh me dritë lavdije në krejt gjinden gjakut shqiptar.

Ekspozitë e ré e Lin Delís

E paprëme ásht veprimtaria artistike e piktorit shqiptar, tashmá në zá ndër bashkatdhetarë e të huej, z. *Lin Delija*. Në selin e Sekcjonit VAS në qytetin Aquila gjatë muejvet kallënduer-fruer të k.v. ka mbajtë t'ekspozuem veprat piktorike të tija má të fundit. Ndër to zgjuen interesim të veçantë *Samaritani shpirtmirë*, *Pijetore*, *Djali plang-prishës* e *Portreti i «Dritës»*. Ekspozita e Delís ka pasë sukses publiku e kritike. Po citojmë vetëm fjalët e kritikut *An. Co.* të fletores «*Il Nazionale*»: «Arti i Delís, si krejt arti i vërtetë, flet një gjuhë të gjithunjishme. të pastër, të stërqartë dhe na sjell një *message* (lajmim) ngushullimi e shprese, pa i lëshue pë kurrkund modës së çasit».

Të lumët, Lin Delija, e të paçim sa malet!

Programi i Festivalit të Filmave Balkanikë

Simbas lajmeve që ka dhënë Agjensia Turke (A. A.) me 15 Shkurt 1965 delegatët e Turqís, Shqipëris, Bulgarís, Greqís, Jugosllavis edhe të Rumanisë, janë mbëledhur me 27-29 Janar 1965 në kryeqytet të Bulgarisë, ku në këtë datë e sipër është pranuar unanimisht «Statuti i Festivalit të Filmave Balkanikë».

Ky demarsh kishte filluar me vendim të Komitetit Kombëtar të UNESCO-s, që ishte mbëledhur në Maj të kaluar në Bukuresht.

Qëllimet e Festivalit janë caktuar si vijon:

a) Të bëhet një afrim reciprok në

lemë të kinemave balkanike.

b) Të njoftohen zhvillimet kinematike të popujve balkanikë, edhe të pregatiten filma më të vlefshëm.

c) Të realizohet qellimi i UNESCO-s në një bashkëpunim reciprok.

d) Të tërhiqet kujdesja e rrethanave kulturore ndaj veprimeve kinematografike.

e) Të naltësohet niveli i dëshirës artistike të popujve balkanikë...

Në Festival të Filmave Balkanikë do të marrin pjesë Shqipëria, Turqija, Greqija, Jugosllavia, Bullgaria edhe Rumania.

Ç'do festival do të vazhdojë një javë midis 5-15 gusht. Simbas programit vitërat janë caktuar kështu: Me 1965 do të bëhet në Bullgari; pastaj me radhë më 1966 në Turqi, më 1967 në Rumania, më 1968 në Greqi, më 1969 në Jugosllavi edhe më 1970 në Shqipëri.

Thuhet akoma se:

— Ç'do shtet do të ketë të drejtë të paraqitë dy filme të gjata.

— Nuk do lejohen ata filma që do jenë kundra idealit të UNESCO-s.

— Ndër këto festivale mund të marrin pjesë edhe firma të tjera që nuk janë nga viset e Ballkanit.

— Në kohë të festivaleve do të organizohen edhe konferenca artistike, kulturore e rreth çështjes kinematografike.

— Në thema të filmave nuk do lejohet të bëhen propaganda kundra popujve përkatës, dmth. në dëm të intereseve balkanike.

Që sot, kanë filluar punimet turistike për të tërhequr shumë turistë. Një komitet prej bulgarësh e jugosllavësh kanë ardhur në Turqi zyrtarisht për të shqyrtuar punët në fjalë.

N. A.

FOGGIA INTITOLA UNA VIA A MICHELE MARCHIANO'

Siamo informati che il Sindaco di Foggia ha proposto al Consiglio Co-

munale d'intitolare una via a **Michele Marchiano** che nel Liceo Statale di quella città insegnò per una lunga serie di anni, lasciando viva e buona memoria di sé. Esprimiamo al Sindaco della prosperosa città pugliese la nostra gratitudine di Albanesi per aver voluto così altamente onorare un insigne scrittore consanguineo che amava di pari affetto le due patrie, l'Albania e l'Italia, operando a favore di entrambe sia nel campo del patriottismo che in quello della cultura.

LAUREA DI ARGOMENTO ALBANOLOGICO

Il 17 febbraio 1965 la Commissione di laurea, presieduta dal Preside della Facoltà di Lettere e Filosofia della Università di Roma, prof. Alberto M. Ghisalberti, ha approvato con una buona votazione la tesi presentata dalla candidata signorina *Giuseppa Consalvi* di argomento albanologico: « *La Nazione Albanese* » di *Anselmo Lorecchio* e i suoi contributi alla letteratura e alla storia dell'Albania. E' un lavoro utile sulla funzione rigeneratrice del periodo italo-albanese che, dal 1897 al 1924, seguì e commentò le vicende albanesi nelle fasi storiche più cruciali attraversate dai destini della giovane nazione adriatica. L'ingente materiale raccolto con lodevole impegno di vari anni dalla Consalvi, aveva bisogno di una più rigorosa e illuminata selezione per essere in equa proporzione inquadrato nei limiti di una tesi. Sovente la candidata appare sopraffatta dalla molteplicità dei problemi da mettere in rilievo e vagliare alla luce dei nuovi progressi segnati dalla albanologia, specie nel campo delle ricerche storiche, negli ultimi trenta anni. S'avverte nei primi capitoli, un difetto di senso prospettico: avvenimenti di importanza capitale sono valutati e considerati spesso alla stessa

stregua di altri meno rimarchevoli. Comunque la tesi testimonia un'onesta e diligente cura dedicata alla raccolta del materiale, si distingue per l'obiettività dei giudizi i quali tengono sempre in prima linea le giuste ragioni del popolo albanese e contiene alcuni capitoli degni d'ogni considerazione, come quello su « *I pretendenti al trono albanese* » e gli ultimi tre della tesi che accompagnano con appropriato e misurato commento le vicende dell'Albania dalla proclamazione dell'indipendenza alla Conferenza della Pace di Versailles.

Primo relatore era il Prof. Koliqi e correlatore il Prof. Giuseppe Schirò.

Alla neo-dottoressa *Giuseppa Consalvi*, la redazione di « *Shêizat* » porge le più sue vive felicitazioni per il conseguimento della laurea in lettere e filosofia con una così appassionante dissertazione di storia albanese.



SEGNALAZIONE

Nel settimanale di Cosenza « **Cronaca di Calabria** » del 18 febbraio 1965 (Anno LXIII - n. 10) è apparsa a firma dello studente universitario **Vittorio Longo**, — Segretario del Comitato Promotore di Macchia Albanese — un'ampia, vibrante e colorita cronaca delle celebrazioni in onore del Poeta Girolamo De Rada svoltesi nell'ottobre 1964 nelle comunità italo-albanesi in occasione del 150° anniversario della nascita (1814-1964).

Cogliamo l'occasione di ringraziare la Direzione del giornale Cosentino, uno dei più antichi della provincia, che dal suo primo apparire ha sempre seguito con illuminata simpatia vicende e manifestazioni italo-albanesi. In esso il compianto Cesare Minicucci pubblicò i suoi articoli su scrittori e patrioti italo-albanesi (Girolamo De Rada, Domenico Mauro e fratelli Mauro, Generale Damis ecc.).

QENDRA NDËRKOMBTARE PËR STUDIME SHQIPTARE

Miqvet t'onë

U bâjmë thirrje miqvet t'onë që nuk janë në rregull me regjistrimin e tyne si antarë të « Qendrës », të kujdesen të dërgojnë taksën vjetore për vjetin 1965.

Kemi besim se asnji njeri nuk do të mohojë ket akt aderimi, i cili, ndonsë është i lidhun me një detyrim të lehtë, është shumë i dobishëm për të mbajtur gjallë një nisjativë, sikursë është kjo e « Qendrës së Studimevet Shqiptare », e cila, tue marrë para sysh qellimin e naltë për të cilin është themelue, është në zemrën e të gjith atyne që të ketë sukses dhe vijim punimi për ruejtjen e traditavet t'ona e të gjuhës s'onë arbreshe.

Do t'u jemi mirënjohës gjith atyne që do t'u përgjigjen kësaj thirrjeje tue dërgue aderimin dhe taksën vjetore, në mënyrë qi emnat e tyne të munden të radhiten në listën e Antarvet të Vjetorit (Annuario) 1965, që është në përgatitje për botim.

Vjetori 1965

Tue fillue prej këtij vjeti nisë botimi i « Vjetorit » të Qendrës Ndërkombëtare për Studimet Shqiptare.

VJETORI do të përfshijë lajmet vjetore të veprimtaris akademike të « Qendrës », me tekstin e konferencavet të ndryshme, mësimë, e kumtesa, kronikën dhe lajmet kryesore të lëvizjes shkencore e kulturore shqiptare, ashtu edhe listën vjetore të misavet.

VJETORI 1965 është në shtyp dhe do të botohet për së shpejti.

Do t'u dërgohet falas gjith antarvet të « Qendrës » rregullisht të regjistruem.

I pari Qindvjetuer i lindjes së Poetit

ZEF SCHIROIT

(16 me 10-8-1865 - vdekë me 17-2-1927)

« Qendra » ka në qellim të kremtojë si duhet jetën, veprat e Poetit t'onë dhe albanologut ZEF SKIROIT në qindvjetorin e parë të lindjes së Tij,

tue qënë se ká lé në Pjanën e Arbreshvet me 10 gusht 1865.

Do të jepen má vonë lajme të hollësishme mbí programin e çfaqjevet krentimore, por qysh tani dishrojmë t'u bájmë të dijtun Antarvet t'onë pikat kryesore që vijojnë:

Me 10 gusht 1965: fillimi i çfaqjevet me një përkujtim krentuer fetár në Kishën e Madhe të Pjanës s'Arbreshvet, nderim i vorrit të Poetit në vorrezat e Pjanës dhe zbulim i njëj mermeri përkujtimuer në shtëpin ku Ai ká lé.

Të dielavet që vijojnë do të zhvillohen përkujtimet në Kolonit e tjera arbreshe të Sicilis.

Me 26 dhe 27 nánduer do të mbahet Kuvendi i IV Ndërkombëtar i Studimevet Shqiptare në Palermë.

Me 28 nánduer në lidhje me «Festën e Flámurit Shqiptár», përkujtim krentuer i ZEF SKIROIT n'Universitetin e Palermës.

Palermë, 21 fruer 1965

KRYETARI

On. Dr. ROZOLIN PETROTTA

DREJTORI

Prof. At ZEF VALENTINI



CENTRO INTERNAZIONALE DI STUDI ALBANESI

Ai nostri Amici

Rivolgiamo vivo appello ai nostri Amici, che ancora non lo hanno fatto, di voler provvedere alla loro regolare iscrizione come Soci del « Centro », inviando la relativa quota annua, per il 1965.

Abbiamo fiducia che nessuno negherà questo atto di adesione che, se comporta qualche lieve onere, gioverà immensamente ad incoraggiare e a sostenere una iniziativa, come questa del « Centro di Studi Albanesi », che, per gli elevati scopi che esso persegue, non può non stare a cuore a quanti, amando la nostra tradizione e la nostra lingua, desiderano che l'iniziativa abbia successo e continuità di vita.

Saremo grati a quanti invieranno sollecitamente la loro adesione e la loro quota in modo che i loro nomi possano essere inclusi nell'Elenco dei Soci dell'ANNUARIO 1965, di prossima pubblicazione.

Annuario 1965

A cominciare dal corrente anno 1965 si dà inizio alla pubblicazione dell'ANNUARIO del Centro Internazionale di Studi Albanesi.

Esso conterrà il resoconto annuale della attività accademica del « Centro », col testo delle varie conferenze, lezioni e comunicazioni, la cronaca e le notizie principali sul movimento scientifico e culturale albanese, nonché l'elenco annuale dei Soci.

L'ANNUARIO 1965 è in corso di stampa e di imminente pubblicazione.

Sarà inviato in omaggio a tutti i Soci del « Centro » regolarmente iscritti.

1º Centenario della nascita del Poeta

Giuseppe Schirò

(nato il 10-8-1865 - morto il 17-2-1927)

Il « Centro » si propone di rievocare degnamente la vita, la figura e le opere del nostro Poeta e albanologo **GIUSEPPE SCHIRO'** nella ricorrenza del 1º centenario della Sua nascita, essendo Egli nato a Piana degli Albanesi il 10 agosto 1865. Riservandoci di dare notizie sul programma dettagliato delle manifestazioni, possiamo sin da ora informare i nostri Soci ed Amici che il programma si svolgerà secondo i seguenti principali punti:

10 agosto 1965: inizio delle celebrazioni con solenne commemorazione religiosa nella Cattedrale di Piana degli Albanesi, omaggio alla tomba del Poeta nel Cimitero locale e scoprimento di una lapide commemorativa nella casa dove Egli nacque.

In varie domeniche successive si svolgeranno le commemorazioni nelle altre Colonie albanesi di Sicilia.

Nei giorni 26 e 27 novembre: IV Convegno Internazionale di Studi Albanesi in Palermo.

Il giorno 28 novembre, in coincidenza con la « festa della bandiera albanese »,

solenne commemorazione di GIUSEPPE SCHIRO' nell'Università di Palermo.
Palermo 21 febbraio 1965

IL PRESIDENTE

On. Dr. Rosolino Petrotta

IL DIRETTORE

Prof. P. Giuseppe Valentini

Lajme Shqipnije

(Marrë nga Rađjo - Tirana)

Shtohen librat dhe lexuesat

Tiranë, 27 kallënduer 1965

Bibliotekat shtetore po bëhen gjithnji e më shumë qendra të randsishme të përhapjes dhe leximit të librit. Sivjet numrit të tyre do t'i shtohet edhe një bibliotekë e ré qi do të ngrihet në Gramsh. Punë e mirë është bërë për shtimin e fondit të librave të tyre. Në të 25 bibliotekat e shtetit numrohen mbi 1.000.000 volume librash letrare e artistike, tekniko-shkencore, politike etj. Vetëm biblioteka kombtare në Tiranë ka 409,650 libra të llojeve dhe gjuhve të ndryshme. Fonde të mdhá librash kanë edhe bibliotekat e shtetit në Korçë, Durrës, Vlorë, etj. Gjatë vitit të kaluar vetëm nga biblioteka kombtare janë tërhequr për lexim mbi 127.000 libra, nga biblioteka e shtetit në Korçë 74,500 libra, nga ajo e Fierit 27.000 etj. Nji punë e gjërë për përhapjen e librit dhe leximin në masa të gjëra punojse, po bëhet edhe në fshat. Qendrat e ktyre aktiviteteve janë bërë bibliotekat që janë ngritur pranë 1100 vatrave dhe shtëpive të kulturës të kooperativave në të cillat ka tani mbi 600.000 volume librash.

Artista shqiptarë në Kubë

Tiranë, 29 kallënduer 1965

Populli i Havanas duertrokiti nxehtësisht grupin e artistëve shqiptarë të

Theatrit të operas e të baletit për koncertet e tij me shumë sukses. Në koncertin që dhanë solistat shqiptarë për Universitetin e Havanas, kishte një pjesëmarrje të madhe dhe gjat çfaqjes pati duertrokkitje të vazhdueshme. Sukses të madh pati edhe koncerti që dhanë artistat tanë sëbashku me artistët kubanë në Theatrin e operas « Garcia Lorca ». Këngëtarët u shoqruan nga orkestra e operas dhe pianistja Lola Gjoka. Mbi 1500 veta duertrokkitën vazhdimisht dhe shpesh herë brohoritën për suksesin e këngëtarve shqiptarë. Në mbarim të koncertit, grupe të ndryshme u dhuruan artistëve tu fa me lule, shumë kuban ju merrnin atyre firma, i përgëzonin për suksesin dhe i përshndesnin nxehtësisht.

Veprimtari artistike argëtuese

Tiranë, 3 shkurt 1965

Trupat artistike profesioniste të qytetit të Tiranës me anë të çfaqjeve të ndryshme po japin një ndihmë të mirë për edukimin dhe argëtimin e klasesave punojse. Theatri popullor gjatë këtij sezoni do të vejë në skenë pjesë të reja. Me interes ndiqen nga punonjësit çfaqjet qi jepen nga theatri i estradës së shtetit, ansambli shtetror i këngëve dhe i valleve popullore dhe ansambli akrobatik; tani këto trupa janë të preokupuara me festivalin kombëtar të këngëve popullore qi do të zhvillohet nga mezi i muejit shkurt. Ansambli shtetror i këngëve dhe i valleve popullore po pregatitet qi këtë radhë të dali para spektatorve me një seri vallesh tematike kushtuar punës dhe jetës së ré qi ka lindur në vëndin tonë, për ti arritur këtij qëllimit ndihmë po japin edhe koreografët më të mirë të vëndit. Trupa e estradës së shtetit do të jap së shpejti premjerën « nga festivali në festival » ku do të përshihien këngët më të bukura të tre festivaleve të këngës në Radio, të fe-

stivalit të parë kombëtar të këngëve popullore si dhe të atyre qi janë zhvilluar në qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës. Ajo po përgatit gjithashtu një premjerë tjetër me titull « varjet letrare muzikore », në të cilën trajtohen problemet qi ngrehi plenumi i k. q. të partisë qi u mbajt në korrik të vitit të kaluar. Edhe trupat teatrale lokale po përgatiten për të vënë në skenë pjesë të reja.



Ekspozitë pikturash në Tiranë

Tiranë, 9 shkurt 1965

Sot pasdite në një nga sallat e pallatit të kulturës « Ali Kelmendi » u hap ekspozita kombëtare e arteve figurative me tematikë nga puna dhe jeta e klasës s'onë puntore, organizuar nga Këshilli Qëndror i B.P.SH. dhe Lidhja e Shkrimtarve dhe e Artistëve të Shqipërisë. Fjalën e rastit e mbajti skulptori i popullit Odhisë Paskali. Pastaj u prë sheriti dhe të pranishmit vizituan ekspozitën. Në ekspozitë janë paraqitur rreth 80 punime të piktorve, skulptorve dhe grafikve të vëndit.



Lajme Kosove

Ekspozita e pikturave dhe skulpturave t'artistëve të Kosovës e Metohisë

Në kuadrin e manifestimeve të ndryshme, që u mbajtën në Prishtinë për nderë të 20 vjetorit të çlirimit të qytetit e rrethinës, në foajeun e Teatrit popullor krahinor u hap ekspozita e pikturave dhe skulpturave t'antarëve të Klubit të piktorëve e skulptorëve të Kosovës e Metohisë. Në praninë e Jovos Shotrës, antar i Sekretarjatit të Ko-

mitetit krahinor të Lidhjes së komunistëve dhe sekretar i Komitetit komunal të LKS të Prishtinës dhe një numri të madh puntorësh kulturalë e publikë të qytetit, ekspozitën e hapi Hasan Mekuli, kryetar i Pleqsisë për arsim e kulturë të Kuvendit të komunës së Prishtinës.

Në fjalën e tij përshëndetëse Hasan Mekuli, përveç të tjerash, propozoi që ky manifestim i randësishëm kultural, që po mbahet sivjet për nderë të Dittës së çlirimit të kryeqytetit të Kosovës e Metohisë, të bahet manifestim tradicional dhe të pagëzohet me emnin « Takime piktorale të Nandorit ». Në këto takime do të paraqiteshin me punimet e veta, jo vetëm piktorat e Prishtinës e të Krahinës sonë, por edhe brushat e njohtuna nga mbarë Republika socialiste e Serbisë dhe viset tjera të vendit tonë.

Ekspozita e klubit të piktorëve e skulptorëve të Kosovës e Metohisë, përveç në Prishtinë, do të mbahet edhe në disa qendra tjera të Krahinës sonë. Asht për t'u theksue se kjo ekspozitë ka zgjue interesim të dukshëm në mesin e dashamirëve t'arteve figurative.



Disa fjalë rreth kualitetit të përkthimeve

Në një numur bukur të madh veprash të përkthyme s'lypset që njeriu të ketë kush e din çfarë kulture gjuhësore ose të jetë ekspert për t'i ra në sy fjalë, fjalë e pjesë të tana që nuk përkojnë fare me natyrën e gjuhës dhe logjikën e saj. Kështu, tue shfletue faqen e parë të romanit *Klasa e kryengritjes* të letrares së shqueme jugosllave Desanka Maksimoviq, në përkthim të Hikmet Gusisë, botim i SGB « Rilindja », na ra në sy, ndër fjalitë tjera, edhe kjo:

Kjo erë vërshonte oborret fqinje të ndame me gardhiqe të brishta?

Nuk duhet me mendue shumë për të mundë me konstatue se çka e ban këtë fjalë të jetë kryekreje e paqëllue me. Kurdo që njeriu nuk kujdeset me respektue veçantinë e gjuhës, ai domosdo do të përdori një fjalë në vend të një tjetre e kështu e lëndon dorë-mënjë natyrën e gjuhës. (Mishi mund të jetë *i brishtë* e kursesi *gardhiqel*).

Këto e shumë gabime të kësaj natyre bahen rëndomë prej pakujdesisë s'atyne që shkruajnë ose përkthejnë, për ma keq, ndoshta, pse atyne nuk ua kap veshi kuptimin e tingëllimin që ka e mund të ketë një fjalë në fjalë.

Mirëpo, gabimet e lëshimet ma të mëdha zakonisht bahen vetëm për shkak se një numër bukur i madh i përkthyesëve tanë marrin me përkthye pa përfillë edhe ato elemente primare të gjuhës, kështu që bajnë që përkthimi i tyre të dali kryekreje i fjalëpërfjalshëm e njeriu me vështirsi shumë të madhe mundet me ia gjetë fillin mendimit. Si, ta zamë, në këtë fjalë:

Edhe tash, sikurse para pesëmbëdhjetë vjetësh, tue i fërgue, ajo rregullonte që të mos kenë trajta të drejta, me plot asi veshësh e bishtash të vegjël dhe sqepësh, si i quejshin fëmijët, sepse u pëlqejshin ma shumë të këtitllë.

Për këtë fjalë dhe tjera kësodore s'mbetet tjetër me thanë pos se asht një shembull tipik i anagramatizmit total dhe pasqyrë e mirë e nivelit të kulturës gjuhësore të përkthyesit.

Përkthimi i fjalëpërfjalshëm, madje, ban që edhe mendimi t'alternojë, për ma keq, edhe të jetë krejtësisht i pakuptueshëm si në këtë fjalë:

Ajri, i valzue me prej erës diku nga lumi, e vërshoi përnjherët me një erë mjalte e të ndonji baroje të fortë dhe e freskoi menjjherë.

Për të mundë me e kuptue këtë fjalë e fjalitë e tilla, duhet me të vërtetë mund i madh, sepse ashtu si asht shtruar vështirë mund ta zbërthejë le-

xuesi i nivelit të një nxansi të shkollës së mesme, të cilit i dedikohet kjo vepër.

Ose, po marrim një fjalë tjetër që, përkaq mënyra e shtrimit dhe mendimi i alternuem, thuese nuk ndryshon aspak, por asht identike si ajo e para:

Ajo mendoj me kënaqsi që, qe paska ende gjana për të cilat i kishin rrujtë simpatitë e tyne të dikurshme fëmijore.

A asht kjo, pra, vetëm një lojë fjalësh apo konstrukt gramatikor? Do të jetë, para së gjithash, rudiment i zvetnimit të gjuhës që, s'asht aspak me randësi, asht ba me vetëdije ose inkoshiencë.

Madje, nuk janë aspak të rralla as fjalitë në të cilat jo vetëm që s'pëlqehen kohët e foljeve, por edhe bahen gabime flagrante sa i përket përdorimit të drejtë të nyjeve, lidhëzeve, parafjalëve etj., si në fjalinë:

Gërshetat, që dikur i mbante të lëshueme për shpinë, padyshim sikurse edhe e bija, tash i kishte çue mbi ballin ende të ri.

Jemi të mendimit se kjo fjalë e shumë tjera që bien në sy tue shfletue këtë vepër, nuk duen kurrfarë komentimi, sepse ato janë shembujt ma markant se si s'duhet të flitet e të shkruhet.

E këtitllë ose pak ma karakteristike asht edhe kjo fjalë:

Edhe ajo, sikurse Emilija, ishte e zbetë, e hollë, qëndrimi i saj kishte diçka të mendueshme dhe të vajzës.

Tue lexue veprat e këtitlla të përkthieme, që u dedikohen kryesisht fëmijëve, imponohet çashtja si e sa do t'u ndihmojnë ato fëmijëve me mësuë drejt e mirë gjuhën, madje, edhe çfarë mund të jetë efekti i përkthimeve të këtitlla në formimin e tyre të drejtë në përgjithsi.

JAK MITA

Nxjerrë nga « Jeta e Ré »

Nr. 5 - shtator-tetor 1964 - Vjetit XVI

Zi në Qendrën e Studimevet Shqiptare

Qendra Ndërkombtare për Studimet Shqiptare, që e ka selinë e vet në Universitetin e Palermës, humbi, menjëherë mbas vdekjes së Prof. Antoninit De Stefano, edhe një antar tjetër të vlefshëm, bashkëthemeluesin e vet Prof. Giuseppe Cocchiara, Presid i Fakultetit të Letraveve qysh prej vjetit 1950. Vdekja e Tij është edhe një herë më e dhimbëshme pse ishte në një moshë kur mund të zhvillonte veprimtarinë e vet edhe për një kohë të gjatë (kishte lé në vjetin 1904) në fushën etnografike e në lamën e studimevet të traditaveve e t'artit populluer sicilian.

Na të «Qendrës së Studimevet Shqiptare» e qajmë humbjen e Tij edhe për arsye se në Të kemi pasë një përkrahës të çmueshëm. Këtij do t'i a dijme në qoftë se sot kemi Selinë e Studimevet t'ona, ku i kemi bënë vend Bibliotekës Albanologjike, ku Kathedra e Shqipërisë zhvillon mësimet, ku priten e qiten albanologë e miq të Shqipërisë, ku studentët gjëjnë botime këshillimesh për thezat shqipe e ku këta mund të pihen me profesorët e vet për udhëheqjen e punimevet të veta. I ndiem Cocchiara, posá u krijue Fakulteti i Magjisterit në gjí t'Universitetit, u interesue që të shtíhej në programin e studimevet mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe; me anën e Tij, qysh prej këtij vjeti akademik 1965, u bënë mundun që katedra e shqipërisë t'i hapte dyert mësimi të gjuhës s'onë. Prof. Cocchiara na ka ndërrue gjithnjë me pjesëmarrjen në çfaqjet t'ona kulturore e në krentrimet t'ona kombtare. Çdo vjet, për festën e 28 Nándorit, e kemi pasë në mes t'onë, ku me fjalën e vet të ngrohtë i uronte Shqipërisë ditë të mbara. Na ka dashtë Cocchiara!

Emni i këtij miku t'onë të vërtetë

është i njoftun jo vetëm në Itali, por edhe në rrethet studimtare ndërkombtare për ndihmesën e dobishme që i ka dhënë studimit të kulturës lëndore e shpirtnore të popullit të Sicilis, bir i së cilës Ai ishte. Botimet e Tij në këtë fushë janë të shumta: në vjetin 1923 dha në shtyp librin e parë «*Popolo e Canti della Sicilia di oggi*», që pat jehonë të gjallë në qarqet folkloristike; e ndoqën ket botim dy vepra të tjera, jo ma pak të dobishme se e para, «*Le Vastate e gli Studi delle tradizioni popolari in Sicilia*». Prej vjetit 1926 deri 1929 Cocchiara gjindet në Firenze për të ndjekë mësimet e mjeshtravev Mochi e Pavolini; ndërkohë qet në dritë manualin «*Folklore*» dhe vëllimin «*L'anima del popolo italiano nei suoi canti*». Prej vjetit 1929 deri 1933 e shofim në Oxford për të bashkëpunue me ethnologun e anthropologun polak Malinovski-n dhe boton «*Folk-love of the folk-song*», «*La leggenda di Re Lear*», «*Il linguaggio del gesto*». Ministrija e Arsimit t'Italis e ngarkoi me rregullimin e Muzeut Ethnografik Pitri të Palermës; më vonë u bë drejtuer i tij, dhe me vullndetin e punën e zellshme që tregoi në ket Institut Shkencuer, e bëni këtë një ndër më të përmendurit e Europës.

Veprimi si ordinár i Historis së Traditaveve Popullore në Universitetin e Palermës. Në këtë ndërkohë nuk pushoi së botuemi vepra të vlefshme, si p.sh. «*Il linguaggio della poesia popolare*», «*Il Diavolo nella tradizione popolare italiana*», «*Il mito del buon selvaggio*», «*Pitri, la Sicilia e il folklore*», «*Storia del folklore in Europa*» (për këtë vepër i u dha çmimi *Marzotto* dhe çmimi ndërkombtar *Pitri*). Përveç këtyne, kemi prej Tij edhe «*Il Paese di Cuccagna*» ashtu edhe «*Popolo e letteratura in Italia*».

Fitoi një emën të përmendun si Sekretár i Përgjithëshëm i Akademisë së Shkencaveve, të Letraveve e t'Arteveve të

Palermës, qe antár i shum Akademive të hueja. Prof. Cocchiara qe nderue me laurën « honoris causa » nga Universiteti i Athinës.

Familjes së Tij i parashtrojmë përdhimbtime të ndieshme.

Karl Gurakuqi

Konsuli shqiptar Nikolaus Rotta vdiq në Vjenë

Me 15 shkurt në Vjenë ndërroi jetë prof. Nikolaus Rotta, ish konsul i Shqipërisë për shumë kohë në kryeqytetin e Austrisë dhe mësimdhënësi i shqipes në atë Universitet. Njeri i butë, i pritun, i gatëshëm me ndihmë Shqiptarët që i u siellshin për drejtim e përkrahje, lën një



Dr. Nikolaus Rotta

kujtim të thellë në të gjithë ato që e njoftën për s'afërmi. Shumica e Shqiptarvet banuesa në Austri dhe një tubë e thukun miqësh austriakë e ndoqën të ndiemën ndër salikime mortore. Dalloheshin në mes tëjervet Primarius dr. univ. Kolonja, dr. Cara e dentisti Bobrati. Mbi vorr dr. Nush Bushati mbajti bisedën që po kujtojmë më poshtë. Zojës Rotta, e cila me dashuni shembullore i u gjet burrit në nevojë e mëdhaja të pleqnës dhe i qe gjatë krejt jetës ngushullim i pashterrshëm, redaksija e « Shëzavet » i drejton përdhimbtime më të sinqerta.

Mbi trupin, para se të vorrohej, me zâ të thekun dr. Nush Bushati, mik i vjetër i të ndiemit, mbajti fjalimin që vazhdon:

Leu Nikoll Rotta para 85 vjetsh prej një familjes t'njoftun në Shkodër. I vllaj i madh Simoni këjë një ndër më të parët piktor shqiptar, e i dyti P. Justin, françeskan, shkrimtar shumë i njoftun. Nikolla, që këmi ardhë për t'i dhanë përshtetjen e fundit, këjë nxënësi i shkollës fillore françeskane dhe i shkollës s'mjesme teknike-tregtare të Kolegjes Sh' Françesk Saverit. Atëherë Austri-Hungaria interesohej për Shqypni dhe merrte djelm t'rij për t'i mësue: kështu dhe Nikolla këjë marrë në Austri ku kreu më s'miri shkollën pedagogjike për mësues. Kah vjeti 1911 këjë dërgue si mësues në katundin shqiptar t'Borgo Erizzo afër Zarës për t'mësue gjuhën shqipe, e në 1913 këjë dërgue në Vjenë, pranë Dr. Pekmezit, si këshilltar i Ministris s'Punvet t'Jashtme për çashtje shqiptare e kujdestar i Shqiptarvet që vijshin në Austri. Ishin gjithnduersh Shqiptarët që vijshin atëherë në Austri. Më e shuma ishin studenta, stipendista ardhë për t'vashdue mësimet në shkollat e mjesme e Universitete t'Monarkis; — të smuet që vijshin për t'gjetë shërim në

mjeksi të shkollës s'famëshme vjeneze; — tregtarë për të shtue e zmadhue marrëdhënjet ekonomike, — e last not least, politikâj shqiptarë qi vijnshin për t'gjetë këshille e ndihmë morale e financjare për vendin e tyne. Nuk e dij a është legjendë a e vertetë, por thohet se flamuri kuq-e-zî qi këtë shtjellue n'Vlonë me 28 Nanduer n'çpalljen e pamvarsis këtë qepë n'Hôtel Huberthof n'Josefstadt t'Vjenës; fakt është edhe se shumë mjek vjenez, ndër t'cillët dhe mjeku privat i Frano Zefit, Internisti i famshem Prof. Ortner, mjekojshin gratis t'gjith Shqiptarët qi vijnshin në Vjenë. A pse Shqiptarët ishin mësue a për të tjera arsylene, pelegri-naaxhi i Shqiptarvet n'Austri vazhdoi shumë kohë edhe mbas çpalljes s'pamvarsis.

Vijnshin studentat e shkretë, shumë herë pa petka n'shtat e te Rrota gjëjshin këshille e ndihmë, ashtu të smuetit ishin të përcjellun prej tij te mjekët e sanatoriumet përkatse, ashtu tregtarët qi me ndihmë të Rrotës gjëjshin t'interesuemit për lidhjet ekonomike e tregtare. Ç'se u krijue Konsullata shqiptare n'Vjenë kah vjeti 1922 e deri n'vjetin 1926 këtë sekretar i Konsullatës shqiptare; me ket vjet 1928 kje emnue Konsull i Shqypnis n'Vjenë, n't'cillën zyrë vazhdoi deri n'vjetin 1945. U ritirue n'jetën private por gjithënjë u kujdeste përherë për ç'do Shqiptar qi vite n'Vjenë. Sado qi ndoshta karrjera e tij kje modeste si natyra e tij, si nieri kje shumë i vlefshëm pse mbate n'vete ato vehtina qi Goethe kërkon për njeriun: fisnikrin, ndihmardhjen e mirsin. « Edel sei der Mensch, hilfreich und gut denn das allein unterscheidet ihn von anderen Wesen » — (Besnik t'jetë njeri, ndihmdhënës e i mirë, pse vetun keto e dajnë prej kënjevet të tjera) a ket detyrë si njeri Rrota e mbushi n'kuptimin e plotë t'saj.

Sa Shqiptarë sot kur t'ndijnë vdekjen e Rrotës do t'mendojnë me mirnjohje e dhimbë te Rrota e do t'i lu-

ten Perendis për të, Perendis qi n'at jetë t'përherëshme i nep lumnin t'mirvet e prej t'cillit Rrota do t'gjëj pagjë e lumni! Me ket bindje na përshndesim për herë t'fundit mikun e dashatun e Shqiptarin e thjeshtë të cillin s'do t'a harrojmë kurr e vehtinat e tija do t'mundohena me i ndjekë!

At Justin Rrota ndroi jetë

Me 21 dhetuer 1964 vdiq në Shqipni At Justin Rrota, Françeskan e një ndër shkrimtarë më të pastër të shqipes. I ndiem i kishte lindë në Shkodër me 17 Fruer 1889. Studimet e para e të mesme i kreu ndër institute t'Etënvet Françeskanë të qytetit të lindjes, ato të lartat në qytete të ndryshme t'Austris. Qe famullitar në Plan të Dukagjinit ku edhe mbajti një shkollë e mandej të gjitha energjit e veta i dërdhi në Lycén « Illiricum » të Shkodrës tue mësue gjuhë e letrësi shqipe dhe latinishte. E zëllshëmë dh'e paprëmë qe veprimtarija e tij në lamiye të kulturës Shqiptare: vepra gramatologjije, kritike letrare, tregime. At Justin i në prozën e vet tregimtare na lën një she-mbull stylli kristaluer ku qartësija e mendimeve lidhet e shkrihet me një hir shprehjesh thjeshtësisht harmonjose. Ai merr për bazë, si Emzot Prennushi, ligjirimin e hajthëm të grëve shkodrane. Mbi këtë shkrimtar, qi gjatë jetës së vet kushtue gjuhës shqipe me dashuni të pamasë e të parreshtun e qi nuk e pat sa qe gjallë njoftjen e meritueshme, në numrin qi vjen të Shëjzavet ka me shkruë bashkëpuntori i vlerët i ynë, prof. Karl Gurakuqi, i cili të ndiem i pat kolegë e mik.

Libra të lexuem

NDRE MJEDA: *Juvenilia e vepra tjera*. Mbledhur e redaktuar nga Mark Gurakuqi. N. Sh. Botimeve « Naim Frashëri ». Tiranë, 1964. Foermat 79 x 10/32 fq. 1-191.

Asht një botim pothuajse i tansishëm i poezive të Mjedjes, (1) të cilave u shtohen edhe vargjet shkruar nga poeti nërgut për të rij. Vepra ndahet në pesë kapituj. Kap. i parë përfshin një paraqitje të M. Gurakuqit, ku rreshtohen shumë ngjarje nga jeta e panjoftun e Dom Ndreut. Si thotë komentuesi e paraqitsi, personaliteti i Poetit t'onë si dhe vepra e tij pret hulumtime të reja për të dalë në pah si duhet. Mjedja është një ndër figura tona kulturore më të zgjedhuna dhe arti i tij, megjithë shpesh herë në dukje i thjeshtë, i ngjan një kristali të shumanshëm. Një anë të tillë e ven në dukje dhe M. Gurakuqi: Mjedja e urren tiraninë dhe merr pjesë aktive në vëajtjet e popullit të vet. Në kap. e dytë ribotohet në tanësi *Juvenilia* ashtu si e njofim në botimet e parëshme. Kapitulli i III përmban vjerrshat e botueme andej e këndej nëpër të përkohëshme e antologjina, nësa ai i katërti *vjersha të mbetuna në dorëshkrim: Uzdaja e padobí, Iliria dhe Epiri*, kurse në kreun e gjashtë poemthas *Lissus, Lirija, Scodra*.

Një takim përsëri me Mjedjen poet, kështu i tansishëm, kënaq çdo lexues dhe sidomos të duket se nëpër ato vargje që Poeti nuk botoi si të pa denja (Mjedja nuk ishte kurr i kënaqun me punën e vet) si me hy në intimitetin më të ngushtë të botës krijuese të tij. Këtu tregon vetë haptas për ve-

(1) Në fq. 3 me të drejtë vren M. Gurakuqi se Poeti nënshkruhet gjithmonë **Mjedja**, nësa shumë kush në shkrime e në të folun shkruen dhe thotë **Mjeda** gabimisht, ashtu si shënohet dhe në titullin e këtij botimi të ri!

shtirsitë e jetës së tij dhe ankohet deri në at pikë të shfaqë se nuk është i kuptuem:

*Prep m' thote mue Nana:
Merr letrat e kindimin,
Shpesh dija jetimin
E qiti qirak.*

*Me shkrime vet' fisin
Nderova e n'ushtri:
As nam, as lumni
S'm' dha fisi per hak.*

Si dihet, rruga e artit mjedjan që shumë e gjatë dhe e qëndrueshme në limumin e landës e të gjuhës, e sidomos të gjuhës që u shkri në një me landë. Në fillim Poeti shkrou me një rregjistër fjalësh e thanjesh të gjuhës së përditëshme, prandaj aty përdoren dhe fjalë turqe, të cilat mandej Mjedja më vonë i qiroi nga shkrimet e veta tue i zavendësue me skaje shqipe. Vetëm një poet si ky ia duel që ndër këto ripunime mos të prishte freskinë e frymzimit të parë dhe dallohet kështu në rreth të shkrimtarëve tjerë për maturni e siguri trajtash, që përfaqsojnë ndër ne frytet e para të një arti klasik në kuptim të plotë të fjalës. Kjo është një cilsi e Mjedjes që e shofin të gjithë, por mbetet pa zbulue shpirti « idhnak » dhe njëkohësisht thejti i ndijshëm i tij i tëholluem nga një jetë interiore shumë të mundueme dhe të ndritun nga riflekse kulturore të botës europiane në kuptim të gjanë.

M. C.

MILTO SOTIR GURRA: *Plaku i motshëm* - Tiranë, 1959, pp. 143.

Ky libër i M. S. Gurrës që mbjeth prralla, tregime, dialogje dhe 4 rrëfime nxjerrë nga shkrimtarë rusë ka qënë i botuar si lexim për fëmijë. Mund të thomi me të vërtetë se për këta është i përshtatur edhe ndëse nuk vënë më pas prrallavet, të thërritur, mund jetë shumë njëze, nga realiteti i jetës së sotshme. Për Shqipëtarët prra-

llat qenë kurdoherë të dashura e mendonj se do të jenë edhe sot, përndryshej ky libër nuk kish qenë i botuar.

«*Plaku i motshëm*», e para ndër «*Prrallat e Hallë Cepës*» — kështu është e thënë e para pjesë e këtij libri — është një njeri që qe mik i Skandërbegut: ai që vate të e thërrit në Anatoli ku rrinte i harruar për atdheun. Këthyer Skandërbegu në Shqipëri, luftoi kurdoherë për lirinë e atdheut, po, me gjithë se qe gjithëmon mundës, Shqipëria nuk pat liri. Kur ish për të vdis Skandërbegu thërriti mikun dhe i dha Flamurin për t'e ruanej nga duart e armikut ture i thënë të prit ditë më të mira për t'e ngrëne për lirin. Pas asaj ditë kishin shkuar më se katër shekuj, dhe plaku — për këtë i thënë i motshëm — e kish mbaruar urdhërin e Skandërbegut kur në 28 t'Nëndorit 1912 e ngrëjti Flamurin kuq e zi me shqipën dykre-nare në Vlorë. Si gjëndej atje, te një shpi e largtë, plaku ja rrëfianej një natë dicave që kishin arrur te ai të shtyjtur nga era e ftohtë e dimrit. Kishin shkuar shtatë vjet nga dita e lirisë. Atë natë plaku doli ture thënë atyre që kish ndë shpi: — Jam për udhë... Shkoj tutje... Ju rrinin këtu se jini të lodhur... Mund që shpejt të kthehem... Ja tek janë drutë... — Prralla mbaron ture thënë: — Kur u ngrita më të nesërmet, se me kish zënë një gjumë i rëndë, plaku ish kthyer. E vura re se xheq mbante fort në gj... 1919. — Mbaron kështu prralla ture na kujtuar jetën më të mirë të Shqipërisë; atë t'Skandërbegut dhe atë të lirisë pas vitit 1912.

E dyta pjesë e librit — «*Tregime*» — na siell përpara syvet jetën e fmijëvet ture na dëftuar dashurinë për prindët në «*Dashuria e çupës*» edhe atë për shkollën në «*Malli për shkollën*». Mëson atyre të jenë më të butë edhe me shtazë — djalëria është moti i sulmit —: kështu në «*Si hoqa dorë nga së vrari zoq*». Njetër mësim më t'math jep libri i Gurrës: është ai të mos bëhen

shaka, që mund sjellën dëme të mëdhenj, e këtë në «*Si mbeti Pjetri dorac*».

Vlerja një libri nuk i vjen as vetëm nga që është shkruar në të as vetëm nga si është shkruar, po nga dy anët. Këta dy shënime t'vlerjës përpikën te e treta pjesë së librit t'Gurrës, në «*Dialogje*», ndër të cilët dëftomi dialogun «*Atdheu*». Ky është i bënë nga dy fmijë: Aliu, dymbëdjetëvjeçar, dhe Pjetri, njëmbëdjetëvjeçar. Gjithë libri i Gurrës është shkruar për fmijë, po ky dialog, për atë që thot, është për gjithë. Aliu dual nga Shqipëria për një udhëtim bashkë me atin e vet dhe kështu pa e njohi vise dhe fise t'huaj. Këthyer, një ditë ture fol me Pjetrin që mbanej ata që gjënden përjashta për harruame të atdheut i thot sa njëze bëhet miqësi me këta: dashuria për atdhen afëron e lidhen ata që gjënden në vende të huaj. Pjetri atëherë i çuditur thot: — «*Kaq e duan Atdhenë ata që janë të mërguar?*» — I përgjegjet Aliu: — «*Po mor, po! Të të themë të drejtën: edhe pa vajtur në vise të huaja nuk para e kuptonja se çdo me thënë kufi e ç'është ajo vija e kuqe që rethon Shqipërinë e lirë në kartën gjeografike. Tani e di se kjo ndarje cakton kufitë e shteteve të ndryshme dhe na ndan nga kombet sado rotull tyre kemi dhe shumë Shqipëtarë që kanë mbetur të robëruar nënë zgjedhën fqinjëve. Po kjo vije ndan tokën e shënjtë të Shqipërisë».* — Shqipëria është vërtet e ndar; ata që fjasen gjuhën shqipe s'janë gjithë të mbjedhur përmbrenda një kombi vetëm; bota ku jetojnë shqipëtarët që janë jasht kombit shqipëtar, po atij rotull, është e madhe edhe njerzitet shumë. Te ky dialog Shqipëria e ndar folen me anën e auktorit të këtij libri; auktori pra thërret me anën e një djali për të thot më mirë gjithve se kjo ndarje s'është fare e drejtë, dhë shërbesi është aq i dukshëm sa edhe një djal dymbëdjetëvjeçar e vën re. Pse atëherë kjo ndarje? Këtë do të thot auktori.

Mësimi i dhënë te ky dialog, dhë ai të i bëhet nder Flamurit, pse mban vendin të gjithë kombit, janë të mirë për këdo; për këtë kish të lavdërohej auktorit i këtij libri që jep mësimë kaq t'lehtë fmijëve.

Pjesa e katërtë, e nxjerrë nga letërsia ruse për fmijë, është e marr nga auktorët I. Turgenjev (3 copa) dhe D. Mihaillovski (1 copë).

Libri është i përshtatur për fmijët e për prrallat të bukura e për mësimet që jep, dhë, të thomi fjalën e fundme, gjykimi për librin është pozitiv.

E. FRYNERA



FEJA, *Shkenca dhe Kombësija*.

Kam një shok intelektual, i cili nga pikpamja fetare ka ndjenja laike, d.m.th. duke mos qënë fanatik, respektonte singerisht të gjithë besimtarët në botë.

Një ditë feste, kur po kremtojmishim Bajramin e Ramazanit — me 4 Shkurt 1965 — na kishte vizituar në shtëpi familjarisht siç ishte zakoni. Nga shkakun që jemi miq të ngushtë, i pranuan në bibliotekë private. Përnjherë miku ynë filloi të vëzhgojë ca libra të radhitura në etazherë të vogël, dhe syri i mbeti në këto vepra që ishin radhitur së-bashku më një vend:

1 - *Fiftieth anniversary book of the Albanian Orthodox Church in America* (Libri i 50 Vjetorit të Kishës Shqipëtare n'Amerikë), 1908-1958, hartuar prej *Imzot Fan Stilian Noli* (1);

2 - *Bektashizmi dhe Teqeja Shqipëtare n'Amerikë*, 1964, punuar prej Z. *Xhevat Kallajxhi* (2);

3 - *Muhammad the last Prophet* (Muhammedi Profeti Islam), Dy vëllime, njëri Shqip edhe tjetri Inglish, shtypur n'Amerikë 1960-1962, shkruar prej të Përndershmit *Imam Vehbi Ismail* (4).

Për shkak që nuk dinte shqip edhe gjendjen fetare të Shqipëtareve, mi-

kut turk, i dhashë disa shpjegime të nevojëshme, dyke i folur si vijon:

«T'a dini sigurisht se, në mes të Shqipëtarëve, qofshin të krishterë, muhamedanë, bektashí, katolikë, orthodoxë edhe laikë, s'ka as një mosmarrveshje, po thuaj të gjithë veten e tyre e njohën nga rraca ose feja shqipëtare, sektet e feveve ndër Shqipëtarë konsiderohen si specialitete profesionale. Për ata nuk ka luftë fetare, sektorë; lufta e tyre është edhe është vetëm kundra armikëve që vijnë nga jugu, nga lindja, nga veriu edhe nga perëndimi. Se zaten të mos kish ndodhur kështu, nuk do që e mundur që të rronte ky popull kaq i vogël e kaq i vjetër në brigje të Ballkanit der sot, pa patur abetar», etj...

Miku ynë që ishte një Kemalist i vendosur, u kënaq tepër edhe dyke u çuditur më tha:

«Bravo Shqipëtarëvet! Tani e mora vesh fare mirë se nga vjen besa e këtyre bijve të Aleksandrit e të Skënderbeut, të cilët janë për të admiruar edhe për të marrë si shembëll në çështje të bashkimit kombëtar...».

Edhe neve personalisht jemi n'atë mendim se, njeriu sadoqë të ketë ndjenja fetare laike, s'është e mundur të mohojë vlerat socio-morale të fevet të ndryshme. Po mjafton vetëm të jemi intelektualë me tolerancë, dmth. të jemi demokratë të vërtetë!...

Siç dihet botërisht, feja është një fenomen besimi shoqëror, e cila për qe-llim ka të naltësojë moralin e njerëzimit ndaj së drejtës, së mirës e së bukurës; me shprehje ndryshe, botën t'a zëjë xhenet (parajsë) edhe njerëzit engjëj.

Shkenca natyrore e shoqërore, fenë s'e ka mohuar kurrë. Të marrim për shembull, sociologun francez *Emile Durheim*, i cili thotë: «Janë besimet hvjnore, me të cilat formohen sektet fetare, që bashkojnë popujt me një egzistencë shpirtërore».

Edhe krijonjësi i shkencës biologjike, *Claude Bernard*-i freng, thotë kë-

shtu: «Unë kur hyj në laboratuvar, derën e faltore e mbylli; edhe kur hyj në faltore, po mbyll edhe derën e laboratuvarit».

Si edhe formonjësi i Shkollës Aktive, pedagogu i mirënjohur Adolphe Ferrière na këshillon që në «Shkollat e reja, duhet dhenë një edukatë fetare, e jo mësim (enseignements) të fesë».

Shkurtazi: Në vendin ku jeton demokracija realiste, feja edhe sektet e saj, nuk pengojnë ndjenjat kombëtare. Përkundrazi, fetë janë faktorë që forcojnë bashkimin kombëtar. Sepse, sot nuk jemi në Mesjetë, qe këto të bëhen vegla të shteteve imperialiste. Këtë fakt Shqipëtarët e kanë provuar fare mirë.

Dhe tani le të çfletësojmë veprat e bukura të Imamit tonë Vehbi Ismail:

Muhammedi profeti Islam: Kjo veprë e botuar me një karakter edukativ përmban këto lënda:

1 - *Parëthënije:* ku thuhet tekstualisht: «Ky libër nuk është dhe as që kemi pretendimin të jetë një studim i plotë dhe i intë i jetës së Profetit Muhammed. Qellimi i jonë është t'i paraqesim Rinisë Muslimane Shqiptare një pasqyrë besnike të jetës së Profetit në aspektet më kryesore, që kështu t'a njohin Mësuesin e fesë së tyre dhe të jenë në gjendje të kuptojnë mësimet që Ay predikoi dyke paraqitur si shembëll jetën që praktikoi.

Na nuk dyshojmë që Profeti Muhammed ka qenë mishërimi ose personifikimi i Mësimeve Kuranore. Këtë gjë e vërteton dhe bashkëshortja e Tij Ajsheja, e cila kur e pyetën: «Cili është morali i Profetit?», u-përgjeggj: «Moral i Tij është Kurani». ... Mjaf-ton të përmendim Enciklopedinë Britanike, e cila e quan Muhammedin Profetin me sukses-plotë në historinë e njerëzimit...».

2 - *Hyrje:* Kjo ka një karakter tregimor që jep programin e librit. Për të kuptuar methodën e veprës do riprodhojmë disa rreshta nga ky tregim:

«— Baba, a nuk më tregon diçka mbi jetën e Profetit Muhammed?»

— Çupa ime, po të jap fjalën se duke filluar nga e shtuna që vjen, për çdo javë do të flas, pak nga pak, mbi jetën e Profetit.

Mbas këtyre fjalëve doli Fatimeja dhe shkoi në dhomën e saj.

Unë me Luanin ndejtëm së bashku deri mbas mesnat duke kujtuar ditët e ëmbëla që kishim kaluar në bankat e shkollës. Kur u-ndamë i thashë se çdo të shtunë do t'i veja mysafir, që kështu të dëgjoja historinë e Muhammedit ashtu si do t'ia tregonte çupës së vet. Ay u-kënaq pa masë. Kështu që unë vajta për çdo të shtunë tek Luani gjer sa mbaroi tregimi.

Këto fletë që do të leçitni në këtë libër janë përmbledhja e Historisë q'i tregoi Luani Fatimesë. I shkroita natë për natë ashtu si i dëgjoja E tani i botova për ju. Besoj, o të dashur të mij se do të kënaqeni me 'to edhe ju, si u-kënaq Fatimeja».

3 - Nër kaptina të tjera marrin pjesë me radhë edhe lidhur ngushtësisht si një shkrim romani këto lënda: Arabia, Arabet, Lindja e Muhammedit, Foshnjëria e Tij, Muhammedi në Fisin Benu Said, Muhammedi pa nënë, Muhammedi tek i ungjii, Muhammedi në djalëri, Martesa e Muhammedit, Muhammedi bëhet Profet, Besimtarët e parë, Vuajtjet edhe mundimet e Tij, Emigrimi në Abisini, Viti i deshpërimit, Medinasit pranojnë Muslimanizmin, Emigrimi i Profetit, Muhammedi në Medinë, Muhammedi burrë shteti, Mbrojtja e lirisë: Lufta e Bedrit, e Uhudit, e Hendekut; Paqja e Hudejbijes, Muhammedi fton sundonjësit në Fenë Islame, Pushtimi i Meqgesë, Lufta e Hunejnit, Pelegrinazhi i fundit, Vdekja e Profetit, Dukja dhe rrojtja e Profetit, Disa nga cilësitë e Profetit, Reformat që bëri Muhammedi, Disa nga fjalët e Profetit (Hodithe)... Dhe në fund një listë ndihmash, në të cilën 80 Shqipëtarë t'Amerikës, për bo-

tim të librit kanë dhuruar 1450 dollarë.

Jeta dhe veprat e Imam Vehbi Ismaili-t: Imami ynë i dashur, Vehbi Ismaili ka lindur në Shkodër, shkollën fillore e kreu në vent të lindjes. Mësimet e para fetare i mori në Seminar Islam të Tiranës. Më vonë vate në Misir, ku mbaroi studimet e nalta fetare në Universitet të El-Ezhar-it. Me të marrë diplomën me 1945 shkoi në Amerikë, me 1949 u zgjodh Imam i Shqipëtarëve të Amerikës. Me 1957 botoi veprën « *Islamizmi dhe Lutjet* ». Me 1960 botoi veprën e sipër-shënuar, e cila me 1962 u botua edhe inglisht me titull: « *Muhammad The Last Prophet* », 16×24, f. 167, çmim Dollarë: 3,95. Ky vëllim, të tepërmi përmban:

- a) Një *Parëthënje* të veçantë,
- b) Një *Hyrje* të shkruar nga direktori i Qendrës Islame në Washington, Dr. Mahmut F. Hoballah,
- c) Një hartë të Aarabistanit,
- ç) Një fotografi të njëj familjeje muslimane,
- d) Ca fotokopira origjinale nga Kurani,
- e) Dy fotografira nga Qabe-ja në Meqe dhe nga Xhamia Profetjane në Medinë,

f) Një bibliografi,

g) Një kapak-kuverturë mbi lidhje, në të cilin merr pjesë edhe fotografija e Imam Vehbi Ismaili-t edhe shënime bijografike ..

Të shtojmë akoma se autori është në përgatitje e sipër të botojë edhe ca libra të tjera si: *Rreze nga drita hyjnore, Fjalë profetike, Imam Aliu, Fjalë dhe Predikime, Tregime nga historia Islame, Banuesit e Shpellës* (përkthim nga gjuha arabishte)...

Edhe neve duke e uruar nga zëmra Imamin tonë, deshërojmë që edhe këto vepra të tjera të dalin në dritë një ditë më parë.

Prof. N. P. Zhulati

(1) Njoftuar në **Besa** me datë Shtator 1960.

(2) Njoftuar në **Dielli** me datë 28-10-1964, edhe në « **Shëjzat** » me dalë Nëntor-Dhjetor 1964.

(3) Njoftuar në **Besa** me datë 20-12-1964.

(4) Libri shqip botuar me 1960, New York, 16×24, f. 132. Botimi inglisht me 1962 në Iowa, 16×24, f. 167. Që të dy veprat nga pikpamja materiale janë shtypur fare bukur. Mund të porositen tek **Imam Vehbi Ismaili**, 20426 Country Club, Dr. Harper Woods 36, U.S.A.

Nel prossimo numero di marzo-aprile sarà pubblicata la interessantissima ricerca sulla « Pastorizia a Frascone-to » del nostro collaboratore A. B. Frasnjoti.

Preghiamo gli Abbonati che, a causa degli scioperi degli uffici postali alla fine di settembre, non avessero ricevuto il Numero Speciale in onore di Girolamo De Rada, di farne immediata richiesta all'Amministrazione di « Shëjzat ».

PAJTIMTARË TË DASHUN !

Qe, prá, fatbardhësisht Shêjzat po hýjnë në të Nandëtin Vjet të jetës. Thomi fatbardhësisht, sepse sejcili prej Jush e merr me mend sa vishtirsi e mundim e pengime paraqet në vend të huej botimi i nji së përkohëshmje kulturore shqipe. Por, të përkrahun nga ndihma e Juej zëmerbardhë e nga sympathija trimnuese me të cilat keni ndjekë e ndiqni veprimtarin t'onë kulturore, i a dolme m'e mbajtë në kâmbë të përkohëshmen për tetë vjet rresht dhe shpresojmë se do të vazhdojmë t'a mbajmë edhe për disa vjet tjera.

Mos na i kurseni as mbas sodit ndihmesën e këshillet. U lutemi sidomos Pajtimtarvet qi ç'prej numrit të parë na kanë dërgue rregullisht pajtimin, m'e forcue përkrahjen e tyne tue na gjetë pajtimtarë të rij.



AMICI ITALO-ALBANESE E ITALIANI !

Con questo numero la rivista « Shêjzat » (Le Pleiadi) entra nel suo IX ANNO di vita. Con gravi sacrifici d'ogni genere è stata conservata e si conserva in vita. Ha quindi bisogno del Vostro generoso contributo per mantenere il suo regolare ritmo di pubblicazione.

Nelle pagine di « Shêjzat » (Le Pleiadi) gli Albanesi d'Italia troveranno esposti come in una galleria gli splendori del patrimonio degli avi, di quegli avi che stupirono l'Europa opponendosi dietro la guida di Scanderbeg all'avanzata turca in Europa.

Gli Italiani potranno gustare la rude e nel contempo delicata poesia popolare albanese e italo-albanese in nitide versioni italiane e conoscere un mondo, piccolo sì ma complesso, dove tutte le civiltà del Mediterraneo hanno lasciato la loro impronta. I riflessi di tre civiltà arricchiscono e rendono suggestiva la vita e per naturale conseguenza la letteratura albanese che di quella vita è un fedele specchio.

ABBONATEVI a « Shêjzat » (Le Pleiadi) inviando l'importo sul c/c postale 1/23626 di Roma 1 intestato alla rivista.

PAJTIMET E PERVJEÇME

Për Itali	Lit. 3.200
N'Europë	\$ 10
Për USA, Kanada e Australí	\$ 12

ABBONAMENTO ANNUALE

Italia	Lit. 3.200
Europa	\$ 10
USA, Canada, Australia	\$ 12

Registrato il 26-7-1957 al n. 5898 del Registro del Tribunale di Roma

S.A.G.E.R. - Via dei Bresciani, 38 - Roma - Telefono 65 35 47

Qendra e Studimeve Albanologjike Shejzat-Pleiades

In nessuna biblioteca dovrebbe mancare il poemetto del Poeta italo-albanese GIROLAMO DE RADA:

I CANTI DI MILOSAO

FIGLIO DEL DESPOTA DI SCUTARI

Testo albanese fiancheggiato da una nuova traduzione

a cura del

PROF. GIUSEPPE GRADILONE

Il poemetto è un capolavoro poetico ammirato da Alphonse de Lamartine, Mistral, Niccolò Tommaseo, Cantù e altri rinomati scrittori italiani e stranieri.

E' in vendita presso l'EDITORE LEO S. OLSCHKI di Firenze (Via delle Caldaie, 14).



Çdo Shqiptar dhe çdo Arbresh duhet t'a pajisi libertoren e vet private me kryeveprën « **Milosao** » të Jeronym De Radës, qi në këto dit u botue nga Editori Olschki (shif mâ nalt drejtesën).

Teksti shqip ka përkrah përkëthimin italisht. Teksti e përkëthimi u shqyrtuen e u kryen me kujdes të madh nga Prof. Zef Gradilone.

v. f. 52

Numer dyfish; L. 600